



---

# *Politika kulturore Udhëzues i shkurtër*

Simon Mundy

Këshilli për bashkëpunimin kulturor  
Departamenti për politika dhe aktivitetet kulturore  
Njësia për hulumtim dhe zhvillim

Publikimet e Këshillit të Europës

---

Dhjetor 2014, Prishtina



---

# *Politika kulturore Udhëzues i shkurtër*

Simon Mundy

---

---

Autor: **Simon Mundy, Përkthimi, CITS TRANSLATION**



Projekt i financuar nga BE-ja  
dhe i menaxhuar nga Zyra e  
Bashkimit European në Kosovë



Mendimet e shprehura në këtë publikim janë ato të autorit dhe nuk shprehin domosdoshmërisht pikëpamjet e Këshillit të Europës.

Kopertina © Ilustrimi nga June Hainault  
Dizajni i kopertinës: Graphic Design  
Workshop, Këshilli i Europës  
Faqosja: DTP Unit, Këshilli i Europës

Publikimet Këshilli i Europës  
F-67075 Strasbourg Cedex  
ISBN 92-871-4301-3

© Këshilli i Europës, maj 2000

# Përmbajta

## Parathënia 6

### Hyrja 7

#### I. Konteksti dhe parametrat e politikës kulturore 8

Detyra për ministritë e kulturës, tensionet në shoqëri që pasqyrohen në kulturë, argumentet për financimin e kulturës, marrëdhënia në mes të shtetit dhe sektorit të kulturës, baraspesha në mes të trashëgimisë dhe bashkëkohores, shkallët e financimit dhe vlerësimit, kultura dhe dimensionit ndërkombëtar

#### II. Trajtimi i trashëgimisë 24

Pozita e departamenteve të kulturës në qeveri, vlera e shtuar e kulturës, strategjitë për financim, kontributet e sektorit privat dhe komercial, sponsorizimi

#### III. Nivelet e qeverisë 36

Baraspesha në mes të organizatave civile dhe autoriteteve rajonale qendrore, mekanizmat për shpërndarje të financimit, rrjetat dhe shoqatat e shoqërisë civile, ekspertiza e zyrtarëve të kulturës

#### IV. Objektivat politike 44

Ruajtja e identitetit, lartësimi i dallimeve, përmbushja e potencialeve individuale dhe kolektive, qasja, pjesëmarrja, profesionalja dhe amatorja, përfshirja e minoriteteve, siguria kulturore

#### V. Realizimi i politikës 52

Trashëgimia 52

Turizmi 55

Muzetë, bibliotekat dhe arkivat 58

Artet vizuale dhe letrare 58

Artet interpretuese 68

Sektorët e kulturës 76

Media 79

#### VI. Arsimimi dhe trajnimi 84

Përgatitja e njerëzve për kulturën e tyre, vendi i kulturës në arsim, arsimit kulturor në shkollë dhe pas saj, shfrytëzimi i infrastrukturës shkollore për kulturën e komunitetit

#### VII. Përmbledhje: listë kontrolluese për politikëbërësit 91

# Parathënie

## Parathënie

Që nga mesi i viteve 1980-ta, Këshilli i Europës ka qenë i përfshirë në një program të madh studimor që ka të bëjë me vlerësimin e politikave kulturore kombëtare. Pesëmbëdhjetë shtete veçse janë shqyrtuar, ndërsa katër të tjera priten të shqyrtohen. Dokumente të shumta janë hartuar nga qeveritë dhe institutet hulumtuese të shteteve të ndryshme, si dhe nga ekipe të pavarura të ekspertëve për politika kulturore.

Edicioni i parë i përmbledhur dhe i azhurnuar i informatave themelore të mbledhura përmes shqyrtimeve është publikuar këtë vit dhe do të përfundohet në mënyrë që përfundimisht t'i mbulojë të gjitha shtetet që bashkëpunojnë brenda kornizës së Konventës Kulturore të Europës.<sup>1</sup>

Përtej fakteve dhe prirjeve themelore, përmes programit gjithashtu kanë dalë në pah një numër i madh informatash, të cilat janë nxjerrë nga mijëra faqe të dokumenteve për politika kulturore që janë mbledhur deri më tani. Shtrohet pyetja, si mund të shfrytëzohet më së miri kjo pasuri e informatave?

Një përgjigje tipike do të ishte që ato të shfrytëzohen për të zhvilluar

një sërë rekomandimesh për politika. Mirëpo, kultura dhe politikat e kulturës sa janë sfera komplekse, aq janë edhe të ndjeshme. Për këtë arsye nuk është as e mundshme e as e dëshirueshme që thjesht të sigurohet një tërësi e rekomandimeve politike të aprovuara “zyrtarisht” nga një organizatë ndërqeveritare.

Sidoqoftë, me kënaqësi të madhe e ndajmë me lexuesin e interesuar njohurinë e grumbulluar në këtë udhëzues shumë personal nga Simon Mundy, bazuar në dokumentet ekzistuese në lidhje me Shqyrtimet e politikave kulturore kombëtare.

## Vera Boltho

*Kryesuesja e Departamentit të politikave dhe aktiviteteve kulturore Këshilli i Europës*

1. *Politikat e kulturës në Europë: një përmbledhje e fakteve dhe prirjeve themelore*, Këshilli i Europës, ERICarts, Bonn: ARCutMedia, 2000. Versioni elektronik është në dispozicion në adresën e internetit: <http://www.culturalpolicies.net>.

Është plotësisht e pamundshme të mbulohet çdo aspekt i politikës kulturore brenda një vëllimi të kësaj madhësie. Megjithatë, ky është një tentim që të bëhet diçka që është afër asaj pamundësie. Nëse është fatlum, lexuesi do të fitojë njohuri se çfarë është politika kulturore, cilët janë komponentët kryesorë të saj dhe përbërësit që do ta sjellin atë në rrjedhat kryesore të praktikave bashkëkohore europiane.

Shumë zyrtarë dhe politikanë që do ta lexojnë këtë Udhëzues do të zbulojnë se veçse punojnë përgjatë këtyre linjave. Kjo nuk është e rastësishme. Materiali udhëzues është nxjerrë nga shumë studime të politikave kulturore në shtetet evropiane, të ndërmarra nga Këshilli i Europës që nga viti 1986.

Megjithatë, unë mendoj se kushdo që do ta shfrytëzojë atë si instrument profesional, do të gjejë diçka që do ta shtyjë të ndalet ta pyesë veten nëse në të vërtetë politikat e tij i plotësojnë idealet që ka. Shpresoj se studentët e menaxhmentit të kulturës, partitë politike, organizatat ombrellë, administruesit e institucioneve kulturore dhe artistët do të jenë në gjendje ta shfrytëzojnë këtë si udhëzues, kundrejt të cilit do ta testojnë politikën e shtetit

të tyre.

Këshilli i Europës nuk mund të fajësohet për të gjitha sugjerimet dhe interpretimin tim të tyre, e as për zhvillimin dhe përzgjedhjen e bërë, nga unë, prej qindra rekomandime të ekspertëve nga mbarë Europa. Është e pashmangshme që pozita e shkrimtarit të shpërfaqet. Andaj, kjo është një përgjigje personale ndaj materialit, e jo politikë zyrtare e Këshillit të Europës, apo e shteteve anëtare të tij.

Sa më shumë që të bëhet kondensimi i materialit, aq më qartë paraqiten temat. Unë supozoj se qeveritë aspirojnë të jenë demokratike, të kenë një ekonomi të bazuar në bashkëveprimin e sektorit privat dhe publik dhe ta shohin jetën kulturore si të denjë për investime. Unë gjithashtu i lejoj vetes t'iu them të mos ndërhyjnë në vendimet për artin dhe ta konsiderojnë tërësinë e mjedisit kulturor përmes një mënyre e cila i çan kufijtë zyrtarë dhe interesat. Këtu mund të gjenden mendime, mirëpo politika është zbatimi i mendimeve në renditjen e prioritetëve, kështu që nuk do të kërkoj shumë ndjesë.

Falënderimet e mia shkojnë për Kathrin Merkle dhe ekipin e saj në Strasburg për ndihmën e tyre dhe për një mal dokumentesh të dhëna si material përcjellës. Çfarëdo keqkuptimesh që mund të ketë, llogariteni se janë të mia.

**Simon Mundy**

*Gladestry, Uells*



# I. Konteksti dhe parametrat e politikës kulturore

Aty, si era që me trazi kalon nëpër pyje

Përmes tij stuhia e jetës kaloi furishëm

Trungu i njeriut kurrë nuk ishte i qetë Atëherë ishte Romaku, tani jam unë

**A.E. Housman**

***A Shropshire Lad***

Nuk ka kufij tokësorë në mes të shteteve kombe në Europë, të cilët kanë mbetur të pandryshuar gjatë 250 viteve të fundit. Kjo nuk është çështje e meritës së menaxhimit tonë kushtetues. Mirëpo, kjo e shpjegon se Europa është një kontinent politik evolucionar, jo një grumbull statik i burokracive të pandryshueshme. Perandoritë, republikat, nacionalizmat dhe lëvizjet ideologjike, të cilat e kanë nxitur ndryshimin (qoftë përmes luftës, qoftë përmes demokracisë) gjithashtu ia kanë dhënë Europës energjinë intelektuale dhe mundësinë artistike. Kultura – qoftë në kuptimin e saj të përgjithshëm të përfshirjes së çdo gjëje që e definon imazhin tonë për veten, apo në paraqitjen e saj që është më e lehtë për t'u menaxhuar si depo e shprehjes tonë – lulëzon nën tensionin e ndryshimeve politike dhe shoqërore.

Detyra për qeveritë moderne është ta inkurajojnë hulumtimin publik dhe privat

të kulturës, në të gjitha format dhe llojet e saj, pa e përdorur atë për ta fermentuar potencialin përçarës të kulturës për përshtatshmëri politike. Kultura, përgjatë rrugës, mund t'i sigurojë shtetit kontribute të mirëqenies ekonomike dhe shoqërore, kontribute që mund të jenë të rastësishme, por janë edhe të rëndësishme. Kjo mund të jetë një industri e dobishme. Ajo është në qendër të arsimit humanist. Ajo gjithashtu mund t'i mbulojë me lavdi kohërat dhe të gjallërojë jetesën e përditshme. Mund të veprojë si depo e trashëgimisë, qoftë private apo kolektive. Mund të jetë një ndihmë në transformimin qendrave të popullatës që janë në rënie apo duke vdekur, duke i ngritur pritshmëritë e qytetarëve, duke e shndërruar imazhin e një shkretie të dëshpëruar në një imazh të interesit dhe prosperitetit potencial. Kultura nuk mund të bëjë gjithçka që qeveritë do të dëshironin (dhe rrallëherë me shpejtësinë të cilën e presin), mirëpo, pa mjetet kulturore, detyra e përmirësimit të cilësisë së jetës do të ishte pafundësisht më e vështirë.

Derisa kultura mund dhe do të duhej shpesh ta përfshijë një ndjenjë të argëtimit, ajo është më shumë se zbavitje. Arsyeja pse njerëzit zgjedhin t'i shfrytëzojnë të hyrat e tyre gjithnjë

e më shumë në të mira kulturore nuk është vetëm se janë në esencë të dëshirueshme, por për shkak se shpeshherë idetë të cilat ato i mbajnë bartin me vete ngushëllim, lehtësim, shpjegim dhe plotësim dhe kënaqësi në të njëjtën kohë. Ndoshta nuk ka arsye me të madhe pse një qeveri me prioritete të shumta buxhetore duhet të ndihet e detyruar të subvencionojë argëtimin. Mirëpo, aspektet kulturore të arteve dhe të trashëgimisë në shumë mënyra janë një ekstrapolim i mjedisit. Një numër i madh i argumenteve që mjedisi të mbahet i pastër dhe i qëndrueshëm gjithashtu vlejnë edhe për kulturën. Shoqërisë i nevojitet një baraspeshë në mes të ruajtjes dhe risisë, në mes të së vjetrës dhe të së resë, të së veçantës dhe të së shumëllojshmes. Kultura, ashtu si natyra, e shfrytëzon të kaluarën për ta ushqyer të ardhmen. Shumica e asaj që ndodh mund të jetë kalimtare dhe jetëshkurtër dhe, përveç si dëshmi e saktë e historisë, mund të hidhet poshtë. Mirëpo, nuk i takon gjeneratës zbuluese që ta përcaktojë vlerën e asaj çfarë ajo prodhon. Cilësia relative e cilitdo prodhim apo ide mund të caktohet vetëm pjesërisht në atë kohë. Po ashtu, duhet të shtohet se ka nevojë për punë dhe përvojë të madhe nga shoqëria për ta mbajtur kulturën plot me energji dhe

entuziazëm.

Për një zyrtar apo politikan (qoftë të nivelit lokal, rajonal apo kombëtar) të ngarkuar me vendosjen e kësaj baraspeshë në mes të sigurimit dhe stimujve brenda një buxheti të kufizuar tejmase, një koncept i fillë gjithëpërfshirës mund, në rastin më të mirë, të jetë shumë irritues, e në rastin më të keq, si diçka që duket të jetë e pamundur të plotësohet. Kultura, si shëndeti dhe arsimimi, mund të jetë një humnerë e pafund për burimet. Ajo kurrë nuk është e përmbushur. Kurrë nuk ka të holla të mjaftueshme që të bëhen të gjitha dhe shpeshherë ka shumë pak për të bërë diçka në nivel të mirë. Por, në të njëjtën kohë, kjo është edhe përparësia e kulturës. Për shkak se investimi në kulturë ka të bëjë me paraqitjen e arritjeve dhe hulumtimin e mundësive deri në kufijtë e tyre, njerëzit gjithmonë do të kenë skema të reja dhe iniciativa të guximshme për të cilat kërkohet financim nga dikush tjetër. Një shoqëri, një kulturë, pa atë shtytje dhe ambicie, është një e stagnuar – dhe asnjë politikan, i çfarëdo nuance, nuk dëshiron të udhëheqë gjatë një periudhe të stagnimit.

la vlen që, për një moment, t'i nxjerrim parametrat brenda të cilëve do të operojë ky studim. Qëllimi nuk është

të diskutohet e tërë gama e çështjeve të ngritura nga pyetja e identitetit kombëtar, praktikës shoqërore, përkatësisë fetare apo rregullimit kushtetues (të gjitha prej të cilave kanë ndikim brenda definicionit më të gjerë të kulturës njerëzore). Në vend të kësaj, qëllimi është i kufizuar në ato aspekte të cilat rregullisht bien brenda fushë së veprimit të ministrive dhe departamenteve të kulturës, apo të cilat njihen qartë nga ministritë e tjera si aspekte kulturore të çështjeve brenda detyrave të tyre zyrtare.

Megjithatë, është e pashmangshme që çfarëdo diskutimi i tillë si ky të ndodhë përbrenda një konteksti më të gjerë filozofik, i cili përmban supozime në lidhje me natyrën, detyrat dhe aspiratat e qeverisë. Atëherë, supozohet se politika kulturore duhet të vendoset në një kornizë politike që është demokratike, që është e bazuar në një shoqëri në të cilën tatimet rishpërndahen për të mirën publike, se njerëzve iu mbetet sasi e mjaftueshme nga të ardhurat e tyre që të jenë në gjendje të bëjnë më shumë se vetëm të mbahen gjallë dhe se qeveritë iu përmbahen konventave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, lirisë së shprehjes, ruajtjes së trashëgimisë dhe ndershmërisë administrative. Për shumë qeveri

europiane kjo ka qenë gjendja për shumë vite (së paku në teori), për disa të tjera përvoja e vërtetë e kësaj është paksa e freskët, ndërsa për të tjerët, trazirat nëpër të cilat kanë kaluar shtetet e tyre kanë bërë që themelimi i një kornize të tillë të shihet ende si diçka që është në vijim e sipër.

Të gjithë europianët kanë parë ndryshime të jashtëzakonshme gjatë jetës së tyre, qofshin ato kushtetuese, ekonomike apo teknologjike. Kjo ka bërë që shumë prej tyre të ndihen të hutuar dhe të pasigurt, të përcaktuar t'i mbajnë elementet e jetës që mbesin të njohura për ta dhe iu japin së paku një grimcë të sigurisë. Derisa Europa shpeshherë është motori i inovacionit, po aq shpesh karakterizohet edhe me nostalgji, me një gjurmë të keqardhjes se aq shumë ka ndryshuar, se aq shumë gjëra që kanë pasur vlerë janë humbur përgjatë rrugëtimit. Realiteti i luftës dhe trazirave ende qëndron me ne, por ka një vetëdijesim se lufta dhe shtypja kurrë nuk kanë qenë i tërë tregimi; se çdo vit apo vend i mirë ka pikat e tij të mira, por gjithashtu edhe katastrofat, se për gjithçka që ka qenë gabim ka pasur edhe përfitim, edhe në qoftë se ai ka ndodhur vetëm për disa. Në këtë europianët nuk janë si amerikanët (edhe

pse amerikanët, për çdo vit, gjithnjë e më shumë po pajtohen me versionet e historisë së tyre). Jo gjithmonë supozojmë se gjithçka e re do të thotë e mirë, se vendimi më i fundit i marrë është domosdoshmërisht ai i duhuri. Ne jemi të vetëdijshëm se jemi pjesë e një procesi në formimin e të cilit mund të ndihmojmë, por për të cilin ne kurrë nuk mund ta kemi fjalën përfundimtare.

Për kulturën, kjo tendosje që është gjithnjë e pranishme në mes të së kaluarës dhe të tashmes rezulton në një marrëdhënie të çuditshme. Kultura është, në të njëjtën kohë, vendi ku mbledhet dhe ruhet thesari i identitetit, agjenti i cili dëshmon saktësinë ose validitetin për shumicën e politikave dhe sjelljes tonë dhe një përgjegjësi qeveritare, e cila vazhdimisht vendoset shumë poshtë në hierarkinë profesionale dhe buxhetore. Statusi i kulturës në qeveri karakterizohet nga hendeku shumë i madh në mes të përkrahjes retorike dhe asaj financiare. Po të ishte kultura aq e rëndësishme sa e bëjnë fjalimet qeveritare të ndihet, ajo do të kishte një buxhet që do të krahasohej me atë të mirëqenies apo mbrojtjes. Në realitet, kjo natyrisht se kurrë nuk ndodh. Gjithashtu, ka një mospërputhje të madhe në mes të mënyrës se si

qeveritë (qofshin ato komunale apo qendrore) e shfrytëzojnë kulturën në diplomaci dhe në promovimin e vetvetes dhe qëndrimit të tyre ndaj saj, kur dihet mirëfilli se aktiviteti kulturor është në thelb një çështje për vetë qytetarët e tyre. Në diplomaci kjo shndërrohet në një flamur, në një manifestim të së drejtës së lokalitetit që të trajtohet me seriozitet në kontekst më të gjerë. Për qytetarët kjo shpesh shihet si një aktivitet i kohës së lirë, një diversion për ato kohë kur ata nuk kanë asgjë më të rëndësishme për të arritur (siç është gjenerimi i tatimeve).

Kultura gjendet në pozitë të ulët sa iu përket prioritetëve për shumicën e qeverive moderne (edhe pse në të kaluarën shpesh është vendosur vetëm prapa mbrojtjes). Kjo i bie thujtë të zihesh duke shpenzuar për shëndetin kulturor të shoqërisë është një ofendim për mirëqenien trupore të qytetarëve. Kritikuesit e shpenzimit kulturor shpesh krahasojnë vendosjen e të hollave në operë me të holla që nevojiten për të blerë makina të veshkave, apo spitale të fëmijëve. Kjo sigurisht se është një analogji qëllimisht e pavërtetë dhe emocionale. Nuk ka asnjë arsye që të veçohet opera para fushave të tjera të financimit publik. Do të ishte shumë më e logjikshme, po qe se dëshirojmë të krahasojmë harxhimet koti me nevoja,

t'i krahasojmë shpenzimet për skemat e panevojshme të menaxhimit të trafikut me shëndetësi dhe paradat ushtarake me opera. Mirëpo, kultura është një temë emocionale, e cila me të vërtetë e nxjerr forcën jetësore të saj nga ngarkesa emocionale që është në gjendje ta krijojë. Për këtë arsye, është thuajse fare pak e çuditshme po qe se kjo shkakton argumente të paarsyeshme dhe negative me po aq pasion sa edhe ato pozitive dhe të arsyeshme.

Perceptimet europiane të kulturës ende pengohen nga feja, sidomos nga variantet e krishterimit, edhe pse shumë njerëz në Europë do ta konsideronin veten laik në pikëpamjen e tyre. Në bazën e shumë shoqërive protestante veriore ekziston një grimcë e mospranimit dhe mosbesimit puritan ndaj arteve, thua se vendet e punës të krijuara në fushën e artit dhe kulturës disi janë në thelb më joserioze se sa ato në prodhimtari apo financa. Pse kjo duhet të jetë kështu është një çështje hutuese – një rast që më parë do të duhej të trajtohej nga psikologu sesa nga shkencëtari politik. Të hollat në sektorët e tjerë shpenzohen po aq shpejt dhe të mirat e prodhuara hidhen (zakonisht shndërrohen në të vjetruara përbrenda një periudhe shumë të shkurtër kohore),

ndërsa artet prodhojnë punime që u qëndrojnë shekujve. Shoqëritë katolike kanë më pak probleme për të arsyetuar shfaqjen kulturore. Besimi i tyre është ai që mund ta arsyetojë ekstravagancën e festimit të lavdisë së Zotit dhe mund ta zgjerojë këtë parim në shumë drejtime, duke përdorur interpretimin humanist. Ndoshta europianët e fesë ortodokse janë shërbyer më së miri, ku hierarkia fetare ka qenë, në të vërtetë, neutrale në qëndrimin e saj ndaj aktiviteteve artistike jashtë kishës. Për këtë arsye, shpenzimi në kulturë nga qeveria, në këtë kontekst, mund të shihet si një shërbim shoqëror i pangarkuar nga teologjia e formuluar për një kohë tjetër. Mirëpo, pikëpamjet fetare do të shfaqen dhe duhet të ketë ndjeshmëri ndaj tyre, për shembull, ndaj traditave islamike dhe të tjerave përreth botës. Megjithatë, është e rëndësishme që politikat të mos humbin drejtimin e tyre nga kërkesat e grupeve të ndryshme fetare, pavarësisht se sa të zëshme janë ato.

Vetë historia politike e ka komplikuar çështjen e përkrahjes shtetërore për sektorin kulturor në Europë. Kjo është një temë shumë e gjerë dhe nuk ka vend të mjaftueshëm këtu për ta hulumtuar atë tërësisht. Sidoqoftë, pasi që kjo karakterizon marrëdhëniet e përditshme

në mes të ministrave, zyrtarëve, artistëve dhe shtypit, është e përshtatshme që të paraqitet një përshkrim i vrazhdë i disa prej streseve dhe tensioneve, në të cilat ata punojnë.

Çështja e ndërhyrjes politike në liritë artistike dhe intelektuale është një çështje konstante në pothuajse të gjitha shoqëritë europiane. Kjo është po aq e pashmangshme sa është edhe endemike. Partitë politike ekzistojnë që t'i bëjnë njerëzit të ndihen të sigurt dhe të kënaqur me jetën e tyre dhe ta kthejnë atë kënaqësi në miratim të administratës apo regjimit kur ata të jenë duke udhëhequr. Nga ana tjetër, artistët dhe intelektualët janë aty që ta vënë në dyshim, të debatojnë dhe shpesh ta dobësojnë rregullimin e pranuar. Madje edhe artet që ne i shohim tani si të parrezikshme (për shembull këngët e Schubertit apo pikturat e Vermeerit) në kohën e tyre kanë qenë përshtatje domethënëse të status quos. Si politikanët ashtu edhe artistët kërkojnë ndryshimin. Mirëpo, aty edhe përfundon ngjashmëria, për shkak se derisa politikanin tenton ta bindë popullatën se ai e ka zgjidhjen, artisti është i sigurt vetëm për pyetjen. Artisti jo domosdoshmërisht bashkëpunon për ta mbuluar me lavdi shoqërinë me

vrullin dhe në mënyrën e dëshiruar nga autoritetet. Vërtet, shpesh ndodh që sa më madhështore dhe e lavdishme të jetë ndodhia zyrtare, aq më ekstreme do të jenë pyetjet e artistëve. Është aksiomë e arteve ta lëmojnë aq sa të kafshojë dorën që i ushqen. Kjo tronditje e supozimeve mund të ndërmerret në çfarëdo forme dhe në secilën situatë. Ky është dallimi në mes të argëtimit të thjeshtë dhe artit. Sepse, përdërisa argëtuesi luan dhe i përforcon paragjykimet dhe supozimet e publikut, artisti kërkon ta ndryshojë botëkuptimin, në disa raste vetëm paksa dhe në mënyrë delikate, në disa raste gati se dhunshëm. Si pasojë, kur artisti i nënshtrohet dëshirave të autoritetit, apo kur kërkon ta përforcojë status quon – qoftë duke u bazuar në besimet politike apo në frikën nga pasojat – është më se e mundshme që puna e tij të mos jetë e besueshme nga boja e gjerë kulturore. Artisti në rol të tillë kthehet në një dekorues, diçka që duhet trajtuar jo me më shumë seriozitet se vetë ambiciet e fryra të vetë regjimit.

Kjo krijon për qeverinë dy probleme, njërin praktik e tjetrin filozofik. Ai praktik është i thjeshtë. Si mund ta mbajë dinjitetin dhe autoritetin e saj, ta ruajë respektin e qytetarëve, kur është duke u

sfiduar drejtpërdrejt nga ata të cilët është gjithashtu duke i financuar? Problemi filozofik është më i vështirë. Si mund ta mbrojë një politikan një artist, i cili është jo vetëm duke çrregulluar teorinë, doktrinën apo praktikën përgjithësisht të pranuar, apo të autorizuar, që është ndërtuar me aq kujdes, por gjithashtu edhe definicionet e shijes së mirë, sjelljes së pranueshme dhe gjuhës së përshtatshme? Shpesh zyrtarët janë singërisht të befashuar kur shihet si censurim kur ata thonë se një punim specifik nuk mund të prezantohet në një ndodhi apo ndërtesë specifike. Në fund të fundit, shumë shpesh këto janë ndodhitë dhe ndërtesat e tyre. Po që se ata do të vepronin në një ambient privat, do të kishin të drejtën e plotë të vendosin cilat piktura t'i vënë në mure, cilën poezi ta lexojnë apo cilën pjesë teatrale ta shfaqin në kopsht. Mirëpo, në publik ky nuk është rasti, për shkak se duke imponuar një pikëpamje zyrtare, autoriteti publik është duke e vendosur veten në pozitë ndërmjetësuese në mes të komunikuesit, artistit dhe qytetarit. Qytetari vendos nëse duhet ta pranojë apo ta refuzojë ofertën e artistit (dhe refuzimi është shpesh i zëshëm) dhe përveç në rast ku qytetari me ligj nuk e ka moshën e duhur që të shihet si person që është në gjendje të vendosë, autoriteti

publik duhet ta pranojë se i njëjti nuk ka asnjë fuqi të vendimit (edhe në rastin e fëmijëve, autoriteti i dorëzohet prindërve, jo shtetit).

Secilës shoqëri në Europë i ka ndodhur të ballafaqohet me këtë vështirësi kohëve të fundit, edhe pse kjo çështje në disa raste është trajtuar më egërsisht se në raste të tjera. Në ish-shtetet komuniste, largësitë e skajshme, shpeshherë jonjerëzore, deri në cilat kanë shkuar autoritetet për t'i imponuar pikëvështrimet e veta, kanë rezultuar me shumë shoqëri dyshuese ndaj çfarëdo përzierje nga shteti në përkrahjen e artistëve. Kjo është e kuptueshme dhe në rast se shoqëritë kanë pasur sisteme private zemërgjera të patronazhit që do ta merrnin rolin, kjo nuk do të paraqiste vështirësi. Mirëpo, nuk ka alternativë realiste për financimin shtetëror dhe kështu, sado me dhimbje, janë nxjerrë mësimet në të dyja anët. Institucionet artistike duhen ta pranojnë se është e mundshme që shteti të sigurojë të holla pa kërkuar të kontrollojë, derisa shteti duhet të mësojë të mos i imponojë shijet dhe prioritetet e veta vetëm për shkak se është siguresi i financave. Në të dyja rastet bindja dhe debati janë drejtimi i duhur. Refuzimi, qoftë i të hollave apo artistit, nuk i ndihmon asnjëherë palë.

Gjatë viteve të 1990-ta, rastet e ndërhyrjes së shtetit në lirinë artistike pësuan rënie të theksuar, jo vetëm në shtetet e ish-bllokut lindor. Edhe në shtetet e tjera, tentimet për ta censuruar teatrin apo filmat për shkak të tabuve seksuale apo dinjitetit politik ndodhnin shumë më rrallë se kurdo përpara. Mirëpo, kanë vazhduar të ketë raste të autoriteteve të qytetit dhe atyre lokale të cilat kërcënonin se do ta tërhiqnin përkrahjen financiare për festivale apo teatro, për shkak se politikanët lokalë nuk i pëlqenin përmbajtjet. Mirësjellja publike ka qenë normalisht sinjali për shfaqje të reagimeve kundërshtuese nëpër qytetet e Europës veriore (siç ishte rasti edhe në Amerikë). Në jug nxitëse ka qenë ndjenja nacionaliste. Është vështirë që, derisa bartja e vendimmarrjes te nivelet lokale sjell me vete një shkallë të pronësisë së politikës kulturore, e njëjta gjithashtu ta bëjë atë të hapur ndaj ndikimeve të cilat jo domosdoshmërisht janë aq të sofistikuara sa ato që mund të gjenden në një ministri në nivel qendror. Kjo nuk do të thotë se të gjitha ministratë janë shembuj të përkryer të vlerave liberale, apo se e tërë udhëheqësia lokale janë censurues të natyrshëm; kjo vetëm do të thotë se në nivelin lokal, shtypjet që rrjedhin nga reagimet kundërshtuese, në kohën kur kufijtë që

janë në vend tejkalohen, mund të bëhen shumë të rënda dhe të vështira për institucionet lokale që t'i injorojnë.

Në një mënyrë duhet të ketë një shkallë të simpatisë ndaj atyre që janë zënë në mes të argumenteve të censurimit. E drejta bardh-e-zi e artistëve për të qenë ofendues sipas nevojës shkon kundrejt dëshirës së qytetarëve të jetojnë jetën e tyre të papenguar nga spektaklet që i konsiderojnë të papërshtatshme. Kjo krejtësisht dallon nga ndërhyrja e drejtpërdrejtë për shkaqe ideologjike. Këtu ballafaqohen dy lloje të të drejtave demokratike që në shikim të parë duken jokundërshtuese. Zgjidhja duhet të qëndrojë në faktin se derisa një artist (apo kushdo tjetër) ka të drejtë të paraqesë çfarëdo veprë që mendon se ia vlen, çdokush tjetër ka të njëjtën të drejtë që atë vepër plotësisht ta shpërfillë, ta ndërpresë shikimin apo dëgjimin ose të dalë jashtë. Megjithatë, gjithmonë është më së miri që autoritetet publike të mos ia lejojnë vetes që të luajnë rolin e arbitrit mes publikut të pakënaqur dhe artistit të vendosur. Pa audiencë, artisti do t'i bëjë gati plaçkat e veta dhe do të shkojë. Nëse vepra ndalohet, atëherë e njëjta do të bëhet *cause célèbre* dhe do të vizitohet dhe shihet nga shumë më shumë njerëz sesa



në rastin kur vlera e saj shokuese do të absorbohej pa komente. Fundja, është vështirë të kemi një argument kur askush nuk kthen përgjigje.

Derisa ky është qëndrimi më i mirë për shëndetin afatgjatë të jetës publike, ai njëkohësisht mund të ndikojë në pozitën e aktivitetit kulturor në komunitet. Artet bashkëkohore nga vetë nevoja janë *enfants terribles* të kulturës. Në rastet ku ato tërheqin vëmendjen, gjejnë kënaqësi në rebelim dhe kërkojnë më shumë resurse se sa që mund të arsyetohen nga suksesi i tyre (qoftë nga aspekti i audiencave të gjëra, apo nga ai i gjykimit kritik). Shpesh mbulimi medial ndërlikon çështjen, duke qenë njëkohësisht i përgatitur t'i mbulojë storiet e artit vetëm nëse krijojnë një tërbim, duke i denigruar fajtorët dhe ata që i ndihmojnë. Atëherë afshi emocional kthehet kundër tërë sistemit për financimin e kulturës, thuase cilido institucion që mendon të jetë nikoqir i arteve të urryera moderne duhet të jetë fajtor për shkak të ndërlydhjes me çuarjen dëm të parave publike në çdo departament tjetër. Kjo më së miri është vërejtur në Shtetet e Bashkuara, të cilat përkundër ekzistimit të sistemit të financimit publik, që është pothuajse përqeshës shikuar sipas kriterëve europiane, prapëseprapë ballafaqohet me sulme të pareshtura

nga kundërshtarët puritanë, të cilët janë të përgatitur ta dënojnë tërë sektorin e kulturës për shkak se iu gjen strehë njerëzve me pikëpamje që atyre nuk u pëlqejnë. Pasi që një numër domethënës i zgjedhësve gjithashtu përshkohet nga një shije e mosmiratimit, sektori i kulturës është një shënjestër e lehtë për politikanët që kanë dëshirë të shihen se mbajnë anën e vlerave borgjeze, pa pasur nevojë të marrin vendime të vështira për buxhete në sektorët që kanë më shumë rrezik të përçmohen nga publiku.

Në realitet, artet bashkëkohore përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të politikave kulturore. Megjithatë, ato mbajnë në vete tensionin më të madh të publicitetit. Ato gjithashtu parandalojnë kulturën që të merret më shumë me të kaluarën dhe me kënaqjen e audiencës, e cila më shumë e adhuron të njohurën sesa sfidën. Çfarëdo programi artistik që plotësisht mbështetet në gjërat tanimë mirë të sprovuara nga e kaluara, patjetër se pas kalimit të kohës do të duket i pëlqyeshëm për një pjesë të shoqërisë, e cila vetëm për një përqindje të vogël është më e madhe në numër se ajo që anon kah veprat moderne që bartin rrezikun e vet. Natyrisht, ka mënyra të hulumtimit të veprave nga e kaluara, të cilat i mbajnë ato të freskëta – interesimi

i vazhdueshëm për teknikat e hershme të performancës për herë të parë në shumë shekuj e ka sjellë në vëmendjen e publikut një vistrë shumë të gjerë të muzikës, për shembull, dhe Shekspiri vazhdon të riinterpretohet ashtu që të duket modern në cilëndo kohë që flasim.

Për politikën publike, elementi më i rëndësishëm është baraspesha, gjegjësisht gjetja e mënyrës për stimulimin e emocionimit, madje edhe të kundërtshënies, duke krijuar njëkohësisht kushtet për një hulumtim të gjallë, por të respektueshëm të materialit që përbën mbamendjen kulturore. Ky material, qofshin ato ndërtesa, tipare arkeologjike, peizazhe, objekte, kopshte, dorëshkrime dhe libra, regjistra të performimit apo zakone tradicionale, zakonisht quhet si trashëgimi, shpesh madje edhe si trashëgimi kombëtare, sikurse ekzistimi i saj dhe konteksti i kufijve shtetërorë e i institucioneve të ishin të pandashëm.

Historia e vërtetë e pjesës më të madhe të trashëgimisë është më e pasur dhe më pak e qetë sesa që iu konvenon qeverive. Ajo zakonisht shkon pas pushtetit – qoftë triumfit të pushtetit dhe të madhështisë që lë apo edhe rënies së pushtetit dhe mbetjeve të kolapsit të tij. Për kombet dhe vendet, kjo ndikon në prishjen e imazhit. Më mirë do të ishte

që trashëgimia të paraqitet si një shtëpi e mbushur me thesar. Si një shkëlqim që ka mbijetuar të kaluarën e trazuar dhe që paraqet referencë për informata të reja në enciklopeditë e vetëdijes kulturore. Në fakt, kjo duhet të vlerësohet. Çdo brez i një shteti ka detyrë ta ruajë dhe mbrojë regjistrin e të kaluarës për brezat e ardhshëm, duke zhvilluar njëkohësisht aktivitetet që do të lënë gjurmë në kohën aktuale. Shikuar nga ky aspekt, trashëgimia asnjëherë nuk qëndron në vend.

Ajo vazhdimisht pasurohet dhe riinterpretohet. Gjetja e një baraspeshe në këtë kontekst është test i politikës së mirë. Nëse e kaluara theksohet shumë, atëherë ekziston rreziku që vendi të shndërrohet në një park të temave kulturore, gjithmonë duke nxjerrë versionin e pastruar dhe të ripaketuar të historisë, me shkallë të autenticitetit dhe integritetit të ngjashme me rifabrikimet e filmave vizatimorë të viteve 1880-ta, të quajtura “Main Street, USA”. Të arriturat e të tashmes denigrohen nga kjo politikë dhe duket se nuk ka asgjë për të madhëruar. Rrjedhimisht, vendi do të duket se ka mbetur pa karburant dhe se është parkuar në një vend të errët të zhvillimeve të tashme.

Megjithatë, nëse ka interesim të tepërt për modernen, atëherë shteti bëhet vetëm si një pasues i modës, duke shpërfillur rrënjët e veta në kërkim të përhershëm të risisë. Kjo shkatërroi gjërat e bukura dhe vlerat afatgjata në emër të progresit, duke fshirë peizazhet, duke zëvendësuar fushat e blerta me hekur dhe duke i quajtur muzikën e poezinë e vjetër të zbrazta dhe të vdekura. Nga një aspekt, ky është krim edhe më i madh se këto dy, për shkak se trashëgimia asnjëherë nuk mund të rikthehet pasi që të jetë shkatërruar njëherë, ndërsa mungesa e kujdesit për punën moderne do të lë vetëm një vrimë në analet e kohës – të mbajtur në mend si një valë jofrymëzuese para se të vinte dikush me një vizion dhe energji më të madhe.

Në procesin e ushtrimit të këtij kujdesi, shteti (ose organet e tij lokale) ka një numër të madh armësh në armëtoren e tij. Disa janë të natyrës financiare – mu sikurse në shërbimet shëndetësore ose në ushtri, pra, asgjë në kulturë nuk arrihet pa para – por, të tjerat janë të natyrës rregullative dhe filozofike. Një pjesë e madhe e trashëgimisë mund të mbrohet përmes ligjeve dhe mund të përmirësohet përmes tatimeve, të cilat favorizojnë kujdesin dhe jo shkatërrim

apo ndryshimin e planifikuar keq. Njeriu mund ta konsiderojë këtë si rregullim të mjedisit kulturor. Ngjashëm me këtë, mund të hartohen ligjet, ku do të parashiheshin më shumë shpërblime për menaxhimin kreativ sesa për ruajtjen e drejtpërdrejtë apo lënien anash. Njëkohësisht, pushteti mund të formësojë porosinë e tij, ashtu që të jetë e qartë se toni politik është i baraspeshuar dhe i pjekur, duke u bazuar në mësimet e nxjerra nga e kaluara dhe duke i vlerësuar ato, njëkohësisht duke e ngritur në qiell momentin e kohës së tij, përmes ndërtimit të objekteve, organizimit të ngjarjeve artistike dhe objekteve që demonstrojnë se e tashmja është po aq e aftë t'i japë kontribut kulturës dinamike, siç ishte edhe e kaluara.

Për të arritur më të mirën nga politika e balancuar, pushteti duhet t'i plotësojë dy kritere të tjera. I pari është fleksibiliteti. Kështu, është lehtë që në kuadër të politikës së kulturës të përkrahen pa rezervë disa institucione, të cilat pas një kohe bëhen më të interesuara për të mbijetuar në aspektin korporativ, sesa në rizbulimin e vetvetes për t'i përballuar sfidat e reja. Politika kulturore duhet të ruajë aftësinë për t'i mbajtur organizatat brenda sferës

së saj në gjendje të evolucionit të vazhdueshëm. Kjo do të thotë, ruajtjen apo ndarjen e një pjese fondesh për nisma të reja, apo për institucionet në zhvillim. Problemi me kulturën, siç është rasti me arsimin dhe shëndetësinë, është se përgjigjja e logjikshme në shumicën e pyetjeve nuk është në formën “kjo apo ajo”, por “që të dyja”.

Ata që janë të mirë në punët e kulturës gjithmonë do të kenë ide të reja, do t'i shtyjnë gjërat përpara dhe do të jenë të acaruar nëse nuk mund të gjejnë resurse për financimin e nismës së tyre. Andaj, gjatë hartimit të politikave duhet t'i kemi parasysh kostot fikse, duke siguruar që të mos lejojmë që ato të marrin pjesën më të madhe të buxhetit, duke pamundësuar kështu futjen e risive, si dhe duke siguruar njëkohësisht që institucionet të jenë në gjendje të mirëmbajnë objektet dhe strukturat e punonjësve në mënyrë të duhur. Kjo nuk është gjithmonë vetëm çështje e parave. Disa nga sektorët kulturorë më së shumti të financuar nganjëherë janë bërë asgjë më shumë se burokraci të ngurta, ku madje edhe muzikantët janë lidhur për strukturës, e cila i mban të ngjitur për vendet e tyre, ku kreativiteti është i barabartë sikurse të ishin duke larë enë dhe pastruar në ndonjë kuzhinë

qeveritare, ndërsa sektorët (që kanë pak para, por shumë imagjinatë) kanë arritur rezultate mbresëlënëse. Megjithatë, kjo e fundit mund të zgjasë vetëm për një periudhë të kufizuar. Në fund të fundit, në një periudhë afatmesme problemet që vijnë si rrjedhojë e financimit të mangët do të dalin në pah, pasi që pritet gjithnjë rriten, ndërsa përmbushja e tyre gjithnjë do të çalojë.

Nuk ekziston ndonjë pikë e caktuar ku takohen rregullsia fiskale dhe ofrimi i arsyeshëm i kulturës. Megjithatë, ekziston një nivel nën të cilin një infrastrukturë e pranueshme nuk mund të mirëmbahet – në të cilin lloji i institucioneve të ndërlydhura me sektorin e shëndoshë europian pushojnë së qeni të qëndrueshme dhe ku nuk mbetet hapësirë qoftë për ruajtje mjedisin kulturor, qoftë për ta nxitur kreativitetin. Nga përvoja, ky nivel duket të jetë mes 0.5 dhe 1% të shpenzimit publik. Qeveritë më zemërgjere europiane kanë shpenzuar afër 2%, ndërsa ato më duarshtërnguara kanë shpenzuar jo më shumë se 0.3%. Asnjë artist apo drejtor i një vendi të trashëgimisë kulturore nuk do të ankohet haptas se ka shumë para në sistem – edhe pse ka shembuj ku teprica e mjeteve vetëm shërben për rritjen e tarifave profesionale, përveç në

rastet kur kemi një menaxhment inovativ për t'i shpërndarë ato në projekte të reja. Megjithatë, efektet e lënies pas dore mund të dallohen lehtë: mbyllja e teatrove apo shfrytëzimi i tyre i pakët, gjendja e keqe e monumenteve, galeritë dhe muzetë e paraqitura keq, problemet e orkestrave, zhdukja e revistave të poezisë, papunësia dhe festivalet e paorganizuar mirë.

Përbërësi tjetër përpos sasisë së duhur të mjeteve financiare, i cili shndërron sektorin konfuz dhe problematik në një sektor të rregulluar mirë dhe përparimtar, është edhe vlerësimi. Përcaktimi i objektivave, monitorimi i përmbushjes së detyrave, përcjellja e dinamikave të perceptimit publik dhe krahasimi me punët e ngjashme jashtë vendit, krijon mundësinë që politika kulturore të hartohet ashtu që të ketë mundësinë e përshtatjes në rast të paraqitjes së problemeve. Megjithatë, për të qenë të suksesshëm dhe për t'iu shmangur krijimit të problemeve dhe dyshimeve, vlerësimi duhet të jetë sa më i hapur dhe transparent që të jetë e mundur. Kjo, natyrisht, nuk do të thotë që sistemi të ngulfatet me krijimin e komisioneve të pafundme, por më shumë ngërthen në vete krijimin e mundësive adekuatë

për paraqitjen e planeve; pasjen e një qëndrimi pranues për ide të reja, përveç nëse ka ndonjë arsye të fortë për ta bërë të kundërtën; shpjegimin e vendimeve dhe ofrimin e mundësisë për ankesë. Fundja, politika kulturore krijohet për t'i ndihmuar sektorit të kulturës që ta bëjë punën e vet në mënyrë sa më të lehtë dhe që të mos e kufizojë atë për hir të burokracisë qeveritare.

Asgjë nga këto nuk ndodhin të veçuara. Kultura është shqetësimi më personal i kombit, por gjithashtu edhe një nga çështjet më lidhëse në rrafshin ndërkombëtar. Vetë trashëgimia është po aq pjesë e historisë së popujve të tjerë sa është edhe e vendit ku ndodhet, e rezultatit të invadimeve dhe martesave, e migrimit dhe e vjedhjes. Arti, përderisa është gjithmonë në kulmin e tij, kur frymon brenda kontekstit dhe kohës së caktuar, është gjithashtu edhe ambasadori më i madh që është i aftë të flasë përtej kufijve kombëtarë, etnikë, moshorë dhe të prejardhjes në mënyrë të tillë sa që asnjë program politik nuk mund ta bëjë. Do të ishte thellësisht klaustrofobike po qe se do të kufizoheshim vetëm në përvojën artistike të vendit dhe kohës sonë kur jetojmë. Arti rrugëton i papenguar nga aspektet e përshtatshmërisë burokratike.

Shpesh ne shohim njëri-tjetrin përmes syve të artistit, qoftë ai regjisor modern i filmave, apo piktor i Rilindjes. Imazhi i kulturave të tjera që vjen përmes muzikës së tyre, apo regjistrimit vizual, qoftë ajo piktura e Musogorskit e Ruisë në Boris Godunov ose piktura e ëndrrës aborigjene në Australi, le një përshtypje më të thellë sesa paralajmërimet e veprimeve të pushteteve zyrtare. Edhe kur lufta është ende e freskët në mbamendje, është gjuha artistike e ish-armikut ajo që nxit përmbajtjen dhe respektin shumë përpara se besimi i bazuar në aleanca të reja dhe në interesat e përbashkëta materiale të mund të ndërtohet prapë.

Për shkak të këtyre tri elementëve – ndërsjellshmërisë së kulturës, përdorimit të saj në cilësinë e të dërguarit të sinqertë dhe joshjes së saj për humanizmin universal – kultura po bëhet pjesë gjithnjë e më e rëndësishme në dialogun ndërkombëtar. Shikuar nga njëra anë, sektori i kulturës është më i lëvizshmi dhe i globalizuari nga të gjithë të tjerët dhe, rrjedhimisht, kërkon politika të zbatueshme në mbarë botën. Ndërsa nga ana tjetër, po bëhet e dukshme që programet ndërkombëtare për siguri dhe zhvillim do të kenë gabime serioze nëse nuk e marrin parasysh kulturën (qoftë në

kontekstin e gjerë, apo në atë ngushtë).

Megjithatë, marrja parasysh e saj do të jetë e padobishme nëse është plotësisht pasive. Programet e agjencive ndërkombëtare dhe institucioneve ndërqeveritare duhet gjithashtu të kenë substancë të konsiderueshme aktive kulturore. Retorika dhe shfrytëzimi i porosive kulturore në reklamim dhe propagandë nuk mjafton. Çka është më e rëndësishme, qeveritë do të konstatojnë se nismat e tyre do të marrin më shumë kohë për arritjen e rezultateve dhe nuk do të merren me asgjë tjetër përveç me problemet e lehta, në rast se shpërfillen mundësitë për bashkërendim kulturor, apo nëse kultura gjithmonë lejohet të rrëshqasë në fund të agjendës së prioritetëve.

Gjithashtu, ekziston interesi i përbashkët ndërkombëtar për t'u siguruar që shtetet ta kultivojnë kulturën e tyre. Arka e ideve dhe i traditave që ruan materialet për të ardhmen është pjesë e thesarit të diversitetit njerëzor. Tani bota ka vetëm 10% të gjuhëve aktive nga numri i përgjithshëm i gjuhëve, me të cilat e filloi shekullin e 20-të. Kjo paraqet një humbje shkatërrimtare të koncepteve dhe të literaturës (shumica syresh gojëdhëna, të cilat do të mund

të ishin kyçe për të kuptuarit e shumë tensioneve të përbashkëta rreth nesh). Në të njëjtën kohë, ndërvarshmëria dhe shpejtësia e afarizmit global do të thotë se lidhjet e përbashkëta po fuqizohen dita-ditës. Së këndejmi, po dalin në pah dy grupe që janë të privileguara në mënyra të ndryshme: ata që kanë qasje dhe që e kuptojnë traditën dhe kulturën e pasur të zbuluar me gjuhën e vjetër dhe me mënyra të stërholluara, të cilët nuk kanë asgjë të bëjnë me konformizmin modern; dhe ata që kanë mjete dhe ekspertizë të ecin rrjedhshëm nga kultura në kulturë në një tapet të cekët të tipareve ndërkombëtarisht të pranuar – mishërime të lëvizshmërisë së korporatave. Në mes jemi ne të tjerët, me një ndjenjë të fortë të së kaluarës sonë dhe me dëshirë që t'i përkasim të ardhmes, si dhe me një etje për të mirat e jetës moderne, të përputhur me një ndjenjë pothuajse të barabartë të të kuptuarit.

## II. Trajtimi i trashëgimisë

*Ne jemi njerëz të shpërndarë,  
historia e të cilëve është ndjenjë e  
besueshmërisë së errët.*

**Seamus Heaney**

*Nga "The Land of the Unspoken"*

Edhe pse kultura ka qenë një nga përgjegjësitë më të vjetra të shtetit në shumë sisteme politike europiane, prapëseprapë ka mbetur relativisht në nivele më të ulëta të hierarkisë profesionale, qoftë ajo politike apo administrative. Kur merret parasysh se sa shteti shpesh është i përgatitur të investojë në avancimin e lavdisë së vet përmes kulturës, kjo mund të duket befusuese. Qoftë përmes spektakleve të mëdha të gjykatave franceze dhe italiane të shekullit 16-të dhe 17-të, ruajtjes së orkestrave të gjykatave gjermane në shekullin 19-të, ose restaurimit të objekteve të panevojshme mesjetare, apo edhe investimit në qendra të mëdha kulturore dhe në rrjete transmetuese në shekullin e 20-të. Është për t'u habitur se si statusi i atyre që lehtësojnë aktivitetin kulturor nuk përputhet me pozitën retorike që iu atribuohet.

Ndoshta për këtë ekzistojnë së paku dy arsye. E para është se qeveria iu jep rëndësi katër fushave themelore:

financimit, mbrojtjes, diplomacisë dhe sigurisë së brendshme. Pas kësaj, statusi varet nga shumta e buxhetit, kështu që shëndetësia, arsimiti, shërbimet sociale dhe transporti gjithmonë kanë prioritet më të lartë se kultura, edhe pse kultura është element i fuqishëm në shumicën e portofolëve të tjerë. Ministri i kulturës është në pozitë të veçantë të të qenit në krye të fushës që është më se afërmi me identitetin e komunitetit, duke mbajtur njëkohësisht pozitën në tavolinën qeveritare, të cilës i mungon ndikimi dhe pesha politike.

Ky është realiteti në pothuajse çdo administratë. Ky realitet është shkurtër dhe pa imagjinatë. Po të ishte kjo pozitë e kundërt – dhe po t'i jepej kulturës pozita e lartë ashtu siç i jepet punëve të jashtme – kreativiteti, besimi dhe dinamizmi i shteteve do të rritej dukshëm.

Arsyeja e dytë është se qeverisë i pëlqen të masë dhe të kontrollojë. Ajo dëshiron të dijë nëse resurset e ndara do të jenë në përputhje me rezultatet e arritura. Në lëmin e kulturës, kjo gjithmonë është e vështirë të arrihet. Kjo më lehtë arrihet në fushën e trashëgimisë, ku rezultatet e projekteve të planifikuara mirë lidhur me muzetë,



restaurimin dhe monumentet mund të shihen qartë. Kjo është më pak e lehtë me artin, ku produkti më i shtrenjtë mund të dalë të jetë mediokër, ndërsa këpucët punëdore mund të dalin të jenë më të ngulitura në mbamendjen e njerëzve për vite me radhë.

Në fakt, e njëjta pasiguri për rezultatin është evidente edhe për shumicën e fushave të tjera të shpenzimeve qeveritare. Nuk ka garanci se një armatim i shtrenjtë do të sjellë fitoren, se njerëzit me shkollim superior do të kenë karrierë superiore, se spitalet e shtrenjta do t'i shpëtojnë të gjithë pacientët e tyre, apo se një politikë e jashtme e shkëlqyeshme do të shmangë një fiasco politike. Mbi të gjitha, nuk ka dëshmi se një ministri e financave me buxhet të lartë do të ketë më shumë gjasa të drejtojë ekonominë më mirë sesa ajo me më pak buxhet.

Rreziku në kulturë duket më imediat dhe i drejtpërdrejtë sesa rreziqet në qeveri. Suksesit matet sipas kritereve subjektive, të cilat iu rezistojnë normave të matshme të sektorëve të tjerë. Ministri i arsimit, për shembull, mund të theksojë faktin se më shumë fëmijë po kalojnë testet. Zyrtari i shëndetësisë mund të thotë se më

pak njerëz po vdesin nga sëmundjet e mushkërive. Natyrisht, një ministër i kulturës mund të flasë për shifrat e vijueshmërisë së ngjarjeve kulturore, numrin e ekspozitave, dramave, filmave, librave apo të koncerteve ose edhe për zhvillimin e festivaleve. Megjithatë, numrat tregojnë shumë pak për cilësinë dhe asgjë për kënaqshmërinë e shoqërisë.

Financuesi i kulturës gjithmonë i nënshtrohet kritikave pas një mbrëmjeje të mjerueshme apo shokuese kulturore të qytetarit. Megjithatë, nëse dëshirojmë ta ruajmë mosndërrhyrjen në çështje artistike apo kurative, shumë pak mund ose duhet të bëjnë autoritetet në aspektin afatshkurtër. Kjo është vështirë për t'u kapërthyer nga mendja e një zyrtari. Në çdo fushë tjetër të përgjegjësisë, është detyrë e qeverisë që të menaxhojë dhe të sigurojë përmbushjen e standardeve, ndërsa në një pjesë më të madhe të sektorit të kulturës, kjo detyrë dallon. Këtu kemi të bëjmë me mundësimin e pastaj me qëndrimin anash. Nuk është çudi që autoritetet janë shumë më të kënaqura kur merren me ato fusha të kulturës në rastet kur kanë një shkallë të konsiderueshme të kontrollit, siç janë: trashëgimia e ndërtuar, legjislacioni

i planifikimit hapësinor, kultura në politikat e arsimit, standardet e qasjes fizike dhe politikat e mundësive të barabarta. Rreziku qëndron në atë se kur ballafaqohen me presione më të mëdha për arsyetimin e shpenzimeve, autoritetet e kulturës do t'i mbitheksojnë ato fusha ku rezultati është i matshëm në dëm të atyre që ngërthejnë në vete rrezikun burokratik, i cili është zemra e paprekshme e përvojës kulturore. Kur kjo të ndodhë, rezultati pashmangshmërisht do t'i zhgënjëjë ata që kanë avokuar për shtrëngimin e treguesve të politikave. Synimet e punësimit nuk do të arrihen. Interesi i publikut nuk do të zgjohet dhe politikat e kohezionit social do të kenë efektin shumë më të vogël sesa që kanë shpresuar promotorët e tyre. Në fund, punonjësi i kulturës duhet të ketë besim në talentin kreativ dhe të pranojë se, ashtu siç ndodh edhe me eksperimentet shkencore, shkalla e suksesit asnjëherë nuk do të jetë aq e lartë sa që do të dëshironin dhe se për çdo moment të madhështisë do të ketë disa momente të afërta me katastrofën. Çdo e mirë e ka të keqen e vet.

Në përgjithësi, qeveritë kanë pasur tendenca të jenë relativisht të mira në të kuptuarit e dallimeve mes përpjekjeve dhe rezultateve në praktikën e artit.

Nga ana tjetër, ligjvënësit, gazetarët që kërkojnë shembuj të çuarjes dëm të parave publike dhe qytetarët e zhgënjyer, apo të irrituar kanë qenë më pak tolerantë. Qeveritë e kanë më lehtë t'i arsyetojnë investimet e tyre kur përfshirja e tyre në kulturë vjen nga të kuptuarit se kjo është detyrë e të gjitha legjislaturave demokratike dhe se jeta kulturore është gjithmonë më e rëndësishme për një shoqëri të shëndoshë. Po ashtu, sa më i madh të jetë kontributi katalizues i parave publike, aq më shumë njerëzit do të kenë mundësinë që të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga puna cilësore.

Kohërat kur qeveritë e kanë të vështirë arsyetimin e shpenzimeve publike kanë tendenca të shfaqen kur argumenti për financim është i bazuar në përfitimet e tjera jokulturore që parashihen të vijnë nga investimet. Nëse kultura stimulohet për shkak të pritjeve për nxitjen e punësimit stabil, të një kohezioni më të madh shoqëror, të një shoqërie me më pak krim, të një rruge të shpejtë kah prosperiteti ekonomik apo të përmbushjes së synimeve politike, atëherë rezultatet nuk do t'i plotësojnë synimet. Në të vërtetë, jeta kulturore mund t'i plotësojë të gjitha këto objektiva në një kohë dhe shkallë të caktuar. Do të ketë raste kur do të

përfaqësojë strategjinë më të mirë. Por, ka edhe metoda të tjera (banim, arsim, mirëqenie dhe politika fiskale më të mira, për shembull), të cilat janë po aq të efektshme. Edhe pse aktiviteti kulturor për përfitime sociale mund të jetë opsioni më pak i kushtueshëm dhe më tërheqësi, i njëjti duhet të ofrohet njëkohësisht me nisma të tjera. Politikës që nuk ka hapësirë për kulturë do t'i mungojë një përbërës jetik, ndërsa politika që mbështetet vetëm në kulturë do të jetë e paqëndrueshme.

Megjithatë, ekziston një kuptueshmëri gjithnjë në rritje se kultura sjell “vlerë të shtuar” në punën e departamenteve të tjera të qeverisë. Në shumë raste, këto janë fusha tradicionale, të cilat, në një kohë apo në tjetrën, kanë qenë fokusi kryesor i aktiviteteve kulturore të qeverisë shumë para krijimit të konceptit të administratave të posaçme për kulturë. Avancimi i kulturës kombëtare apo mbretërore në punët e jashtme ka arritur kulmin e tij në oborret mbretërore të familjes Medici dhe të Luigjit të XIV-të të Francës, por ka edhe ekuivalentë nga kohërat e sotme moderne në shumë vende europiane. Shtetet që nuk promovojnë imazhin e tyre jashtë vendit përmes organizatave prezantuese ose emisioneve për botën e jashtme

janë të pakta. Shikuar më shumë nga aspekti rutinor, shumë pak aktivitete diplomatike (qofshin ato për argëtimin e personaliteteve të huaja gjatë vizitave në vend, apo përmes ambasadave jashtë vendit), organizohen pa ndonjë stimulim thelbësor nga jeta kulturore.

Ngjashëm me këtë, forcat e armatosura gjithmonë kanë pasur komunitete të forta artistike. Nganjëherë ata kanë qenë muzikantë të punësuar për të mbajtur lart moralin e trupave dhe për ta mposhtur armikun, nganjëherë artistët janë marrë në fushëbetetë për ta regjistruar atë në mënyra që shkojnë përtej kapaciteteve të një dokumentari fotografik, e nganjëherë ata kanë shkuar si poetë për t'i përkujtuar ngjarjet, për t'i ngrehur në qiell fitoret, apo për të regjistruar tmerrin dhe kotësinë e gjakderdhjes. Roli që ka pasur filmi dhe teatri në konfliktet e shek. XX, si në aspektin e ngritjes së moralit, ashtu edhe në atë të ofrimit të një burimi për reagimet komplekse ndaj luftës, ka qenë imponant. Duhet cekur se gjatë viteve 1980-ta, në Britaninë e Madhe është konstatuar se Ministria e Mbrojtjes ka shpenzuar më shumë para në muzikë sesa Këshilli i Arteve.

Arsimi natyrisht se ka një ndikim

të madh në kulturë, por gjithashtu ka elemente të kulturës që kanë të bëjnë me ministritë e zhvillimit, të mjedisit (me politikat e saj për komunitete të qëndrueshme, peizazhe dhe mbrojtje të arkitekturës), të bujqësisë, të shëndetësisë, si dhe me ministritë për mbrojtje sociale dhe punësim. Rrjedhimisht, duhet të ekzistojë nivel i lartë i bashkërendimit brenda të gjithë departamenteve në mënyrë që të krijohet një qasje gjithëpërfshirëse për shfrytëzimin e kulturës. Kjo nuk do të thotë se çdo ministri të mbrojë me ngulm territorin e saj burokratik, por duhet t'ia mundësojë qeverisë që t'i identifikojë mundësitë për përfshirjen e kulturës në një vistër të gjerë të politikave në mënyrë që të shihen efektet e tyre në jetën kulturore.

Financimi i kulturës nga resurset shtetërore ka një histori të gjatë dhe të respektueshme në Europë. Ky financim ka pasqyruar programet e tjera shtetërore duke shkuar përmes vijave të patronazhit aristokratik dhe mbretëror, të përforcuara nga Kisha, me një përfshirje të përnjëhershme të administratave të qyteteve e qytezave. Në shumë mënyra, niveli lokal ka mbetur më konsekuent se sa ai qendror. Kjo natyrisht ndodh pjesërisht për shkak

se strukturat e qytetit kanë ndryshuar më ngadalë se sa ato shtetërore (qofshin ato qendrore apo regionale). Megjithatë, kjo gjithashtu ndodh pjesërisht për shkak se nderi i qytetarisë i investuar në jetën e gjallë kulturore komunale gjithmonë është favorizuar nga një shumicë e politikanëve lokalë.

Në rastet ku është ruajtur një shkallë e lartë e pavarësisë dhe ku ka traditë të gjatë të përkrahjes, qytetet vazhdojnë të jenë niveli më aktiv i ofruesve të kulturës. Në fakt, do të ishte e drejtë të thuhet se pa zotimin e resurseve substanciale nga pushteti lokal, çfarëdo ofrimi kulturor nga niveli qendror vetëm se do të shtronte një infrastrukturë jo të duhur me një llak të paqëndrueshëm.

Andaj, qeveria duhet t'i ketë tri strategji të financimit: njëra që ka të bëjë me kontributin e saj vetanak, e dyta që ka për qëllim ruajtjen e nivelit të lartë të investimeve lokale dhe e treta që ka për qëllim shfrytëzimin sa më të mirë të mjeteve financiare që nuk i ka në kontroll të drejtpërdrejtë, pra, ato të sektorit privat. Megjithatë, një pjesë e madhe e parave publike gjen rrugën e tyre drejt kulturës, në realitet, pjesa më e madhe e shumës së gjithëmbarshme krijohet nga vetë sektori përmes burimeve të

tjera. Këtu përfshihen blerja e biletave dhe mallrave, donacionet, grantet e fondacioneve dhe sponsorizimet komerciale. Përderisa asnjëra nuk është dhuratë e qeverisë, të gjitha janë të ndikuara nga inkurajimi që vjen përmes politikave. Çmimet e biletave varen drejtpërdrejt nga suksesi që qeveria pret nga institucionet e kulturës dhe nga niveli i subvencionimit, me të cilin është e përgatitur të mbështesë atë pritje. Në kulturë, qeveria zgjedh se si dhe në çfarë niveli të ndërhyjë në këtë treg për të vënë në dispozicion punën e dëshirueshme, e cila ndoshta aktualisht nuk është popullore apo vetëmbështetëse.

Donacionet e individëve shpesh vijnë për shkak të dashurisë së mirëfilltë dhe zemërgjerësisë për artin dhe trashëgiminë. Mirëpo, ato ka gjasë të shtohen në rast se donatorëve iu lejohen lirime tatimore. Shtetet e Bashkuara e çojnë këtë parim në skajshmërinë e tij logjike, duke supozuar se parimi demokratik i zgjedhjes, historia e zemërgjerësisë për kauzat e mira lokale dhe aversioni ndaj tatimit, mund ta bëjnë kontributin federal ndaj tatimeve pothuajse të pandërlidhur me qeverinë, përveç përmes sistemit të dhënies së shumave të caktuara të parave dhe

donacionit relativisht të vogël nacional për artin. Kështu, ShBA-të pretendojnë se nuk kanë fare politikë të kulturës. Në fakt, politika e saj është e gjerë dhe e shtruar në hollësi, vetëm se nuk ka ndonjë departament specifik qeveritar që merret me të. Problemi me këtë qasje është se e përqendron financimin në disa institucione që janë tërheqëse për ata me xhepa të thellë. Kjo ka tendencë t'i bëjë kompanitë artistike konservative dhe të pasigurta. E vetmja mbrojtje që kanë nga dështimi financiar është ndonjë rezervë financiare që kanë krijuar gjatë viteve. Në realitet, këto rezerva shpesh nuk mjaftojnë dhe nuk mund ta parandalojnë katastrofën e kompanisë (edhe pse, siç mund të shihet më vonë, këto rezerva mund të jenë instrument i rëndësishëm). Në ShBA, vendet dhe programet universitare janë bërë fokus i inovacionit kulturor. Ato janë në gjendje të shfrytëzojnë bagazhin e madh intelektual dhe mjetet financiare për të ofruar një klimë eksperimentale, të cilën nuk mund ta ketë asnjë institucion artistik pa fonde domethënëse publike që nuk mund t'i kenë në dispozicion derisa donacionet të jenë llogaritur dhe tatimi të jetë paguar.

Nëse kjo barazi kthehet ndryshe dhe çdo organizatë ka një fond të

gatshëm për të pranuar donacione dhe për t'i shfrytëzuar ato si një mburojë, atëherë ato mund t'i japin stabilitetit një kontribut modest, por gjithnjë në rritje – për aq kohë sa qeveria nuk ndërpret apo kufizon financimin e saj, që do të ishte një veprim vetëhumbës, përmes të cilit dënohen organizatat për përpjekjen për t'i diversifikuar burimet e tyre financiare. Donacionet gjithashtu kanë një veprim të dobishëm anësor, iu japin anëtarëve eminentë të komunitetit një dozë të ndikimit personal në jetën kulturore. Donacioni paraqet një shkallë pronësie, e cila nga ana tjetër do të përkthehet në kujdes dhe përfshirje. Kjo mund t'i japë organizatës kulturore aleatë të fuqishëm dhe ndikues.

Grantet e fondacioneve janë gjithashtu burim i dobishëm, por, sikurse edhe sponsorimi, ato janë më të mira për përkrahjen e projekteve specifike sesa për dhënien e fondeve në baza të përditshme, të cilat e mbajnë organizatën gjallë. Mbështetja e tepërt në fondacione në fund do ta anojë punën kulturore ashtu që të pasqyrojë agjendën e fondacionit donator, e jo atë të vetë organizatës kulturore. Megjithatë, ka kohë kur granti mund t'i japë një projekt afatmesëm një lloj shtytjeje substanciale, për të cilën ka nevojë

që ta dëshmojë vetveten dhe të bëhet pjesë e rrjedhave kulturore. Përparësia e fondacioneve ndaj donatorëve të tjerë, qofshin ata komercialë apo individualë, është se ata rrallë herë ndodh që të kërkojnë njohjen e ndërlikuar dhe të shtrenjtë si kthim – kokteje, ceremoni, fushata të mëdha reklamuese, etj. Nga ana tjetër, mangësia ndërlidhet me faktin se fondacionet kanë kritere të rrepta të aplikimit, të cilat shpesh janë në kundërshtim me ato të fondacioneve dhe organeve publike të tjera. Drejtori i institucionit kulturor mund të ballafaqohet me humbjen e fondeve që janë në dispozicion, ose me largimin nga e vërteta strikte për t'iu përshtatur kritereve konkurruese.

Në fillim të viteve 1980-ta, sponsorizimi komercial u bë mënyrë moderne e grumbullimit të fondeve për art dhe trashëgimi. Kjo tendencë dukej të ketë filluar nga vlerësimi i gabuar britanik i praktikës së ShBA-ve, ku edhe pse afaristët japin donacione të mëdha si individë për arsye tatimore dhe sponsorët për shkaqe të publicitetit, praktika e përshtatjes komerciale të projekteve kulturore në fakt është relativisht e kufizuar. Bizneset nuk i japin parat e veta për asgjë, ata presin një kthim, qoftë përmes publicitetit të mirë të krijuar

nga projekti, apo nga rritja e njohjes së brendit, ose për shkak se ua mundëson që të ndërlidhen në mentalitetin e qytetarëve me vlerat shoqërore, të cilat nuk mund t'i demonstrojnë në mënyra të tjera. Kjo do të thotë se sponsorizimi është më i përshtatshëm për disa punë në fushën e kulturës sesa për disa të tjera. Shumë vepra të vogla apo eksperimentale kulturore nuk do të jenë në gjendje të tërheqin audiencë apo publicitet për të arsyetuar përfshirjen substanciale të afaristëve. Për organizata të mesme, sasia e punës së nevojshme shtesë për t'ua dhënë sponsorëve profilin që dëshirojnë, mund të jetë shpërqendrim i madh nga aspekti i kohës dhe energjisë së punonjësve, duke u larguar kështu nga qëllimet fillestare të projektit. Për institucionet e mëdha, brendimi përmes sponsorizimit mund të shpërqendrojë publikun nga fokusi i tyre artistik lidhur me fushatat e tyre publike, duke dështuar që të ofrojnë para të mjaftueshme në mënyrë që përshtatjet e bëra t'ia vlejnë.

Përveç kësaj, është me rëndësi të theksohet se sponsorizimi komercial rrallë herë kalon 10%-shin e buxhetit të organizatës (përpos në raste të disa festivaleve, ku rrethanat ofrojnë më shumë beneficione për sponsorët dhe

shteti është më pak i prirë që të japë përkrahje të vazhdueshme sesa në pjesët e tjera të sektorit). Zakonisht, zbatimi i tij gjen vend vetëm në nivel lokal. Derisa kompanitë janë shpesh shumëkombëshe, menaxhmenti dhe rrjetet e konsumatorëve janë zakonisht vendore ose regjionale, dhe ky është ai niveli ku merren vendimet për shumat relativisht të vogla të parave për sponsorizim. Në mesin e sponsorëve ka pak entuziazëm për përkrahjen e punës që duket si tërheqëse për audiencën. Sa iu përket projekteve ndërkombëtare, sponsorizimi është i vështirë për t'u tërhequr. Është interesant të theksohet se kompanitë që kanë përkrahur projekte që në thelb janë ndërkombëtare kanë tendenca të jenë ato që e shohin Europën si një treg, me fjalë të tjera ato janë kompanitë nga ShBA-ja, Japonia dhe Korea. Andaj, sponsorizimi, sikurse edhe burimet e tjera të financimit privat, është një shtesë e rëndësishme, por asnjëherë nuk mund t'ia zë vendin financimit të sigurt nga buxheti publik.

Këto janë pikat e dobëta. Pikat e mira nga ana tjetër janë në numër më të madh – për aq kohë sa roli i sponsorizimit nuk ka pritje të porealizueshme nga ana e qeverisë, organizatave kulturore dhe vetë sponsorëve. Biznesi fiton shumë

nga ndërlidhja e tij me grupet kulturore, dhe mund të mësojë nga kreativiteti dhe fleksibiliteti që karakterizon artin, si dhe nga marrëdhënia që krijon sektori i trashëgimisë me qytetarët. Kultura mbërrin drejtpërdrejt te pjesët e popullatës, veçanërisht te të rinjtë dhe të moshuarit, të cilat biznesi i gjen me vështirësi. Në ndërkohë, sektori i kulturës mund të shfrytëzojë më shumë se sa paratë e biznesit. Sofistikimi i marketingut të tij, qasja në shërbime, trajnimi dhe përkrahja teknike që operacionet komerciale mund të ofrojnë, iu japin organizatave të artit dhe trashëgimisë një dimension shtesë në avancimin dhe prezantimin e punës së tyre. Një projekt i mirë i sponsorizimit është gjithmonë ai ku njerëzit hyjnë në partneritet – ku diskutimet me sponsorët lidhur me drejtimin dhe fushëveprimin e projekteve shpesh mund t'i çojnë të dy palët në zgjerimin dhe përmirësimin e ideve të tyre fillestare.

Armiku i sponsorizimit të mirë është zhgënjimi. Nëse organizata kulturore është në pikën e rënies së saj apo kompania shfrytëzon sponsorizimin si një përpjekje të fundit për të arritur te tregu, atëherë kjo marrëdhënie është pothuajse e sigurt se do të përfundojë me lot. Për shkak se sponsorizimi

është burim shtesë i të hyrave, pra jo burim kryesor, më së miri funksionon kur të dyja palët janë mjaftueshëm të sigurt në fushën e tyre të veprimit për ta trajtuar sponsorizimin si një mundësi imagjinative, e jo si një fije kashte që do t'i shpëtojë nga mbytja. Për qeveritë, pjesëmarrja e bizneseve mund të paraqesë përkrahjen e vlefshme për politikën e tyre kulturore, por biznesi nuk duhet të lihet t'i mbledhë copëzat e thyera të jetës kulturore në rastet kur ministrat e financave humbin interesin, apo kur nuk mund t'i japin subvencionet e nevojshme.

Shpërbërja në Europën Lindore e pronësisë dhe kontrollit të plotë të ekonomisë nga shteti ka lënë një pyetje të madhe lidhur me trajtimin e trashëgimisë. Shumë punë që janë bërë kanë qenë mbresëlënëse. Shumica e vendeve të Europës Lindore kanë trashëguar një numër të madh të kompanive ku puna (edhe pse jo gjithmonë e dobishme) ka qenë e garantuar, çmimet kanë qenë të ulëta dhe qytetarët kanë pasur mjete për të marrë pjesë një ngjarjet kulturore – shpesh pa u pyetur nëse dëshironin apo jo. Por, kufizimet në lirinë e shprehjes, ngurtësimi burokratik i sistemit dhe fakti se asgjë nuk ka mundur të ndodhë pa



miratimin e autoriteteve, ka nënkuptuar se kur organet shtetërore u shkatërruan apo bankrotuan, diskreditimi u shpërnda nëpër institucionet që janë mbështetur në to. Andaj, tundimi ishte që të shtyheshin gjërat përpara përmes një revolucioni po aq traumatik siç ishte edhe ai që solli strukturat e pasluftës.

Që nga rënia e komunizmit është harxhuar energji e madhe në largimin e institucioneve nga sektori shtetëror dhe në hapjen e tyre drejt një konkurrence të plotë të tregut dhe të aksionarëve. Përderisa kjo është thelbësore për një industri efikase, ku qëllimi është që thjesht të prodhohen mallra për shitje, nga ana tjetër, kjo qasje është më pak e dobishme në rastet kur qëllimi kryesor i institucionit është i natyrës sociale, apo kur i njëjti është pjesë e infrastrukturës së establishmentit kulturor. Në njërën anë, të gjitha institucionet kanë nevojë për pavarësi të mjaftueshme për të realizuar punët e veta pa ndërhyrje burokratike. Ndërsa, nga ana tjetër, lidhja me shtetin mund të krijojë stabilitetin dhe një vend në ndërgjegjen kombëtare, të cilën privatizimi i plotë nuk mund ta bëjë.

Asnjë sistem artistik europian nuk ka funksionuar me sukses pa iu referuar pushtetit, brenda të cilit funksionon.

Kjo lidhje nuk është e thënë të jetë e drejtpërdrejtë. Ajo mund të ushtrohet përmes procedurave të llogaridhënies, për shembull, miratimi i anëtarëve të bordit, kushtet e parapara për pagesën e subvencionit dhe kushtet për publikimin e raporteve periodike. Mund të ketë, në fakt, duhet të ketë një normë ligjore, ku do të parashihej se shteti nuk ka të drejtë t'i shfrytëzojë këto mekanizma për të ndërhyrë në politikat artistike apo kuratoriale, edhe pse mund të ngulmojë për mbajtjen e standardeve të larta, për të dhënë llogari se ku dhe si shpenzohen paratë dhe për shfrytëzimin e të gjitha mënyrave për të arritur te publiku.

Në Europën Perëndimore përvoja e punës me sektorin privat të kulturës ka qenë e përzier. Sektori i kulturës, i cili shfrytëzon aftësitë dhe kreativitetin e krijuar përmes një sistemi të subvencioneve, ka pak nevojë që të funksionojë brenda kontekstit të autoritetit publik, dhe, në përgjithësi, këtë edhe nuk e bën. Ky sektor është shumëkombësh nga aspekti i shtrirjes, edhe në rastet kur talenti i tyre rrjedh nga niveli i vendit. Ka pasur një tendencë të

pushtetet perëndimore që t'i trajtojnë institucionet e tyre të varura kulturore si një marrëdhënie me të varfrin, ku të njëjtat janë në pozitë të kërkimit të vazhdueshëm të ndihmesës dhe në nevojë për t'ua përkujtuar herë pas herë se ata duhet t'i fitojnë pagat e tyre. Duket se i vetmi dallim i vërtetë mes institucioneve perëndimore dhe atyre të vjetra komuniste ishte kushti për kontrollimin e artit.

Siç është rasti edhe me fushat e tjera, baraspesha është çelës i suksesit. Në rastet kur shkalla më e madhe e lirisë do të rezultojë me injektimin e mjeteve financiare, me më shumë aventurë, me më pak burokraci të tejzgjatur dhe të shtrenjtë si dhe me një reputacion më të mirë, lidhja me shtetin duhet të jetë sa më e dobët që të jetë e mundur. Privatizimi duhet të jetë aq i plotë sa e kërkon interesi publik dhe kulturor. Në rastet kur privatizimi nënkupton lënien e institucionit të fundoset apo të notojë; në rastet kur nënkupton se shtetit më nuk i bën aq a do të mbijetojë ai institucion apo jo, atëherë privatizimi ka shkuar shumë larg.

Megjithatë, gjithmonë ka hapësirë për sektorin e gjallë privat, i cili fillon dhe vazhdon pa iu referuar autoriteteve.

Sektori privat mund të ketë nevojë për përkrahje të herëpashershme të projekteve, apo për fonde nismëtare nga shteti. Në këtë aspekt, ndihmesa për sektorin e kulturës nuk dallon nga ajo për çfarëdo lloj ndërmarrjeje tjetër. Artistët dhe ndërmarrësit e kulturës duhet të kenë aftësinë të fillojnë dhe të zhvillojnë nisma me inkurajimin, por jo domosdo edhe me ndikimin apo menaxhimin nga autoritetet publike. Përndryshe sektori do të ngeçë, institucionet nuk do të kenë dinamikë alternative dhe mosbesimi i qytetarëve ndaj qeverisë do të përhapet tek institucionet e kulturës, të cilat shihen si prezantuese të punës së tyre. Kultura nuk është asgjë nëse nuk është demokratike dhe nëse sektori privat ia mundëson kulturës që të zhvillohet përmes energjisë së individit e jo përmes planifikimit të institucioneve.

Megjithatë, vjen momenti kur puqen interesi i institucioneve, i autoriteteve publike dhe i ndërmarrjes private. Fleksibiliteti me të cilin politika është e aftë të merret me këtë puqje të interesave është ai që teston efektshmërinë. Nëse rezultati është një ndërmarrje e rigjallëruar, një partneritet me institucionet dhe autoritetet që duket i gjallë dhe jodogmatik, atëherë politika

do të paraqesë sukses. Andaj, qëllimi i qeverisë në të gjitha nivelet duhet të jetë stimulimi dhe lehtësimi dhe pastaj lirimi i rrugës.

# III. Nivelet e qeverisjes

*Sistemet duhet të ndryshohen dhe kjo është e vërteta. Paratë, fitimet dhe puna na amortizojnë, lopët e shenja të jetës sonë që nuk marrin parasysh presionet dhe kufizimet e vargut...*

**Gavin Ewart**

*Leaving Leeds*

Politika kulturore duhet të jetë ofrimi i mjeteve individit në mënyrë që ai ta hulumtojë trashëgiminë e të kaluarës dhe potencialin e të tashmes në kontekstin shoqëror. Për shkak se bazohet në përvojën individuale, por organizohet në nivel të përbashkët, ofrimi i ndihmës për kulturë përfshin çdo pjesë të qeverisë, agjencitë e saj, si dhe strukturat e shoqërisë civile, qofshin ato politike, komerciale apo altruiste. Kështu, pjesa më e madhe e politikave të menaxhimit përqendrohet në marrjen e vendimit për funksionet e secilit prej këtyre niveleve të ndryshme, që nganjëherë janë konkurruese, si dhe në përcaktimin e marrëdhënieve mes tyre.

Për shkak se çdo vend ka një baraspeshë të ndryshme mes autoriteteve civile, regjionale dhe kombëtare, agjencive autonome dhe gjysmautonome, si dhe shoqatave të lira, çdo vend gjithashtu ka kërkuar

të arrijë një rregullim të ndryshëm mes përgjegjësi relative. Sido që të jetë, një parim përshkon metodat më të suksesshme: që vendimi duhet të merret nga niveli më i afërm me pikën e ofrimit. Autoritetet e qytetit duhet të kujdesen për institucionet e qytetit, ato të kontekstit regjional nga qeveritë regjionale, ndërsa ato të paktat, që me të vërtetë janë qendrore, duhet të bashkëpunojnë me partnerin nacional. Megjithatë, çdo institucion kulturor do të ketë elemente të të tri fushave përkatëse. Festivali lokal mund të ketë rëndësi kombëtare, orkestra simfonike regjionale do të ketë publikun lokal të cilit do t'i shërbejë dhe do të duhet ta mbajë reputacionin ndërkombëtar. Rrjedhimisht, ekziston sistemi që njeh interesat e këtyre niveleve të ndryshme të llogaridhënies dhe nxjerr resurse nga të tria, duke u pajtuar se ku qëndrojnë përgjegjësitë kryesore. Vetëm kur të kërkohej që secili nivel të përfshihet, kontributi do të jetë evident.

Kjo baraspeshohet përmes një parimi tjetër, pra se duhet të ekzistojë gjithmonë e drejta e ankesës te niveli i autoritetit që është i afër ta shohë dispozitën në një kontekst më të gjerë. Rrjedhimisht, politika ndikon në lëvizjen e matricës së vendimmarrjes, me

drejtime që çojnë në anë të kundërta. Me fjalë të tjera, politika nuk mund të jetë gjithmonë e përshtatshme, pasi që ajo pasqyron tensionet dhe kundërthëniet strukturore të shoqërisë komplekse që i shërben, ku kultura është instrument i pasqyrimin të saj. Kjo do të thotë se gjithmonë do të ketë mospajtime, diskutime dhe acarime. Kjo nuk është çështje e zhgënjimit, edhe pse kreativiteti nuk prehet në rregullsi. Kështu, mund të themi se për të nxitur një lëvizje kërkohet të kemi elemente të konfliktit.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ndoshta funksioni parësor i autoritetit qendror është bashkërendimi i niveleve të ndryshme të interesit legjitim dhe marrja e vendimeve rreth tyre, duke përdorur si matës faktin se, fillimisht, nga rezultati duhet të përfitojnë qytetarët, së dyti ofruesi i shërbimit të kulturës dhe vetëm së treti autoritetet qeveritare. Në ato vende ku qeveritë lokale dhe regjionale i mbledhin vetë mjetet financiare, apo një pjesë të madhe të tyre, si dhe në ato vende ku të hyrat paguhen nga fondet qendrore me qëllim të shpërndarjes në nivele më të ulëta, detyra e qeverisë qendrore është e njëjtë: të sigurohet që të zotohet shuma minimale për të përmbajtur një

jetë të gjallë kulturore kudo që njerëzit jetojnë. Disa, në fakt shumë autoritete lokale mund të dëshirojnë që këtë ta përmirësojnë edhe më tej, duke kuptuar implikimet e rëndësishme lidhur me punësimin, turizmin dhe ndërtimin e imazhit që përfaqëson kultura. Ky aktivitet duhet të inkurajohet, ku qeveria qendrore ndihmon në avancimin e kulturës lokale në nivel vendi dhe në lehtësimin e zbatimit të programeve ndërkombëtare.

Në praktikë, qëllimi është që atyre që punojnë në fushën e kulturës t'i u afrohet qasja më e thjeshtë dhe më e drejtpërdrejtë e mundur në resurse dhe në instrumentet e autoriteteve publike. Vetëm nëse kjo rrugë është e shpejtë dhe e papenguar punonjësi i kulturës do të jetë në gjendje t'i shmangët procedurave të gjata dhe t'i hyjë punës së krijimit të lidhjes me audiencën. Nuk ka asgjë më të kotë se sa sorollatja prej një zyre dhe një komisioni në tjetrin, duke kërkuar marrëveshjen, kur shumica e parave në fjalë nuk meriton më shumë se një telefonatë.

Për shumicën e vendeve struktura që rrjedh nga këto parime do të ketë hapësirë që çdo nivel të ketë linja të qarta të autoritetit, me mekanizma për

lidhjen e diskutimeve prej poshtë-lart dhe anasjelltas përmes sistemit.

Në disa vende kjo ndërlikohet nga parimi i “gjatësisë së dorës”, përmes të cilit tentohet futja e një tampon zone mes sektorit të kulturës dhe atij të politikës. Derisa kjo politikanëve iu jep imazhin e heqjes së përgjegjësisë për punët e kulturës, gjë që mund t'i shqetësojë zgjedhësit, në realitet rrallëherë mbron sektorin e kulturës nga klima politike e ditës. Në rastin më të keq, mund t'i ndërlikojë edhe më tej mënyrat për ofrimin e resurseve. Në vend të lehtësimit të rrugës për organizatat e kulturës, shpesh ndërhyjnë në këtë rrugë, duke i dyfishuar proceset burokratike dhe duke ua mundësuar autoriteteve tërheqjen nga zotimi i resurseve të tyre dhe ndjekjen e një agjende që në vetvete mund t'ia vlejë, por që nuk iu shërben interesave të sektorit të kulturës apo atij publik. Një agjenci gjysmë e pavarur mund ta gjejë veten të zënë në mes, ku nuk do të jetë në gjendje as të detyrojë qeverinë të marrë një qëndrim pozitiv e as që të ofrojë resurse të mjaftueshme për plotësimin e nevojave imagjinare të organizatave të kulturës, apo të projekteve të individëve.

Nga ana tjetër e tij më e mirë, parimi

i “gjatësisë së dorës” ia mundëson qeverisë që të përqendrohet në politikën e përgjithshme dhe jo në punët e përditshme. Ky parim gjithashtu e mënjanon pushtetin nga marrja e vendimeve për çështjet e shijes dhe të nderit, të cilat, edhe pse turpëruese, janë çështje të audiencës dhe jo të pushtetit. Administrimi sipas parimit të “gjatësisë së dorës” gjithashtu ua mundëson organizatave të kulturës që të tregojnë pavarësinë e tyre për aq kohë sa kushtimisht dora të jetë e gjatë. Megjithatë, organi zyrtar ka rol të rëndësishëm, mund të japë një këshillë të mirë dhe të pavarur për autoritetet publike lidhur me drejtimin e politikës dhe shpërndarjen e fondeve. Nëse ky organ ka bazë statusore dhe nëse nga autoritetet kërkohet të japin arsyeime se pse këshilla po respektohet apo, më e rëndësishme, se pse nuk po respektohet, atëherë i tërë procesi i zbatimit të politikës kalon në terren të hapur. Organizatat kulturore mund t'i pranojnë vendimet apo të ankohen kundër tyre, duke ditur që procedurat janë transparente. Atyre mund të mos iu pëlqejë qoftë këshilla apo edhe vendimi, por së paku ato mund të sigurohen se që të dyja janë dhënë në mënyrë të drejtë. Futja e politikës kulturore në arenën e debatit publik është e vetmja mënyrë

për t'u siguruar në vitalitetin e saj të vazhdueshëm dhe në llogaridhënie ndaj të gjitha palëve me interes. Kultura është aq shumë e rëndësishme për atmosferën e shoqërisë sa që nuk mund të lejohet që ofrimi i resurseve për të të futet nën vellon e interesave të mjegullta jolegjitime.

Pasi që për këtë të jetë arritur pajtimi, gjithashtu duhet të shtrohet pyetja se sa organe duhet të krijohen për të dhënë këshilla. Shoqëria civile do të japë këshillat e veta së bashku me ato që do të vijnë nga institucionet zyrtare. Rrjeti i interesave kulturore do të ofrojë raporte, lista të kërkesave, komente për legjislacionin dhe propozime për zhvillim. Ata duhet të inkurajohen. Në fakt, autoritetet publike janë të mençura që t'u japin të hyra këtyre rrjeteve, si dhe institucioneve individuale të kulturës dhe organeve zyrtare. Rrjetet mund të ofrojnë qasje alternative, të cilat organet zyrtare janë shumë të kufizuara t'i japin për shkak të politikës së trashëguar. Po ashtu, rrjetet ofrojnë një bazë më të gjerë për zhvillimin e politikës sesa cilido institucion individual, duke mbrojtur kështu bazën e tyre të financimit dhe projektet. Është pjesë e fushës së politikave të kulturës që të sigurohet se shoqëria bashkohet lirshëm dhe

në mënyrë energjetike për të siguruar zhvillimin.

Në vitet 1990-ta, rrjetet u bënë emërtim i përgjithshëm që ngërthenin kontaktet joformale mes kolegëve profesionistë, të organizuar jo në mënyrë strikte nën një emërtim të përbashkët së bashku me Organizatat Joqeveritare (OJQ) të themeluara më herët dhe të rrënjosura në sektorët e caktuar të jetës kulturore. Këto rrjete përforcuan shoqatat profesionale, të cilat vlerësojnë statusin profesional dhe nganjëherë negociojnë në emër të anëtarëve (të kuptuarit e përgjithshëm të terminologjisë nuk përfshin sindikatat e mirëfillta që kanë kompetenca për realizimin e marrëveshjeve kolektive). Këto rrjete funksionojnë paralelisht me qeverinë, kështu që ato ekzistojnë në të gjitha nivelet. Pasi që jeta kulturore po bëhet gjithnjë e më shumë më e ndjeshme ndaj presioneve regjionale e globale, rrjetet nacionale janë duke i bashkuar forcat me ato europiane dhe botërore.

Megjithatë, këto nuk janë vetëm federata të interesave nacionale. Shpesh ato janë të hapura për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të individëve apo grupeve, të cilët nuk pasqyrojnë ndonjë përkatësi të dukshme nacionale, duke dalluar

kështu dukshëm nga organizatat ndërkombëtare, të themeluara nga qeveritë, të cilat (pothuajse pa përjashtime) mbajnë strukturën e anëtarësisë në bazë të shtetit komb. Ky dallim nga modeli zyrtar do të thotë se rrjetet u ofrojnë qeverive një alternativë, të cilën ka pak gjasa ta gjejnë brenda korridoreve të tyre. Për shkak të fleksibilitetit të tyre, ata që janë të përfshirë në rrjet mund të jenë, siç është rasti me departamentet universitare, një burim i përshtatshëm i këshillave të pavarura – edhe nëse pagesa e kësaj këshille do të shkaktonte disa net pa gjumë tek ata që përpiqen të përcaktojnë se nga cila pjesë e buxhetit të departamentiit duhet të vijë subvencioni.

Në ndërkohë qeveria tundohet për krijimin e organeve gjysmë të pavarura, ku secili prej tyre merret me një segment specifik të jetës kulturore. Në rastet kur ka dyshime për drejtimin e politikës, apo kur dëshirohet që konsensusi të luhetet, është gjithmonë më lehtë të krijohet një ngjashmëri e vendosmërisë, duke zbuluar edhe një organ tjetër këshillëdhënës apo, çka është edhe më e përshtatshme, një organ rival ndaj atij që ka pasur guximin të dalë me një mendim tjetër. Në fund kjo vetëm rezulton me dyfishimin dhe përzjerjen

e funksioneve, ashtu që ndarja e një pjese relativisht të vogël të buxhetit të përgjithshëm të shtetit, bëhet pjesë e një grupi krejt të panevojshëm të ndërmjetësuesve. Kultura është e ndërlikuar, por nuk ka arsye pse qeverisja e saj duhet të jetë e fillë.

Problemi më i madh i politikanëve dhe artistëve në Europë është përgatitja profesionale e zyrtarëve që i zbatojnë politikat. Kjo është posaçërisht e evidente kur kemi të bëjmë me zyrtarët e nivelit të mesëm, veçanërisht ata që i kanë mbijetuar turbulencës së ndryshimit të rrethanave politike, bagazhi profesional i të cilëve është formuar në kushte më ekstreme ideologjike të fundit të viteve 1970-ta dhe të viteve 1980-ta. Problemi zakonisht duket të jetë mungesa e ekspertizës, dhe jo mungesa e gatishmërisë. Shpesh ata që kalojnë në institucionet zyrtare pas një karriere të suksesshme në menaxhimin e kulturës nuk kanë shkathtësitë e nevojshme për të vepruar në një botë më abstrakte të formimit dhe realizimit të politikave. Ngjashëm me këtë, ata që punojnë si zyrtarë që nga fillimi dështojnë t'i kuptojnë ndërlikueshmëritë dhe veçantitë e sektorit të kulturës dhe aplikojnë qëndrimet e njëjta ndaj teatrit e muzikës, sikurse që do t'i aplikonin edhe



ndaj asfaltimit të rrugës apo planifikimit ekonomik.

Ekziston tendenca për të supozuar se ata që nuk kanë ndonjë pozitë zyrtare nuk mund të llogariten, apo janë aq shumë larg strukturave normale të shoqërisë, sa që trajtohen me jokuptueshmëri patronizuese. Pak zyrtarë kuptojnë në të vërtetë punën e përditshme dhe kërkesat e një instrumentisti të orkestrës, një aktori, piktori, poeti apo koreografi, e as mënyrat e padukshme, përmes të cilave ata lidhen me publikun. Dikush mund të thotë se kjo ndodh kështu, sepse një kompozitor mesatar po ashtu nuk ka pasqyrë të plotë të jetës së një zyrtari (përveç faktit se nuk ka dëshirë ta imitojë atë).

Ngjashëm me këtë, ndjeshmëria për t'u marrë me kulturë ka nevojë për vizion dhe vetëbesim për të zbatuar rregullat dhe rregulloret në mënyrë delikate, duke kuptuar dhe përshtatur idetë që dalin jashtë kufijve të kritereve të përcaktuara. Njëkohësisht, nevoja për transparencë, për procedurat që të shihen si të drejta dhe të hapura, kërkon tolerancë dhe mençuri nga zyrtarët, të cilët nuk i kanë borxh asgjë autoritetit, por që të gjitha i kanë arritur falë integritetit personal.

Autoriteti dhe distinktivët e zyrave rrezatojnë me pak respekt në sektorin e kulturës – edhe pse profesionistët e kulturës e dinë se ku qëndron pushteti, siç e dinë edhe të gjithë të tjerët – por respekti që iu jepet atyre që shihen si aleatë të vërtetë të kauzës së kulturës është tejet i madh.

Në mënyrë që ta japin më të mirën e tyre, zyrtarët e kulturës duhet të kenë njohuri të dorës së parë të sektorit të kulturës që parashihen ta drejtojnë. Kështu, ka nevojë të ekzistojë një strukturë e trajnimit, qoftë përmes shkollimit universitar pasdiplomik, ose përmes ndërrimit të detyrës (secondment) pas punësimit në administratë. Për më tepër, trajnimi duhet të shtrihet në dy drejtime, duke i ndihmuar ata që lëvizin nga profesionet e kulturës në qeveri që të mësojnë si t'i hartojnë politikat dhe t'i ndërtojnë proceset e vendimmarrjes institucionale.

Në mënyrë që kjo të funksionojë efektshëm, karriera e një zyrtari në departamentin e kulturës duhet të shihet si e vlefshme dhe e dëshirueshme. Nuk do të ishte mirë nëse një vend pune në sektorin e kulturës konsiderohet si një ngecje profesionale, apo si tregues se zyrtari ka pak gjasa të ngrihet në

hierarki. Shpesh konsiderohet se përvoja në menaxhimin e kulturës është jo shumë e vlefshme, apo e dorës së dytë. Kjo ngjason me faktin se shijimi i kulturës është shpesh diçka që njerëzit e bëjnë kur nuk janë duke punuar, andaj kjo do të thotë se ata që ofrojnë kulturën janë vetë në një shfaqje. Kjo është zgjatim i pyetjes së vjetër, nëpër të cilën ka kaluar pothuajse çdo artist herët a vonë në ndonjërin nga ahengjet e organizuara. Kur ata thonë se shkruajnë ose performojnë, atëherë zakonisht vjen pyetja se çka bëjnë gjatë ditës në kuadër të punës së tyre të vërtetë. Ky diskriminim iu bëhet zyrtarëve të kulturës dhe ka rezultate shkatërrimtare. Kjo e demotivon punonjësën, e zvogëlon autoritetin e tij me rastin e kërkimit të resurseve dhe siguron që denigrimi të bëhet vetëpërmbushës; atëherë departamentet e kulturës pranojnë zyrtarë, të cilëve pjesët e tjera të sistemit nuk iu besojnë. Kështu që ata përfundojnë duke mos dhënë shërbime të duhura si për politikanët, ashtu edhe për sektorin ku punojnë.

Ato vende që kanë politikat e njëjta të punësimit të zyrtarëve më premtues si për sektorin e kulturës ashtu edhe për atë të ekonomisë, bie fjala, ose të arsimit, do të kenë sistemin më

efikas. Gjithashtu, zbatimi i politikave në këtë rast do të jetë më i lehtë dhe më i lirë. Sa më i madh që të jetë besimi i ndërsjellë mes qytetarëve, profesionistëve dhe aparatit qeveritar, aq më e drejtpërdrejtë mund të jetë marrëdhënia financiare dhe më e vogël do të jetë nevoja për organe të ndërmjetme të nevojshme për krijimin e baraspeshës në pushtet, në të cilët duhet të mbështetet demokracia që është në dështim e sipër.

Zyrtarët e trajnuar mirë dhe me vetëbesim do të jenë më pak mbrojtës ndaj autoritetit të tyre, më të gatshëm që të delegojnë dhe decentralizojnë, apo për të njohur nevojën për vetëdijesim lidhur me politikat e ndryshme të nevojshme për t'i shërbyer një shoqërie komplekse. Siç ndodh edhe me shërbimet shëndetësore dhe të arsimit, kultura duhet të marrë parasysh shumësinë e stileve jetësore moderne – ndarjen mes traditës urbane dhe asaj rurale dhe pozitën diku në mes të qytezave të vogla provinciale, përzierjen kozmopolite në qytete dhe pritjet e ndryshme nga kultura që rrjedhin nga mosha dhe të hyrat. Kësaj politikëbërësi i kulturës gjithmonë duhet t'ia shtojë historinë dhe gjuhën – dy shtyllat e mëdha të identitetit dhe më kryesoret kur

kemi të bëjmë me kënaqjen e secilit.

Nuk ekziston një model i përkryer për ta siguruar këtë. Çdo vend ka traditat e veta të ndryshme që e udhëheqin. Megjithatë, disa tregues ekzistojnë. Në rastet kur ekziston identifikimi mes territorit dhe kulturës lokale apo regjionale, atëherë politikat kulturore duhet të administrohen në atë nivel. Qeveria qendrore duhet ta kufizojë rolin e vet në mundësimin e profesionistëve dhe institucioneve të kulturës ta zgjerojnë punën e tyre jashtë lokalitetit, edhe pse autoritetet lokale mund të dëshirojnë ta bëjnë një pjesë të kësaj pune me qëllim të avancimit të imazhit të tyre. Qytetet duhet të kenë stimulime të mëdha për të ruajtur infrastrukturën e tyre kulturore, por gjithashtu duhet të ekzistojë mirëkuptimi që vendet rurale dhe paratjet gjithashtu të trajtohen me kujdes, qoftë përmes ndonjë mekanizmi të veçantë apo përmes zgjerimit të kufijve të përgjegjësive së qytetit. Disa institucione dhe vende të trashëgimisë do të kenë rëndësinë nacionale dhe përgjegjësia për to duhet të jetë në nivel qendror, madje edhe nëse bartet kompetenca për menaxhimin e punëve të përditshme.

Derisa themelohen këto sisteme

kulturore dhe administrative, nuk duhet të harrohet se qëllimi i politikës kulturore është bashkimi dhe jo ndarja. Në mbarë Europën janë duke u bërë përpjekje që të minimizohet rëndësia e kufijve, të zhvillohen sistemet bashkëpunuese dhe të lehtësohet lëvizshmëria. Njerëzit do të ndihen të sigurt në këtë proces vetëm nëse janë të vlerësuar dhe nëse ndjenja e tyre e përkatësisë respektohet. Kështu, me zvogëlimin e rëndësisë së kufijve administrativë, bëhet gjithnjë e më e rëndësishme që njerëzve t'iu jepet një kontekst kulturor që ua mundëson atyre të kenë një ndjenjë të fuqishme se kush janë dhe ku janë. Sfida për qeveritë e Europës në shekullin njëzetentë është ruajtja e dëshirës së njerëzve për identitet dhe vetëvendosje, duke ecur lehtësisht brenda sistemit federal dhe global të ligjeve dhe tregtisë. Kjo detyrë nuk është e lehtë. Nacionalizimi shkatërrimtar ka qenë mallkimi i Europës që nga themelimi i shteteve kombe në fillim të mijëvjeçarit të kaluar. Gjetja e mënyrës për baraspeshimin e dëshirës për rrënjë të fuqishme dhe gjithëpërfshirëse me dëshirën po aq të fuqishme për një botë të lirë, të hapur dhe tolerante, që respekton vlerat e liberalizimit dhe prosperitetit do të na konsumojë të gjithëve.

## IV. Objektivat politike

*Ariosto, ndoshta kjo kohë do të  
zhduket  
Dhe do të derdhim Detin tënd Azur  
dhe Detin tonë të Zi së bashku një të  
ngjyrë të kaltër vëllazërore.  
Edhe ne e dimë këtë mirë. Kemi pirë  
së bashku në këto brigje.*

### **Osip Mandelstam**

*Ariosto*

Nëse një objektivi politik i politikës kulturore është kohezioni i shoqërisë si reagim ndaj presioneve mbi kulturën, duhet të theksohet se ka edhe shumë të tjerë. Disa janë objektiva për të cilat kultura është njëri nga shumë instrumentet e përshtatshme. Disa të tjerë janë objektiva që janë në përputhje me vetë kulturën. Këto nuk duhet të përzihen me objektivat e menaxhimit të kulturës dhe me ofrimin e saj – kjo do të trajtohet në kapitullin e ardhshëm – por, pavarësisht kësaj, ato janë çështjet që do të diktojnë tonin e diskursit mes partive politike dhe formuesve të opinionit lidhur me qëllimet e qeverisë.

Megjithatë, ekziston një objektivi themelor, përmes së cilit duhet të drejtohen marrëdhëniet mes sektorit të kulturës dhe autoriteteve. Duhet të caktohet korniza e politikave, ndërsa

mekanizmat e saj duhet të rafinohen. Qëllimet e saj duhet të bëhen të qarta dhe fondet duhet të ofrohen. Pastaj qeveria duhet të qëndrojë anash dhe të lejojë komunitetin e kulturës, qoftë ai profesional apo amator, që të vazhdojë me stimulimin dhe pasurimin e kulturës. Qeveria do ta dijë se është duke arritur rezultat me politikën e saj kur dora e saj të jetë e padukshme, pra, kur të gjithë flasin për vetë kulturën dhe jo për atë se si menaxhohet ajo.

Gjithashtu, ka më shumë objektiva të përgjithshme për Europën, të cilat ndërlidhen me kontekstin më të gjerë politik dhe social. Asnjë shoqëri moderne evropiane nuk është homogjene. Madje edhe ato që janë përpjekur që në mënyrën më brutale të përjashtojnë çdokënd që nuk iu përshtatet kriterëve të imponuara etnike ose gjuhësore, janë komunitete të përziera. Nuk ekziston askush në Europë, anëtarët e familjeve nga komunitetet e ndryshme të të cilëve nuk janë martuar mes vete, nuk kanë emigruar apo nuk kanë përjetuar përvojën e vendit tjetër. Etiketat e përshtatshme të nacionalitetit, të vendbanimit dhe të mbiemrit në fakt japin një nga indikacionet më të mjegullta të prejardhjes së vërtetë të personit. Madje edhe në fshatra

që duket se të kthejnë prapa në të kaluarën sharmante, kjo pasqyrë është iluzion. Ferat kanë ndryshuar pronarët; ata kanë ardhur e shkuar; fëmijët janë martuar me të huaj apo janë shpërngulur, të tjerë kanë ardhur pas luftërave duke kërkuar punë, ose (në rastin e shumë artistëve), një shkallë vetmie dhe standard më të lirë të jetesës. Konteksti kulturor vazhdimisht është duke ndryshuar. Gjuhët zgjerohen dhe tkurren sipas tekeve të atyre që i flasin, edhe madje kur bëhen përpjekje të mëdha zyrtare që të mbahen nën kontroll, të shpallen të jashtëligjshme apo të rizbulohen.

Ruajtja e gjuhëve të vjetra europiane ka rëndësi jetike, jo sepse paraqet vetëdijen nacionale – në shumicën e rasteve gjuhët janë folur shumë kohë para se nocioni politik i *patrias* të bëhej i njohur – por, sepse paraqesin pasurinë e mendimit dhe të shprehjes europiane. Ta humbësh aftësinë e të kuptuarit të letërsisë në formën e saj origjinale do të thotë ta humbasësh pjesën më të madhe të fuqisë së saj estetike. Gjithashtu, kjo do të kufizonte përgjithmonë shkallën e të shprehurit të europianëve. Në këtë kuptim, llojshmëria e jonë gjuhësore është e ngjashme me biodiversitetin në botën e natyrës. Pasuria gjuhësore

nuk është e kufizuar vetëm në gjuhët kombëtare brenda kufijve kombëtarë. Të gjitha vendet europiane kanë komunitete, të cilët flasin qoftë gjuhën autoktone të veten apo atë të vendit fqinj (ose, gjithnjë e më shumë, gjuhën e një pjese joeuropiane të botës). Importimi i fjalëve ka qenë metoda, përmes së cilës gjuhët janë pasuruar. Andaj, kultivimi i llojshmërisë gjuhësore nuk do të thotë dobësim i unitetit nacional, por nënkupton investim në një kulturë të gjallë dhe dinamike.

Gjuha angleze është një shembull interesant. Edhe pse është një ndër gjuhët më të përhapura, shkrimet më të bukura moderne nuk vijnë nga autorët që flasin gjuhën e saktë akademike, por nga ata fjalori dhe vistri shprehës i të cilëve ndikohet nga gjuhët e tjera autoktone: ato të Karaibeve, të nënkontinentit indian, të Afrikës apo të regjioneve kelte të Britanisë. Nëse këto gjuhë do të humbnin, apo komunitetet e tyre do të rrezikoheshin, atëherë do të vuante letërsia angleze po aq sa edhe të tyret. Me fjalë të tjera, potenciali nacional plotësohet jo duke i kufizuar gjuhët, por duke siguruar praninë e sa më shumë gjuhëve të folura në atë territor. Vitaliteti gjuhësor i jep vlerë krijimtarisë së përgjithshme të kombit dhe ndikimit të tij

në botë. Fëmijët që janë rritur duke folur më shumë se një gjuhë, shpesh tregojnë mprehtësi më të madhe të mendimit dhe të vetëbesimit në lëndë të tjera (kjo vlen edhe për ata që mësojnë t'i bien një instrumenti muzikor).

Përbushja e potencialit – ose ndoshta thënë më saktë, dhënia e ndihmesës individëve në përbushjen e potencialit të tyre – është qëllimi kryesor i politikave të kulturës. Të gjithë mekanizmat e arsimit, të të drejtave të autorit, të infrastrukturës, të qasshmërisë, të ruajtjes dhe të pjesëmarrjes rrjedhin nga kjo. Në mënyrë që potenciali individual (që zgjerohet edhe në atë nacional) të plotësohet, liria e shprehjes, llogaridhënia demokratike dhe vendimmarrja e deleguar kanë rëndësi të vazhdueshme. Brenda tyre kemi edhe detyrat shtesë të rëndësisë së njëjtë; stimulimi i krijimtarisë dhe pajisja e popullatës që të kenë aftësinë fizike, të hyrat dhe njohuritë për të përfitur nga rezultati. Kjo është fuqizimi që njerëzve ua ofron mundësinë të kontribuojnë, jo vetëm për mirëqenien e tyre, por edhe për pasurinë kulturore dhe materiale të botës. Ky është një koncept i madh dhe çfarëdo kufizimesh dhe acarimesh ditore nuk mund ta prishin madhëshinë e tij.

Qasja është bërë fjala kyçe për

mbulimin e një numri politikash të nevojshme për t'i vënë në kontakt njerëzit me kulturën e tyre. Këtu përfshihet edhe kushti për qasje fizike – ftesat për hapjet solemne, objekte miqësore për personat me aftësi të kufizuara, shërbime të integruara të transportit për në vendet e rëndësishme të trashëgimisë kulturore dhe të arteve, aranzhime të përshtatshme për fëmijët dhe të moshuarit. Këtu gjithashtu përfshihet edhe qasja sociale – dhënia e informatave në mënyrë më të lehtë dhe më të përshtatshme për njerëzit, duke siguruar njëkohësisht çmime të ulëta të biletave në mënyrë që të gjithëve t'iu jepet mundësia për të ardhur, si dhe duke i bërë vizitat e ekspozitave artistike të veçanta dhe tërheqëse, duke evituar prej tyre snobizmin apo ngacmimin.

Një pjesë e detyrës ka të bëjë edhe me sistemin edukativ-arsimor, i cili do të shthjellohet në kapitullin e radhës, por vlen të theksohet se arsimit nuk realizohet vetëm në klasë të shkollave dhe të fakulteteve. Shkollimi realizohet po aq në mënyrë efektive përmes një forme më subtile të transmetimeve televizive, bibliotekave, arkivave dhe teknologjive të reja. Bibliotekat janë veçanërisht të rëndësishme në rastet kur njerëzit nuk kanë para të blejnë librat,

revistat dhe CD-të. Ato gjithashtu mund të shërbejnë si qendra të resurseve, të pajisura me kompjuterë dhe pajisje audio, seksione të referencave dhe me punonjës që mund të japin informata se si dhe ku të kërkohen informatat. Biblioteka mund të bëhet strumbullar i një jete hulumtuese të qytetarit, duke paraqitur një rrugë për fitimin e njohurive, të cilën raftet e bibliotekave private nuk mund ta ofrojnë. Ngjashëm me këtë, arkivat i ruajnë kujtimet e së kaluarës, materialet që presin për t'u zbuluar dhe vetëpërcaktimin tonë. Ato paraqesin regjistrat e civilizimit. Ruajtja dhe disponimi i tyre është thelbësore në mënyrë që ne ta kuptojmë historinë.

Gjithmonë ekziston një presion i madh ndaj autoriteteve që t'ua lejojnë transmetuesve komercialë animin e pakufizuar në transmetimin e programeve, mu sikurse në shumë vende kemi presionin nga reklamuesit për të transmetuar programe që parashikohen për një masë të llogaritshme të audiencës. Megjithatë, nuk do të ishte kufizim i lirisë komerciale që të ngulmohet që transmetimet t'iu përshtaten të gjitha shijeve kulturore, duke përfshirë edhe ato që janë pakicë. Ne të gjithë jemi pjesë e pakicës së shijes, qofshin shijet tona të lidhura

me ushqimin, muzikën, modën apo me ekipin e futbollit. Mbulimi i një spektri të gjerë të shijeve shkon në dobi të transmetuesit. Në fakt, ofrimi i emisioneve radio-televizive të cilësisë së lartë rrit mundësinë për shikueshmëri nga një numër më i madh i njerëzve. Transmetimet e poezisë dhe dramave, të muzikës klasike dhe të vallëzimit, të operës dhe artit duhet të jenë në qendër të programeve transmetuese. Këto programe ndoshta nuk mund të arrijnë tek aq njerëz sa mund të arrijnë, bie fjala, ndeshjet e kupës botërore të futbollit, por ato shikohen dhe dëgjohen me qindra herë më shumë sesa që është numri i atyre që shkojnë në teatër, sallën e koncerteve apo atyre që do ta përzgjidhnin një libër në librari. Gjithashtu është e rëndësishme të ceket se paraqitja e artistëve përmes kanaleve televizive i familjarizon ata me njerëzit, duke rritur kështu mundësinë që audiencia t'i ndjekë koncertet apo manifestimet e tyre drejtpërdrejt. Ky proces i njoftimit dhe familjarizimit është po aq edukativ sa është edhe studimi akademik.

Të bashkuar në qasje do të thotë proces i pjesëmarrjes. Kultura nuk është kohë e lirë pasive, por ka të bëjë me interesimin dhe përfshirjen aktive. Në

fakt, është e arsyeshme të thuhet se sikurse sporti, apo ndonjë shkathtësi tjetër praktike, njeriu më shumë mëson nga praktikimi sesa nga të studiuarit e kulturës. Qoftë përmes gërmimeve arkeologjike, shkrimit të poezive, pjesëmarrjes në grup muzikor apo në një trupë lokale të teatrit; ata që hulumtojnë potencialin e tyre kulturor janë audiencia më e informuar për profesionistët. Andaj, do të ishte shumë e dobishme për institucionet profesionale të bashkohen me amatorët afër tyre dhe t’iu ndihmojnë atyre. Kjo mund të bëhet në mënyra të shumta, duke filluar nga organizimi i punëtorive, huazimi i pajisjeve dhe i punonjësve teknikë të kualifikuar (bie fjala, kostumeve dhe ndriçimit, regjisorëve dhe mjeshtërvë të ndriçimit) dhe hapja e hapësirave për prova dhe shfaqje, e deri të përfshirja e amatorëve në punën profesionale të organizatës në cilindo nivel që ekspertiza e tyre e arsyeton.

Profesionalizmi gjithmonë ka shkuar paralelisht me amatorizmin e arrirë në jetën kulturore europiane. Si e ka fituar bukën e gojës një artist krijues shpesh ka qenë e parëndësishme për cilësinë e artit (edhe pse jo për rezultatin). Kompozitorët paraqesin shembullin më eklatant – Borodini

(profesor i Kimisë), Charles Ives (agjent sigurimesh), Frederiku i Madh (mbreti i Prusisë) – ndërsa poetët dhe dramaturgët nuk janë shumë më të pakët. A ishte Sir John Vanburgh më pak shkrimtar (i dy dramave më komike në gjuhën angleze, *The Relapse dhe The Provok'd Wife*) për shkak të faktit se ai gjithashtu ka dizajnuar pallatet madhështore të Kështjellës Houard dhe Blenhei, apo Michelangelo a ka qenë më pak skulptor për shkak të faktit se ka shkruar sonete të shkëlqyeshme dhe ka dizajnuar fortifikatat e Firencës? Edhe nëse e marrim një nivel më pak të njohur, gjegjësisht traditat amatore të këngëve korale të Hungarisë, Holandës dhe Britanisë, grupet e instrumentistëve frymorë, miliona njerëz që pikturojnë për dëshirën e tyre dhe jo për para, paraqesin një resurs kulturor të një vlere shumë të madhe.

Po ashtu të rëndësishëm janë ata që ruajnë vlerat e mjeshtërisë, apo edhe që i çojnë ato përpara: argjendarët dhe mjeshtrit e çative të kashtës, kaligrafët dhe muratorët, mjeshtrit e argjilës dhe libralidhësit, leshlnurësit dhe zdruktharët. Politika e kulturës duhet ta marrë parasysh udhëkryqin mes kulturës dhe industrisë së vogël, e cila jo vetëm që dukshëm kontribuon



në punësim dhe përparim, por edhe u ofron kulturave lokale dallueshmëri dhe gjallëri. Andaj, do të ishte një gabim i madh që politikat e përkrahjes të drejtohen tërësisht drejt institucioneve të mëdha apo ndërmarrësve të mëdhenj. Në shumë mënyra, tapiceria e kulturës është më e rëndësishme, ruajtja e kontakteve të njerëzve me trashëgiminë dhe shfrytëzimi i krijimtarisë së tyre aq sa dinë dhe munden brenda çfarëdo konteksti ekonomik ku mund të punojnë.

Shpesh janë nismat më pak spektakolare (që nuk hyjnë brenda kryetitujve) ato që ruajnë gjallërinë e bashkësive të izoluara, parandalojnë që qytetet të bëhen kopje monotone të njëri-tjetrit dhe ua mundësojnë grupeve të pakicave dhe të emigrantëve t'i shpërfaqin shkathtësitë dhe aftësitë e tyre dalluese, duke i kontribuar njëkohësisht shoqërisë. Ato mund t'u japin grupeve të disavantazuara vetëbesim dhe krenari dhe, çka është edhe më e rëndësishme, një hapësirë për të demonstruar talentin e tyre, duke ua dhënë një pikë hyrëse në rrjedhat e përgjithshme ekonomike. Shpesh aktivitetet e tilla rezultojnë me punësim të pavarur për femrat e komunitetit, ku roli i tyre përndryshe do të ishte i cunguar nga kufizimet shoqërore dhe

historike.

Këto zanate shpesh paraqesin disa nga mënyrat më të thjeshta dhe më efikase të nxitjes së dialogut mes komuniteteve, të cilat ngurrojnë t'i afrohen njëra-tjetrës. Admirimi i aftësive, blerja e punës dhe diskutimet që rezultojnë, mund të jenë një hap i vogël, por i rëndësishëm për luftimin e mosbesimit mes komuniteteve. Megjithatë, zyrtarët duhet të jenë të kujdesshëm që të mos i stereotipizojnë ata që janë aktivë në aktivitete kulturore të nivelit të vogël, posaçërisht pakicat. Nganjëherë është më lehtë të shtiremi se të gjithë po jetojnë të gëzuar në jetën e tyre kulturore, duke punuar në zanatet e tyre dhe duke kënduar këngët e tyre tradicionale. Njerëzit në këtë rast bëhen rob të të jetuarit në një muze të gjallë, i cili nuk ka mure, por ka kufij që mbyllin qasjen të përfitimit dhe mundësitë që dhuron rrjedha e jetës. Këta kufij patrollohen në mënyrë aq të përpiktë mu sikurse të ishin pengesa për të arritur në vendin tjetër.

Derisa njerëzit shpërblehen nga kureshtja dhe interesimi i tjerëve, ata nuk kanë dëshirë të shihen si një panoramë kulturore, e ruajtur jo nga dëshira për të avancuar pasurinë e shoqërisë, por si një

arsyetim për t'i përjashtuar pakicat që nuk janë të mirëseardhura pa u dukur si joliberal apo si jonjerëzor. Kjo është bërë problem në mbarë botën, i cili kërkon një shkallë të lartë të ndjeshmërisë. Në njërën anë është me rëndësi që kulturave të pakicave t'u jepet ndihmesa për të mbijetuar; po ashtu, është me rëndësi që të tjerët të kenë mundësinë t'i shohin dhe t'i kuptojnë ata në punë brenda rrethanave sa më të afërta që të jetë e mundur me autenticitetin tradicional. Nga ana tjetër, nuk mjafton që të përjetësohen kulturat nëse rrezikojnë të shndërrohen në geto në vend se të jenë një vend ku njerëzit do të gjejnë prehjen e tyre.

Duhet të ekzistojë një ndërveprim mes komponentëve të ndryshëm kulturore të pakicave në vend që nuk dallojnë nga ai mes komuniteteve shumicë. Këto vështrësi nuk janë të kufizuara në grupe apo zona të vogla. Në shekullin e fundit, regjione të tëra dhe shtetet të mëdha janë bërë muze, kultura të parajsës së gjallë të mirëmbajtura dhe pastruara për qëllime të turizmit. Ato janë aq shumë të pastruara sa që prejardhja e tyre e lidhur me luftërat, madhëria nga e kaluara dhe ngjarjet dalluese duket se janë reduktuar në asgjë më shumë se në filma vizatimorë – keqpërfaqësime

romantike që janë aq degraduese sa janë edhe format e hapura të paragjyqimit.

Mund të krijohet një situatë e rrezikshme nëse shtohen acarimet dhe marginalizimi i komuniteteve që tanimë janë nën presion. Sipas pikëpamjes fundamentaliste (shpesh tmerrësisht të pasaktë) të kulturës së tyre, traditat e njëjta që ofrojnë vazhdimësi dhe vlerë bëhen simbole të identitetit të drejtuar sa nga objektivat kulturore aq edhe nga ato politike. Kur këto shndërrohen në pretendime territoriale, kërkesa për privilegje të posaçme dhe, në fund, për prishjen e rregullit ekzistues, afëherë procesi shkatërrimtar veçse ka filluar. Ironikisht, kështu janë themeluar shumica e shteteve kombe në Evropë. Gjithashtu, përvojat e shumë shteteve afrikane, të ish-Bashkimit Sovjetik dhe të Jugosllavisë tregojnë se çka mund të ndodhë në kontekstin modern. Kulturat që shtypen nga sistemi i kufizimit bëhen bërthamë e shtetësisë. Nga ana tjetër ajo vetëdije e shtetësisë bëhet filozofi mbizotëruese e atyre që kërkojnë që zëri t'iu dëgjohet. Pasi që shtetësia të jetë krijuar, shtetet e sapodala nga veza sillen me po të njëjtën keqësi ndaj atyre që janë bërë pjesë e pakicës në rendin e ri, ashtu siç është sjellë me ta regjimi i mëparshëm. Për një shtet, i cili me

të vërtetë kërkon të mbetet i paprekur, duke i shijuar frytet e shoqërisë liberale, një ekonomi dinamike dhe të drejta të fuqishme të njeriut, është thelbësore të formësojë politikën, përmes së cilës përmirësohet siguria kulturore pa nxitur urrejtje dhe shovinizëm – qoftë brenda shumicës apo pakicës së popullsisë.

Nëse ky argument duket se ka ardhur nga diskutimi rreth pozitës së artit dhe artizanateve në jetën e komunitet, atëherë kjo është e vërtetë. Ka ardhur. Pavarësisht kësaj, hollësitë e kulturës shpesh janë simptoma të punëve më të gjëra shtetërore. Kultura që është e ruajtur, por që nuk e ka më aftësinë të shikojë përtej kutisë dhe të zhvillohet, mund të ballafaqohet me telashe. Kulturat e shëndosha përfitojnë nga informatat e reja dhe i përshtatin ato në dobi të vetes. Ato gjithashtu eksportojnë stilet dhe vlerat e tyre dhe nuk rrinë të ngurta, apo nuk sprapsen nga presionet e kulturave të tjera që kanë pushtet dhe para.

Derisa detyra kryesore e integritimit të shoqërive komplekse mbetet fushë e zyrtarëve që merren me mirëqenien, punësimin dhe banimin; kjo detyrë nuk mund të shpërfillet edhe nga sektori i kulturës. Vetëm politika e

mirë e kulturës nuk mund të sigurojë koherencën dhe përparimin e shtetit. Megjithatë, pa një politikë të mirë kulturore, shumë nga objektivat e tjerë politikë të qeverisë do të jenë më të vështirë për t'u arritur e nganjëherë edhe të pamundshëm. Modeli që ka sukses është ai që mundëson shkallë më të lartë të vefëvendosjes, të lartësimin të aspiratave individuale dhe që ofron një ndjenjë të sigurisë ekonomike e kulturore në një masë të barabartë. Mekanizmat për ta bërë një gjë të tillë janë temë e pjesës së mbetur të këtij libri.

# V. Zbatimi i politikës

*Shih si toka harkore zgjatohet këtu  
në një hemisferë të përkryer!  
As kompas i më i mirë nuk do të  
bënte një vijë më harkore se kjo;  
E as lapsi më butë nuk do të mund  
ta bënte vijën lakore, ashtu siç  
lakohet ky breg.*

**Andrew Marvell**

*Upon the Hill and Grove at Bilbrough*

## Trashëgimia

Kujdesi ndaj trashëgimisë është i ngjashëm në shumë aspekte me atë ndaj mjedisit ku jetojmë. Në këtë rast duhet të krijohet një baraspeshë mes nevojave të konservimit në vend, qasjes së qytetarëve, ruajtjes së përdorimeve tradicionale dhe krijimit të një mjedisi të shëndetshëm për të mbajtur një treg të respektueshëm, pa i dëmtuar artefaktet, apo kontekstin e tyre. Ruajtja e trashëgimisë si një pjesë të gjallë të shoqërisë, duke siguruar njëkohësisht ruajtjen e saj për brezat e ardhshëm, kërkon politikë të guximshme që të ndërhyjë kundër interesave të pastra komerciale, por gjithashtu që të inkurajojë shfrytëzimin e ndjeshëm të trashëgimisë, në mënyrë që rëfimet e jashtëzakonshme që përmban ajo të mund të hapen për sa më shumë njerëz që të jetë e mundur.

Nëse trashëgimia është dëshmi dhe e arritur e të kaluarës, atëherë çfarëdo politike e trashëgimisë duhet të fillojë me peizazhin në Europë, ku njerëzit nuk kanë ndikuar shumë. Duke ua mundësuar arkitektëve dhe zbuluesve të kohërave tona që të kontribuojnë, politikën e planifikimit duhet ta lejojë peizazhin dhe habitatin që të evoluojë dhe jo të nxisin revolucionin gjërryes ndaj tij. Dëshmia e historisë sonë e shtrirë afër sipërfaqes, apo që mbijeton mbi të në formë të rrënojave dhe grumbujve të dheut, duhet të kuptohet dhe të ruhet. Nganjëherë kjo do të kërkojë disiplinën për të ndaluar trazimin. Ndërsa, në raste të tjera, këto vende do të duhet të gërmohen, të shënohen në harta dhe të zhvillohen (jo të çrrënjosen). Sido që të jetë, rregulla është e thjeshtë: dëshmia e të kaluarës nuk duhet të shkatërrohet. Edhe në rastet kur nuk mund të zbulohet, duhet të kujdesemi që t'ua lëmë brezave të ardhshëm për ta hulumtuar, edhe në rastet kur kjo paraqet kosto të mëdha. Mbi të gjitha, vendet duhet ta dinë qartë se çka ka në to. Një pjesë befasisht e madhe e trashëgimisë në Europë nuk është hulumtuar dhe kataloguar, e lëre më gërmuar. Listat e sakta të trashëgimisë që do të jenë në dispozicion të intelektualëve dhe bërësve

të politikave janë parakusht kryesor për menaxhimin e trashëgimisë.

Objektet e bukura duhet të lejohen që të mirëmbahen jo vetëm si atraksione publike, por edhe si vende të jetës dhe punës. Nuk ka asgjë më pikëlluese se një shtëpi e vdekur, e cila ruhet vetëm për përmbajtjen dhe proporcionet e saj të mira. Edhe nëse ato paraqesin përkujtues të këqij të një rendi shoqëror, i cili ka kaluar dhe ende nuk është harruar, objektet e mëdha private të shekujve të kaluar (dhe disa nga shekulli ynë) kanë shije të lartë artistike dhe mjeshtri. Disa vende kanë gjetur mënyrat për të njohur këtë pa e bërë tërë katalogimin e objekteve në përgjegjësi të shtetit. Këto mënyra duhet të përfshijnë ndihmesën (qoftë përmes granteve, kompensimit apo lirimeve tatimore) për pronarët, në mënyrë që ata t'i mirëmbajnë vetë objektet dhe rrethinën e tyre, ku si kundërvlerë e kësaj pune ata do të kenë detyrën për t'u kujdesur dhe kushtin që të mos shesin asetet, të cilat janë në interes të publikut. Ata gjithashtu duhet të kenë për detyrë t'i vënë gjësendet në dispozicion për ekspozita publike, si në rastin kur objektet janë në pronë, apo në rastet kur ato duhet të huazohen në vende të tjera.

Në rastet kur kjo nuk është praktike, duhet të merret parasysh themelimi i fondacioneve për konservimin dhe rregullimin e objekteve, ndoshta të paraparë edhe me kornizë ligjore, në mënyrë që fondacioni të jetë i sigurt në të ardhmen dhe që trashëgimia të mos shpronësohet. Këto fondacione duhet pastaj të zhvillohen në formë të federatave (në disa vende kemi një trust të vetëm) në mënyrë që të kemi standarde të larta në punën e konservimit, të menaxhimit dhe të marketingut.

Kjo qasje nuk ka nevojë të kufizohet vetëm në objekte. E njëjta është e përshtatshme edhe për oborret, parqet dhe zonat e rëndësishme natyrore (të rëndësishme për kontributin e tyre ndaj kulturës në përgjithësi, si dhe për vlerën e tyre mjedisore). Brenda këtij koncepti, trashëgimia vazhdon të jetojë në interesin publik, ku shumë pronarë bëhen kujdestarë të pronës së tyre dhe ku objektet dhe monumentet e bukura mund të veprojnë si katalizatorë për zanatet që përndryshe do të mund të vdisnin. Andaj, gjithmonë do të ketë nevojë për ata që mund të realizojnë punime të bukura në freska, gjips, gurë dhe dru, ata që mund të dizajnojnë oborre, tepihë dhe tekstile, të restaurojnë libra dhe mermer. Ndërtimi

i objekteve të reja përmes teknikave që përdoren në vendet e trashëgimisë ngërthen në vete përparësinë e shtuar të sigurimit të ruajtjes së karakteristikave tradicionale të zonës, edhe në rastet kur provohen stile të reja arkitektonike. Trajnimi për konservimin e trashëgimisë rrjedhimisht mund të ketë efekte anësore të shkëlqyeshme lidhur me perspektivën e përgjithshme të punësimit, posaçërisht në zonat rurale, ku janë të përqendruara aq shumë vende të trashëgimisë.

Objektet e konservuara gjithashtu do të bëhen qendra për edukim dhe zhvillim të diskurseve, festivaleve dhe të gjitha formave të performancave, të cilat mund të akomodohen me imagjinatë dhe pa shkaktuar dëme. Në fakt, objektet që janë pjesë e trashëgimisë paraqesin vende më të mbushura me atmosferë, ku njeriu mund të kënaqet me artin, sesa shumë objekte të ndërtaura enkas për këtë qëllim, siç janë sallat e koncerteve dhe teatrot. Stimulimi vizual i një vendi madhështor ka efekt pozitiv si te publiku, ashtu edhe tek artistët.

Restaurimi, renovimi dhe paraqitja e mundshme e vendeve të trashëgimisë nuk duhet të bëhet përnjëherë e as që duhet të ketë përqendrim të tepërt në vendet posaçërisht spektakulare, të cilat

tërheqin publicitet të madh, por edhe resurse enorme (nganjëherë tejmase të mëdha), si dhe shumë mysafirë për të mirën e tyre vetanake. Konservimi i trashëgimisë është proces afatgjatë që nuk përputhet me mandatet politike. Derisa politikanët shpesh kanë dëshirë të asocohen me punë madhështore, në të shumtën e rasteve trashëgimisë i shërbehet më mirë përmes përparimit të ngadalshëm dhe të kujdesshëm. Qytetarët gjithashtu kanë tendencë të jenë më përkrahës të programeve të vazhdueshme në një zonë të gjerë sesa të projekteve të koncentruara, por në dukje ekstravagante. Është më mirë të shihesh duke punuar vazhdimisht në sa më shumë vende të trashëgimisë që të jetë e mundur. Ky aspekt ka dy efekte të dobishme. Ua dëshmon qytetarëve se diçka po bëhet dhe nënkupton se këto vende vazhdimisht konservohen dhe nuk lihen që t'i gërryëjë dhëmbi i kohës derisa të futen në listën e vendeve të rrezikuara dhe të bëhen prioritet që ngërthen kosto të lartë.

Kujdesi ndaj trashëgimisë nuk ka të bëjë vetëm me konservimin e disa gjërave nga e kaluara, por ka nevojë për një sy kritik dhe një dorë të frymëzuar. Ky kujdes duhet të ketë standarde që përfshijnë çdo aspekt të zhvillimit –

duke filluar nga planifikimi i rrugëve, zgjerimi i vendbanimit dhe ruajtja e materialeve që janë përdorur në objekt, një matricë të bashkërenduar të instrumenteve financiare dhe një program gjithëpërfshirës të arsimit dhe trajnimit. Njëkohësisht ne nuk duhet ta ngulfasim punën e kohës sonë, duke iu kthyer së tepërmi punës së paraardhësve.

Kufizimet duhet të jenë fleksibile dhe inovative, duke bërë më shumë se sa vetëm ndalimin. Përmes zbatimit të politikave duhet të sigurohemi që ndërtimet e tanishme të jenë po aq interesante dhe të vlefshme sa të mund të futen në katalogun e trashëgimisë të së nesërme si një pasqyrë e kohërave të kaluara.

### **Turizmi**

Askujt nuk i pëlqen turizmi. Banorët e një qyteti apo zone të bukur që shohin numra të mëdhenj të huajsh që vijnë për t'i zgurdulluar sytë dhe fotografuar, që ngritin çmimet e shtëpive të pushimit, hedhin mbeturina, i mbushin baret e tyre lokale dhe i ngulfasin rrugët ashtu që për të shkuar diku të nevojitet dy herë më shumë kohë se zakonisht; ata i konsiderojnë turistët më shumë si mallkim sesa bekim. Kur studentët me çantat e tyre të krahut kthehen në

fakultet; kur autobusët me udhëtarë, të cilëve udhëtimin ua ka paguar kompania nga Kjoto, e bëjnë fotografinë e fundit dhe nisen për në aeroport; kur turmat me pak para dhe të huajt e pasur me shumë ikin dhe kthehet ndjenja e të qenit në shtëpi është një gjë shumë e mirë.

Në ekonominë e shërbimeve, në të cilën Europa gjithnjë e më shumë është duke hyrë, të gjithë kanë nevojë për turistë. Ata janë një burim i të hyrave, të cilat vetë komuniteti nuk duhet t'i krijojë. Ata paraqesin një treg që nuk varet nga kushtet lokale dhe kërkojnë shërbime, përmes të cilave përmirësohet infrastruktura lokale ku, për trashëgiminë kulturore, interesimi dhe paratë e tyre bëhet argument i padiskutueshëm për restaurim dhe zhvillim të ndjeshëm.

Askujt nuk i pëlqen që të jetë turist, apo që të jetë i rrethuar nga turistët e tjerë. Ne parapëlqejmë të jemi mysafirë dhe të zbulojmë vendin vetë, edhe pse shumë mirë e dimë se pa të gjithë mysafirët e tjerë hotelet nuk do të ekzistonin, rrugët nuk do të rregulloheshin e restorantet nuk do të kishin punë, ndërsa atraksionet që kemi ardhur për t'i parë do të mbylleshin. Ne dëshirojmë ta shohim plazhin e

zbrazët, por kafeterinë ta kemi pranë, kështjellën e zbrazët dhe romantike, por me porta të hapura duke mirëpritur mysafirët dhe kopshtet e rregulluara deri në përkryeshmëri dhe me shërbyes që na shërbejnë, pa pasur nevojë të përzihemi me qindra të tjerë që nuk i përkasin vendit. Ne dëshirojmë të sillemi dhomave, duke ia hedhur një sy jetës së fshehtë të të mëdhenjve dhe të vdekurve, duke paramenduar veten si habsburgët, mediçët, çërçillët ose romanovët.

Ky është paradoksi i turizmit, i cili qëndron në thelb të politikës së tij: nevoja për të shfrytëzuar potencialin e vendit, duke mos shndërruar banorët e tij në figura të gjalla dylli, apo shkatërruar shpirtin që e bëri interesant dhe të vlefshëm për ta vizituar. Kjo gjithashtu është çështje e qëndrueshmërisë, sepse nëse priset ai shpirt ikanak, ndryshimi do të jetë i pashmangshëm dhe monstra e krijuar gjithmonë do të mbetet në mëshirën e ndryshimeve të modës, të ekonomisë së vendeve të tjera dhe të ndryshimeve të shijeve të brezave. Në rastet kur atraksioni kryesor nuk është vetëm dielli, deti dhe rëra, vendet janë posaçërisht të ndjeshme ndaj dështimeve të natyrës arkitektonike dhe promocionale. Në pjesën më të madhe të Europës Veriore dhe Lindore

atraksionet kulturore janë elementet më të rëndësishme në bindjen e njerëzve për t'i vizituar. Disa të tjera ka gjasa të jenë aq të pafajshme që të varen nga moti, edhe pse bukuria dhe magjia e peizazhit mund të jetë e fuqishme edhe përmes një velloje të shiut. Pavarësisht kësaj, shpesh janë monumentet dhe traditat ato që i shkojnë përshtati peizazhit dhe që i tërheqin njerëzit. Shën Petersburgu apo Edinburgu, Galuej ose Praga nuk do të ishin në listën e pushimeve të askujt nëse nuk do të kishin bukuritë e tyre arkitektonike, të muzikës apo historike. Ekziston një dallim i madh mes numrit të europianëve të veriut që udhëtojnë në jug dhe numrit të atyre që vijnë si turist në drejtimin e kundërt. Dielli natyrisht është faktori kryesor për këtë. Megjithatë, destinimi i saktë dhe lloji i mysafirët që zbret në një vend të caktuar, kryesisht diktohet nga atraksionet kulturore. Këto nuk kanë të bëjnë shumë me objektet që zakonisht ofrohen sipas kushteve të politikës së qeverisur mirë kulturore të vendbanimeve, por këto janë monumentet dhe festivalet, karnavalet dhe tregjet, vera dhe miqësia. Vendet që shfrytëzojnë resurset e tyre në mënyrën më të suksesshme janë ato vende që kombinojnë të gjithë këto elemente, duke e ndryshuar dinamikën gjatë vitit, pa e sakrifikuar identitetin e tyre përmes



shfrytëzimit të reputacionit deri në pikën e artificialitetit.

Rrjedhimisht, politika e turizmit duhet të trajtohet me kujdes. Kjo politikë duhet të jetë inkurajuese dhe të përfitojë më së shumti nga talentet dhe resurset që mund të vihen në dispozicion pa e dëmtuar komunitetin lokal. Nuk do të ishte përparësi të transformohet zona ku popullata lokale, shtëpia e të cilëve ka qenë aty për breza të tërë, lihen anash si kategori e klasës së dytë nga ardhja e mysafirëve të trajnuar më mirë, më të pasur dhe më të ftohtë. Kjo në përgjithësi vlen për turizmin. Kjo është edhe më e rëndësishme në zonat me ndjeshmëri kulturore – pavarësisht nëse peizazhi, vendi i trashëgimisë apo i kulturës së gjallë është i cenueshëm.

Kudo që është e mundur duhet të përfshihet popullata lokale në ndërtimin dhe dizajnimin, si dhe duhet të përbëjnë pjesën më të madhe të punëtorëve aty. Suvenirët duhet të bazohen në traditat dhe prodhuesit lokalë. Kjo nuk është vetëm në dobi të lokalitetit, por është edhe në të mirën e turistëve. Nuk ka asgjë më pak mbresëlënëse se një enë “origjinale” e argjilës me shkrimin “Made in China”, të vendosur në fund të saj. Në përgjithësi, njerëzit nuk udhëtojnë për

të parë diçka që veçse e kanë në shtëpi – edhe pse shoku kulturor, mekanizmi mbrojtës që aktivizohet përmes ballafaqimit me të huajën, nënkupton se ata dëshirojnë të kenë të afërsi edhe gjëra që iu asocojnë me diçka të njohur, posaçërisht kur udhëtojnë me fëmijë të vegjël, të cilëve nuk u pëlqen prishja e rutinës së përditshme dhe ushqimi, me të cilin nuk janë mësuar. Pjesa më e madhe e reagimit instiktiv mund të zbutet përmes vendeve që janë të hapura në kohë të pazakontë për lokalitetin, por që i plotësojnë pritjet e mysafirëve, kanë cilësi të lartë dhe banim e ushqim të pastër, por jo edhe të kushtueshëm, si dhe shërbim të mirë.

Turistët presin të shpenzojnë para dhe në fakt edhe shpenzojnë më shumë sa janë në pushime sesa po të ishin në të njëjtën periudhë në shtëpi. Megjithatë, jo të gjithë ata janë të pasur dhe budallenj. Njerëzit presin që për paratë e tyre të marrin vlerë dhe nuk u pëlqen që të rrjepen. Pronarët e objekteve nuk e mësojnë gjithmonë lehtë këtë mësim, duke supozuar se mysafirët kryesisht janë aty për t'i harxhuar paratë e kursyera sa më shpejtë që të jetë e mundur. Kjo mund të dëmtojë perspektivën afatgjatë të një komuniteti që kryekëput varet nga turizmi. Po ashtu,

rrezikohet edhe emri i mirë i regjionit apo i shtetit. Andaj, qeveritë e përgjegjshme do të duhej të ndërhyjnë në tregun e turizmit në mënyrë më energjike sesa që normalisht do të pritej në aktivitetet që kanë funksion të pastër komercial. Turizmi ka të bëjë me paraqitjen e vendit, për të cilin jemi krenar para botës së jashtme. Nga kjo del se brendimi i imazhit që ka mbetur në mendjen e mysafirëve është aspekti kryesor. Ky imazh mund të jenë rrënojat klasike në shkretëtirën e Jordanit ose xhazi i Nju Orleansit, por qëllimi është i njëjtë – të fiksohet ideja kryesore te mysafiri potencial, në kuadër të së cilës mund të zbulohet me durim dhe kureshtje llojshmëria e vërtetë dhe karakteri kompleks.

Në rastet kur turizmi kulturor është më i rëndësishëm se bregdeti apo plazhet, është thelbësore që mekanizmat për ruajtjen e trashëgimisë dhe inkurajimin e turizmit të jenë të integruara. Në rast se kultura dhe turizmi janë sektorë konkurrentë në qeveri, ata gjithsesi se do të jenë konkurrentë edhe në terren. Kështu që zyrtarët e turizmit do të duhet të trajnohen nga fusha e ekspertizës kulturore dhe duhet t'i kuptojnë forcat që nxisin turistët. Maksimizimi i potencialit të turizmit pa

menaxhim të kulturës është një detyrë delikate. Së këndejmi, planifikimi i integruar, përzgjedhja e kujdesshme e vendit të objekteve, objektet e dizajnuara mirë, kufizimet në numra dhe qasja e kontrolluar do të jenë të rëndësishme.

### **Muzetë, bibliotekat dhe arkivat**

Muzeu nuk është vetëm vend për të vendosur objektet në kuti të qelqit. Ai është një rrugë për në hollësitë e të kaluarës. Kur koleksionet e tij paraqiten me shkëlqim dhe imagjinatë, muzeu mund të jetë mënyra më e efektshme e vendosjes së secilit prej nesh në kontekst, duke treguar njëkohësisht sesa kanë ndryshuar tendencat, por edhe sesa kanë mbetur të njëjta. Në rastin më të mirë muzetë na mundësojnë që të hyjmë në botën tonë në një kohë tjetër dhe që të kuptojmë se si dhe pse historia u shpalos ashtu si u shpalos. Ndoshta përparimi më i madh që bënë muzetë, në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të, ishte të kuptuarit se një koleksion për të qenë i rëndësishëm nuk ka nevojë të ketë thesaret e mëdha. Objektet e përditshme janë po aq fasciuuese sa janë edhe artefaktet e pasura. Nga ana tjetër një koleksion i objekteve të vlefshme i larguar nga ambienti i tij dhe i vendosur me gjësende të tjera të të njëjtit zhanër është i pikëllueshëm për t'u parë. Kjo

na përkujton se arsytet për prodhimin dhe koleksionimin e tij janë zhdukur së bashku me njerëzit që i kanë vlerësuar. Ngjashëm me këtë, muzetë mund ta përqendrojnë vëmendjen në një objekt që mund të jetë lënë anash apo shpërfillur nga pronarët e tij fillestar dhe mund të tregojë cilësinë e vet të vërtetë përmes një perspektive historike. Muzetë janë vende ku ne shkojmë për të interpretuar mbetjet materiale të së kaluarës dhe jo vetëm për t'ua hedhur një shikim.

Në mënyrë që interpretimi të ketë efekt në mendjet moderne, muzeu duhet të menaxhohet ashtu që t'i befasojë dhe t'i kënaqë ata që e vizitojnë, duke i kapluar ata me entuziazëm për diçka, për të cilën më parë kanë pasur vetëm një kureshtje të vakët. Muzetë duhet të inkurajojnë hulumtimin dhe përfshirjen dhe jo vetëm një hedhje pasive të shikimit. Kështu që muzetë më të mira do t'i trajtojnë koleksionet e tyre si pjesë të teatrit, duke përdorur të gjitha teknikat e botës dramatike – dritat dhe zërin, tekstin dhe aktorët, rekreacionin dhe animacionin. Shpesh muzetë do t'i ftojnë mysafirët që t'i vizitojnë në dramë, duke i lejuar ata të prekin (origjinalet në rastet kur aspektet e konservimit e lejojnë këtë, si dhe replikat dhe modelet në rastet kur prekja e origjinalit nuk është e

lejuar), duke i inkurajuar ata të shikojnë procesin e krijimit, prodhimin dhe duke ua dhënë mundësinë të përpiqen të bëjnë diçka edhe vetë. Tani, me aplikimin e teknologjisë dhe imagjinatës fjala, muze po fiton domethënie të reja. Gjithnjë e më shumë pengesa mes muzeut dhe arteve pjesëmarrësve është duke u hequr. Andaj, muzetë që përdorin të gjitha shqisat, muzetë virtuale dhe muzetë e hulumtimit janë vende të zbulimit dhe jo vetëm të pedagogjisë.

Kjo qasje është zbatuar për herë të parë në muzetë e jetës rurale, të filmit dhe fotografisë dhe të shkencës. Megjithatë, nuk ka arsye pse nuk mund të tentohet në forma të modifikuara të muzeve me koleksione më tradicionale – muzetë e qytetit, ata të botës antike, muzetë që përkujtojnë jetën e personave të rëndësishëm. Në këtë vazhde, dy skajshmëri tregojnë dallimin: në njërin anë udhëtimi animator në Muzeun Viking të Nju Jorkut, i cili madje ka rikrijuar aromën e vendbanimit Norse, të cilin e përkujton; ndërsa nga ana tjetër, shtëpitë e ndryshme ku kanë banuar kompozitorë të njohur si Beethoveni, Haydni dhe Mozarti në Gjermani dhe Austri. Në kuadër të këtyre, disa momente strehohen nën një xham të dhomave të zbrazëta (jo aq shumë se tepihu në

disa prej tyre) mu sikurse punëtorët e zhvendosjes para një apo dy ditësh të kenë harruar nga pakujdesia disa mobile.

Të dy qasjet lënë diçka për të dëshiruar. Në rastin e Muzeut Viking, kënaqësia e udhëtimit, sa është e mrekullueshme për ata që vijnë për herë të parë (veçanërisht fëmijët) është aq shumë e preokupuar me atmosferën, kështu që është vështirë për ata që kanë më shumë njohuri të hyjnë në brendi të temës. Teatri gjithmonë përfshin një kompromis mes realitetit strikt dhe nevojës për thjeshtëzim me qëllim të rrëfimit të stories. Në muze, nëse rrëfimi fillon të tejzgjatjet – shumë kinematik – atëherë hollësisht e nevojshme mund të trivializohen apo të lihen anash. Për shkak se muzetë duhet të jenë vende të hulumtimit dhe të prezantimit, lënë hapësira edhe për bizneset private, dëshira për të shkuar në rrugën e zgjedhjes sonë nuk e zbaton në mënyrë automatike skenarin e paraqitur nga kuratori.

Megjithatë, objekti i lënë pasdore vetëm me jehonën e këmbëve të respektueshme në dyshemetë e zbrazëta, me dekorime të zvogëluara në ngjyrën, me storien e temës së rrëfyer vetëm në një gjuhë, lë shumë për të imagjinuar.

Si do të kuptojë dikush që mendon se muzika klasike është e mërziqshme (apo vetëm për të moshuarit) energjinë e madhe të jetës së një kompozitori? Si, dikush që e di vetëm emrin e një muzeu që është pjesë e xhiros së paraparë të vizitës, të kuptojë në rend të parë se pse është ruajtur vendi, përveç nëse nuk gjallëron me muzikë që vjen nga ai? Për të gjetur pikën e duhur mes këtyre skajshmërive kërkon një shkallë të shpirtit prezantues që duhet të kombinohet me kujdesin kuratorial. Integriteti i temës dhe komunikimi i saj te brezi, me të cilin ka humbur lidhjen, duhet të jenë dy shqetësimet kryesore.

Muzetë duhet të kenë mjete financiare për ta shtuar koleksionin e tyre, për ta ruajtur dhe paraqitur atë që kanë, si dhe për ta promovuar në mënyrë të efektshme te publiku, dhe jo vetëm ta vënë atë koleksion në dispozicion. Kjo është një punë e shtrenjtë, zakonisht shumë e shtrenjtë për shtetin që të merret me të i vetëm. Në fakt, për shkak se muzetë janë shtuar dhe diversifikuar në masë të madhe gjatë viteve të fundit – pothuajse me çdo komunitet dhe tematikë që pret që historia e tij të ruhet – duhet të ekzistojnë mënyra të ndryshme të grumbullimit të mjeteve financiare. Dy mënyrat më të

efektshme (përveç subvencioneve), janë fondacionet donatore dhe shfrytëzimi komercial. Parimi i donacioneve vlen për bibliotekat, arkivat dhe madje edhe për institucionet artistike. Këto bashkohen të gjitha formatet e grumbullimit të parave – ankesat, organizatat e përkrahësve, të hyrat nga qiraja, tarifat e të drejtës së autorit, spin-off-et komerciale dhe financimi i projekteve – ku ato kursehen për të ofruar bazë të vazhdueshme të të hyrave. Disa donacione vijnë të gatshme nga dhuruesit zemërgjerë. Ndërsa të tjerat duhet të ndërtohen ngadalë, duke u mbështetur në buxhetimin imagjinar, trashëgimitë e vogla dhe donacionet për ta çuar shumën e përgjithshme të mjeteve deri në nivelin ku interesi nga ta bën dallimin domethënës për rrjedhën e parasë së muzeut.

Shfrytëzimi komercial ka dy përparësi: ia shton të hyrat muzeut, duke rezultuar gjithashtu me material promovues të cilësisë së lartë dhe shërbime të mira shtesë për vizitorin. Shitorja është një përbërës thelbësor. Në të duhet të ketë më shumë gjëra për shitje sesa vetëm kartolina dhe lapsa për suvenirë. Aty mund të ketë edhe kopje të artefakteve, CD të muzikës dhe video xhirime të lidhura me muzeun (shpesh enkas të incizuara), produkte ushqimore dhe

zbukurime të kopshtit, bizhuteri, libra, veshmbathje dhe lojëra. Shitorja nuk është e domosdoshme të jetë në atë vend. Muzeu Metropolitan ka një shitore në Qendrën Rokfeller në Avenynë e 5-të, e cila është një vend shumë i rëndësishëm për blerësit e festave të fundvitit në Nju Jork. Gjithashtu, Muzeu Britanik ka një shitore të tillë në Aeroportin Hithrou.

Muzetë mund të jenë katalizatorë në ruajtjen e artizanateve, në punësimin e artistëve modernë dhe në krijimin e biznesit të vogël prodhues dhe publikues. Muzeu, gjithashtu, mund të përdoret si vend për xhirimin e filmave, për mbajtjen e koncertit, si qendër arsimore dhe vend thjesht për t'u argëtuar. Ato, gjithashtu, mund të jenë vende për të shkruar në një drekë të mirë apo për t'i takuar miqtë. Kafeteria është pjesë thelbësore e muzeut. Ajo jo vetëm se është vend i mirëpritur pas një ecjeje të lodhshme për shikimin e artefakteve, por edhe për faktin se sjell njerëz në muze, të cilëve përndryshe nuk do t'ua bënte edhe aq shumë të vinin aty. Kafeteria duhet të jetë e hapur kurdo që muzeu është i hapur. Në fakt, pothuajse ia vlen që renditja e kësaj fjalie të kthehet ndryshe – orari i punës së muzeut duhet të përputhet me atë

të kafeterisë, që mund të nënkuptojë që muzeu të jetë i qasshëm edhe përtej orarit të zakonshëm të punës, i cili duhet të përshtatet me kohën kur shumica e popullatës mund ta vizitojnë.

Për dallim nga rrëfimet e teatrove dhe operave, rrëfimet e muzeve duhet të jenë realiste. Pa integritet dhe paanësi, muzetë nuk mund të jenë gardianë të artefakteve që prezantojnë. Interpretimi i historisë vazhdimisht po ndryshon, dhe muzetë si edhe universitetet duhet që vazhdimisht t'i rishikojnë dëshmitë që kanë dhe të vijnë në përfundime pa anime dhe diskriminime. Derisa është e paevitueshme që çdo brez të jetë i burgosur i pikëpamjeve mbizotëruese të kohës së vet, një kurator i muzeut me dozë të përshtatshme të skepticizmit dhe vigjilencës duhet të jetë në gjendje të shkojë përtej paragjyqimeve të kohës.

Nëse kjo është e vërtetë për muzetë, atëherë është dyfish e vërtetë për arkivat. Është lehtë që informata të konsiderohet e parëndësishme, sepse nuk na konvenon, apo nuk është interesante shumë në momentin e caktuar, por kohërat dhe rrethanat ndryshojnë dhe prioritetet sociale të një periudhe dallojnë shumë nga ato të periudhës tjetër. Gjatë shek. XX, në shumicën e shoqërive

përkufizimi i ruajtjes së vlerës materiale ka shënuar ndryshime të mëdha, duke filluar nga një pikëpamje aristokrate dhe mbretërore në fillim të shekullit (ku vlerësoheshin mendimet dhe dokumentet e të fuqishmëve), e deri te pikëpamja më demokratike dhe egalitare në fund të periudhës (ku jeta e përditshme është po aq interesante sa kanë qenë edhe dokumentet e të mëdhenjve). Kjo e bën punën e arkivistëve më të vështirë dhe kërkon nga ata që të ruajnë sa më shumë dëshmi që të jetë e mundur, në çfarëdo forme të jetë ajo. Gjithnjë e më shumë këtu do të duhej të përfshiheshin e-mailët dhe format e tjera të komunikimit elektronik. Korrespondenca përmes e-maileve mes shkrimtarëve, për shembull, shumë shpejt do të zëvendësojë letrat e shkruara. Fatkeqësisht, kjo do të thotë se autenticiteti i dorëshkrimit do të bëhet më i rrallë. Pavarësisht kësaj, liria me të cilën njerëzit tani komunikojnë në mbarë botën do të nxjerrë disa fusha fascinuese të studimit në të ardhmen. Këto mjete mekanike të komunikimit duhet të shtypen dhe të ruhen edhe në letër. Shpejtësia me të cilën pajisjet elektronike vjetërsohen do të thotë se materialet e sotme kompjuterike së shpejti do të jenë të vështira për t'u nxjerrë siç është rasti edhe me incizimet

e hershme zanore. Fundja, ku mund të gjejë njeriu tani gjilpërën për gramafonin e viteve të 1920-ta?

Arkivat kanë nevojë edhe më të madhe për të ruajtur regjistrat, pasi që vendet e tjera tradicionale të ruajtjes së informatave humbin aftësinë e tyre për ta bërë një gjë të fillë – kishat në shumë vende janë duke ndryshuar karakterin e administrimit të tyre dhe kanë më pak kontakt me rolin e tyre të vjetër civil, klasa aristokrate dhe e fisnikërisë nuk i kanë më arkivat e tyre (qoftë për faktin se janë vjetërsuar, për shkak të revolucioneve dhe nevojës për t'i shitur si rezultat i zvogëlimit të të hyrave). Arkivat në nivel lokal, qofshin ato të vendosura tek qeveritë apo në universitete, duhet t'i kenë përgjegjësitë e definuara qartë dhe praktikat e rregulluara. Ato gjithashtu kanë nevojë për resurse për ta ruajtur materialin në mënyrë të sigurt dhe për ta nxjerrë lehtë ashtu që publiku të mund të ketë qasje të menjëhershme në të. Në fakt, sa më i fshehtë të jetë materiali, ka më shumë gjasa të jetë i rrallë, kështu vendndodhja e tij duhet të dihet. Sistemi i vjetër i ruajtjes së dorëshkrimeve në kuti brenda bodrumit më nuk është i kënaqshëm. Katalogimi i saktë, që është në dispozicion përmes teknologjive

të reja ka rëndësi thelbësore, kështu që arkivat në mbarë botën duhet t'i bashkojnë forcat si një rrjet i bazave të lidhura të të dhënave, në mënyrë që ekzistimi dhe vendi i dokumentit të mund të gjurmohet pa vështirësi. Njëkohësisht ekziston nevoja për një konventë të re ndërkombëtare për materialin arkivor, me qëllim të caktimit të standardeve minimale të konservimit si mbrojtje nga ndryshimet në atmosferën politike. Një pjesë e madhe e historisë sonë tani është e mbyllur për shkak të mbrojtjes joadekuate të arkivave gjatë viteve të kaluara dhe tani nuk mund të kemi një pasqyrë të saktë të së kaluarës së Europës.

E njëjta detyrë e ruajtjes vlen edhe për bibliotekat, qofshin ato biblioteka publike ku njerëzit mund të huazojnë libra, koleksione të specializuara, apo edhe institucione shtetërore. Librat duhet të ruhen si resurs e jo të shkojnë në rotacion në bazë të popullaritetit. Është shumë me rëndësi që bibliotekat të jenë në pozitë që t'i rrisin koleksionet e tyre. Kjo mund të arrihet përmes dhënies së buxheteve të arsyeshme për blerje bibliotekave, apo duke kërkuar nga botuesit që të japin një numër kopjesh të publikimeve të tyre në sistemin e bibliotekës dhe kompensimin e kostos së

tyre. Në nivel të shtetit është me rëndësi të mbahet regjistri i saktë i historisë së publikuar të shoqërisë. Rrjedhimisht, biblioteka e të drejtës së autorit, ku mbahet kopja e çdo publikimi, luan rol tepër të rëndësishëm. Idealisht, në çdo vend do të duhej të ekzistonin së paku gjashtë biblioteka të tilla në mënyrë që gjasat për ruajtjen e koleksionit të jenë më të mëdha dhe gjithashtu që njerëzit të kenë mundësinë e konsultimit të tyre pa pasur nevojë të udhëtojnë larg. Shkrimtarët duhet t'i furnizojnë këto biblioteka pa pagesë. Sistemi përmes të cilit në disa vende kjo edhe parashihej me ligj ia vlen që të përhapet sa më shumë.

Hapja e bibliotekave për qytetarët në shumicën e qyteteve është një nga të arriturat e mëdha të shek. XIX. Kjo ua ka mundësuar njerëzve nga të gjitha fushat e jetës që për herë të parë të kenë qasje në literaturë, revista periodike dhe punime të tjera. Çdokush që ka ditur të lexojë ka mundur ta përmirësojë njohurinë e vet rreth botës. Kjo në shumë mënyra ka qenë një nga iniciativat më të fuqishme demokratizuese të asaj kohe. Madje edhe tani kur të hyrat janë rritur dhe publikimet më të lira kanë sjellë librin më afër qytetarëve të Europës, dhe edhe pse interneti dhe ruajtja digjitale

premtan zhvillimin edhe më të madh të qasjes në dije, biblioteka lokale ende ka rol të rëndësishëm edukativ-arsimor në përhapjen e kulturës. Është me rëndësi që teoria e konsumatorizimit të mos përhapet shumë dhe që bibliotekat (ku përveç librave shpesh ka edhe muzikë të incizuar dhe kompjuterë me qasja në baza gjigante të të dhënave) të jenë sa më afër dhe të hapura kur njerëzit kanë nevojë për to. Ato mund të jenë vend i prehjes dhe i zbulimit, mu sikurse janë muzetë, posaçërisht për fëmijët, për të cilët biblioteka mund të jetë një burim (jashtë shkollës) i informatave për botën, të cilat nuk mund t'i gjejnë në shtëpi dhe të cilat pasiviteti dhe thjeshtëzimi i televizionit asnjëherë nuk mund t'i zëvendësojë.

Këshilli i Europës ka udhëzime të shkëlqyeshme për administrimin e politikave të bibliotekave – duke i parë ato si resurs demokratik për qasje në të gjitha format e informatës së regjistruar. Megjithatë, bibliotekat nuk kanë vetëm të bëjnë me ruajtjen dhe nxjerrjen e informatës, por ndërliiden edhe me memorien dhe interpretimin tonë të saj, me idetë dhe ruajtjen e tyre; por mbi të gjitha, ato kanë të bëjnë me të shprehurit e pandryshuar të njerëzimit. Në një bibliotekë të mirë autori gjen



pavdekshmërinë dhe shfletuesi internetit gjen më shumë se sa që dikush mund të presë.

### **Artet pamore dhe letrare**

Gjetja e ekuilibrit në politikën për artet pamore dhe letrare është një nga sfidat më të vështira. Secila prej tyre bazohet fuqishëm në treg dhe e forcon atë duke shfrytëzuar sektorin publik për aspektet e rëndësishme të funksionit të saj. Në të dyja politikat, është individi ai që është themeli i aktivitetit dhe që mbështetet në patronazhin e institucioneve dhe në vjeljen e tarifave nga shfrytëzimi i të drejtës së autorit. Por, në shumicën e rasteve, ndoshta edhe në të gjitha sosh, këto të drejta nuk ofrojnë para të mjaftueshme në fillim të karrierës në mënyrë që ato të përparojnë vetëm në bazë të shitjeve. Të hyrat e artistit pamor dhe të shkrimtarit vijnë nga burimet shitesë – nga mësimdhënia, transmetimi, gazetaria dhe dukja personale – sa vijnë edhe nga shfrytëzimi i linjës kryesore të punës kreative.

Kjo ka ndikime për statusin e artistit, jo vetëm në aspekte sociale (administratorët kanë tendencë të supozojnë ku ata që nuk janë administratorë me titull nuk duhet të punojnë apo duhet të trajtohen si

studentë), por edhe në ato tatimore. Artistët pamorë dhe shkrimtarët rrallë i shkojnë përshtati modeleve të pranuar të tregut të punësimit. Pensionet, pagesat për mirëqenie sociale që lidhen me punësimin dhe sistemet e sigurimit rregullisht i anashkalojnë ata. Mirëpo, tregu i tyre është më konkurruesi dhe i udhëhequr nga tregu. Puna në vazhdim e sipër rrallëherë paguhet në avans. Çmimi i punës përcaktohet nga vëllimi dhe reputacioni i artistit dhe jo sa kohë ka marrë për t'u prodhuar. Pagesa materializohet ngadalë pas përfundimit dhe dorëzimit të punës dhe shpesh ngërthen zbritje të mëdha për agentët dhe (në rastin e arteve pamore), materialet, transportin, sigurimin dhe ndihmesën teknike. Kjo është një punë e rëndë. Puna e politikëbërësit të kulturës është që të ndërhyjë në treg për t'i zbutur vështirësitë e shkaktuara nga pasiguria dhe të sigurojë që, përveç tregut, të ketë edhe vende të tjera jokomerciale të afta për ta sjellë punën e artistit te publiku.

Artistët duhet të përkrahen ashtu që ata të kenë qasje te publiku para punës së tyre për shkak se vetëpërkrahja komerciale është baza e politikës në këtë fushë. Për ta arritur këtë ka mënyra të ndryshme. Përkrahja mund të jetë e drejtpërdrejtë, duke ua dhënë artistëve

bursa për t'ua mundësuar atyre të punojnë të papenguar nga brenga lidhur me atë se kur bëhet puna dhe për kë është ajo. Përkrahja e drejtpërdrejtë gjithashtu mund të jepet përmes sistemit të sigurimit social, duke ditur se mospasja e të hyrave javore është një gjendje e zakonshme për artistin dhe nuk nënkupton se ata janë të papunë dhe, rrjedhimisht, jo në dispozicion për punë në fusha të tjera, vetëm se ajo punë është gjithnjë në vazhdim e sipër dhe e pafinancuar. Kjo qasje zbatohet posaçërisht kur artistët janë në fillim të karrierës së tyre.

Megjithatë, kjo i ka dy anë negative. Së pari, shoqërisë i duket se artistët janë disi një klasë që gjithmonë ka nevojë për ndihma, duke i lidhur ata me njerëzit që varen nga ndihmat sociale (paradoksalisht me ata arsimit të cilëve ua bën të vështirë që të kuptojnë, qoftë nëse artisti ka njohuri vizuale apo verbale deri në shkallën që shpesh është përtej të kuptuarit nga pjesa tjetër e shoqërisë). Rezultati është edhe më zhgënjyes për artistët në perceptimet sociale dhe statusin. Së dyti, ky profesion rrallëherë u jep artistëve pak me shumë se një të hyrë sa për mbulimin e nevojave të përditshme,

që askund nuk është afër nivelit të profesionistëve në fazën e njëjtë të karrierave të tyre dhe me ekspertizë të ngjashme. Andaj, kjo i dënon artistët që gjatë tërë jetës të merren me një profesion, ku meritat për punën e tyre i marrin administratorët, shpërndarësit, shitësit me pakicë dhe prezantuesit (ndërmjetësuesit që mund t'i diktojnë pagat për shkak se kanë vend të përhershëm të punës në organizata), sesa artistët që mbijetojnë nga puna e tyre e fragmentarizuar.

Më e kënaqshme do të ishte alternativa, gjegjësisht një formë e përkrahjes së drejtpërdrejtë. Kjo nënkupton financimin për promovimin e organizatave (galeritë, publikuesit, festivalet, etj) që t'i punësojë artistët në mënyrë që ata të krijojnë dhe të prezantojnë për ta. Shuma duhet të jetë e mjaftueshme për të financuar artistin në nivel të duhur profesional për kohën sa i njëjti është i kontraktuar, ku përfshihet periudha e krijimit, punës dhe e prezantimit të punës dhe insistimi që paratë e ofruara të përdoren për promovime të artistëve që nuk janë të aftë për të hyrë në fushën komerciale me produktet e tyre – së paku në aspektet e favorizuara të karrierave të tyre.

Kjo mohon rrezikun që promotorët të porosisin materiale të reja në vend që të mbështeten në katalog, për të cilin publiku tanimë është i njoftuar (dhe rrjedhimisht më i lehtë për t'u shitur). Gjithashtu e rrit statusin e artistëve, duke i ndërlidhur ata në mentalitetin e publikut me institucionet shumë të respektuara. Po ashtu, nuk ka arsye pse shteti nuk duhet të japë përkrahje në formë të huas, të pagueshme në proporcion me taniemat pas prezantimit fillestar të punës, apo si garanci ndaj humbjes. Kjo ruan interesin e shtetit në suksesin e tij (pa pasoja për punën nëse shteti nuk i kthen paratë e veta). Kjo gjithashtu ndryshon perceptimin rreth procesit, duke bërë shtetin investitor dhe jo filantrop.

Megjithatë, duhet pasur kujdes që ky sistem të mos jetë vetëmbyllës, që të dalin artistët të cilët punojnë vetëm me subvencione të fërthorta dhe që prodhojnë material që asnjëherë nuk do të gjente kërkesë në treg. Nuk ka arsye pse një gjë e tillë të ketë ndikim kufizues. Tregu, fundja, ka ngritur disa punime shumë aventureske në lartësi të reja të vlerës që nga vitet 1960-ta. Kjo do të thotë se pasi njëherë artisti të jetë i aftë të fitojë të hyra të larta, paratë publike duhet t'i ofrohen dikujt tjetër –

duke pritur që procesi të jetë fleksibil për ta kuptuar se artisti hyn dhe del nga moda dhe se mund të ketë nevojë për ndihmesë në ndonjë periudhë të mëvonshme.

Reputacionet nuk krijohen fillimisht nga fama e vetë punës. Publiku kërkon të sigurohet se po i paraqitet një vepër e cilësisë së lartë. Mu sikurse ndodh me mallrat e konsumit, mendimet në gazeta apo me kërkimet e shkencëtarëve, sigurimi ka tendenca të ndërlidhet me organizatat e konsoliduara dhe të respektuara sesa me individë. Më pastaj, gjatë karrierës së suksesshme pozita shpesh ndryshon kahun, ku tani reputacioni i institucionit varet nga perceptimi i artistit që është i aftë ta tërheqë.

Sektori komercial, edhe madje nëse subvencionohet për ndonjë punë të re, rrallë ndodh që mund t'iu dalë mbanë të gjithë projekteve të artistëve dhe shkrimtarëve. Andaj, do të ishte mirë që të krijohen shërbime për t'iu ndihmuar artistëve në paraqitjen e veprave të tyre në ekspozita, në shpërndarje dhe në vetëpromovimin e punës së tyre. Po ashtu ka nevojë t'iu ndihmohet artistëve pamorë që të mbrojnë punën e tyre pas shitjes. Ata duhet të kenë të drejtën

të dinë se kush e ka blerë veprën, ku mbahet ajo dhe të kenë qasje në të për pastrim dhe riparim. Rrjedhimisht, nga pronarët duhet të kërkohet që të njoftojnë artistët me rastin e shpërnguljes nga shtëpia, të shitjes së veprës apo lënies së saj trashëgimtarit pas vdekjes së tyre.

E mira më e madhe për artistët në fund të shekullit 19-të ishte zbulimi i sistemit të të drejtave të autorit. Ishte hera e parë që artistët do të mund të shpërbleheshin për jetën e veprës pasi që të dalë nga studioja dhe jo vetëm për objektin. E drejta e autorit ka qenë gjithmonë më e suksesshme për kompozitorët dhe shkrimtarët, megjithatë – ata puna e të cilëve nuk ka qenë e lidhur me objektin, por me përshtypjet e fituara – atëherë kjo kishte të bënte me artistët e arteve pamore (edhe pse zbatimi i të drejtës së autorit – pagesat për kopjet e bëra – u ka ndihmuar atyre, puna e të cilëve mund të shitet në kartolina, posterë apo në replika). Me shfrytëzimin ndërkombëtar të veprave kanë dalë edhe problemet të vjelljes së tarifave dhe të gjurmimit. Sistemi ka qenë veçse nën presion para zbulimit të internetit nga kopjimi pirat dhe nga presioni mbi artistët nga korporatat e mëdha për të hequr apo zvogëluar

të drejtat e tyre. Me bartjen e lehtë të materialeve përmes teknologjisë së re, e drejta e autorit, siç ka qenë e kuptuar për një shekull me radhë, ka qenë e kufizuar në përdorimin e saj. E vetmja zgjidhje e realizueshme, edhe nëse nuk është e përkryer, është pagesa për të drejtën e licencës, të cilat u shpërndahen organizatave të artistëve dhe përkrahen përmes të drejtës ndërkombëtare.

### **Artet e performancës**

Hartimi i politikave në fushën e arteve të performancës përmban vështirësi për qeverinë në të gjitha nivelet. Shteti asnjëherë nuk mund të vë para të mjaftueshme në dispozicion për t'i përmbushur të gjitha aspiratat e palëve të përfshira. Kjo nuk është për keqardhje. Artet e performancës, ashtu siç është edhe biznesi, duhet të jenë kreative, gjithnjë të mendohet për zgjerimin e tyre dhe prodhimi i tyre të rritet dhe të përmirësohet vazhdimisht. Baraspesha e qeverisë është që të ofrojë financa të mjaftueshme për të siguruar zhvillimin e vazhdueshëm dhe qasjen në artet e cilësisë së lartë për qytetarët, kudo që ata jetojnë. Njëkohësisht, nuk është e domosdoshme që arti të mbulohet me para, sepse nuk ka gjë më të mërziqshëm sesa artet e vetëkënaqshme apo vetëvlerësuese dhe arti i mërziqshëm

shumë shpejt e humbet interesimin dhe vëmendjen e audiencës, përveç si gazetë muri e këndshme. Fshehtësia qëndron në dhënien e mbështetjes në nivelin e duhur. Në rastin e shumicës së institucioneve performuese (qofshin ato të vendosura në ndonjë ndërtesë apo jo), në sistemin fiskal europian, kjo ka mundësi të jetë mes 50% dhe 70% të buxhetit të përgjithshëm, duke lënë kështu 10-15% të nxirret nga sponsorimi dhe pjesa tjetër nga shitjet e biletave, të ardhurat nga fondet për kulturë, spinofët e produksionit dhe shitjet shtesë të produktit.

Për kompanitë performuese do të ishte e ndihmesë ekzistimi i deklaratës së qartë rreth qëllimit të dhënies së parasë publike, pra komunitetit t'i jepet niveli më i lartë i mundshëm i produksioneve artistike me çmime të përballeshme nga shumica e qytetarëve. Andaj, është thelbësore që organizatave t'iu jepet garanci reale në mënyrë që ato ta kenë mundësi që të bëjnë plane me kohë. Në operë dhe vallëzime, si dhe gjatë sezoneve të koncerteve, artistët pjesëmarrës (dizajnerët, regjisorët, solistët) duhet të kontraktohen sezone më parë. Nëse gjërat nuk bëhen kështu, atëherë mund të ndodhë që artistët më të mirë të mos

jenë në dispozicion, apo të jenë më të shtrenjtë. Sido që të jetë, do të ketë rënie të standardeve. Planifikimi i fushatave të marketingut gjithashtu ka nevojë për kohë të gjatë. Asnjë nga këto nuk e respektojnë kornizën kohore politike të buxheteve për shpenzime nga viti në vit. Përveç kësaj, kjo i ndihmon vetë qeverisë po të kishte pasqyrë të saktë të zotimeve të veta në një periudhë afatmesme.

Modeli që e përmbush këtë dhe i cili siguron transparencë përgjatë procesit ngjason me atë kur organizatat artistike i paraqesin propozimplanet e veta për tri apo katër vite dhe pastaj atyre iu garantohej niveli i financimit. Kjo mund t'i përmbushë objektivat e tyre, apo edhe mund të mos i përmbushë, por së paku do të jenë të informuar rreth më të keqes. Ato mund t'i rregullojnë planet sipas nevojës, të zgjedhin që të vazhdojnë sipas parashikimeve, ose t'ia fillojnë një punë që merr kohë, e që është grumbullimi i mjeteve nga burime të tjera. Në rast të mospërputhshmërisë serioze mes shumës së kërkuar nga kompanitë dhe asaj që miratohet nga qeveria, zyrtarët duhet t'i bëjnë publike arsyet e tyre. Mund të ketë edhe procedurë ankimi. Të gjitha gjërat janë publike dhe askush nuk do të mund të pohojë se kundër tyre po bëhen

konspiracione. Nëse kushtet ekonomike apo prioritetet e politikave ndryshojnë, qeveria gjithnjë e ka mundësinë që të bëjë pagesa shtesë nëse dëshiron, ndonëse për organizatat është më mirë që të mos krijojnë pritshmëri për to. Nëse janë të gatshëm, më efektive do të ishte që paratë të vihen mënjanë në fonde për kulturë apo të përdoren për projekte specifike jashtë fushëveprimit fillestar të planit të publikuar, sesa të ndryshohen parashikimet, duke krijuar kështu një ndjenjë të re me siguri. Mundësitë janë që qeveria nuk do ta vazhdojë zemërgjerësinë e saj të befasishme me rastin e dorëzimit të planit katërvjeçarë të radhës. Nga ana e saj, qeveria duhet të luajë lojë të drejtë me organizatat e artit dhe kur fati ekonomik është i mirë, ato duhet të përfitojnë nga ai. Ngjashëm, paraqitja e një numri pengesash pas dorëzimit të planeve nuk është e kënaqshme. Kjo paraqet prerje, gjithsesi, dhe pothuajse gjithnjë shpie në stagnim artistik, përveç nëse parave të ruajtura iu ndërrohet destinimi për angazhime të tjera artistike në mënyrë që ato të zhvillohen.

Fondet për kulturë ofrojnë zgjidhje afatgjata për shumë prej problemeve të financimit shtetëror. Megjithatë, ato kërkojnë injektimin e shumave

të mëdha të parave dhe do të duhej pjesa më e madhe e shekullit për ta ndryshuar baraspeshën nga mbështetja me të hyra në interes nga investimet. Megjithatë, shuma të konsiderueshme nga jashtë fushëveprimi i shpenzimeve publike, për shembull grantet e lojërave të fatit, mund të përdoren në mënyrë të efektshme për të krijuar stabilitet financiar afatgjatë. Sapo të pranohet se, herët apo vonë, çdo institucion artistik i rëndësishëm do të ndihmohet nga fondet për kulturë me kalimin e kohës, atëherë qeveria mund t'i përshtatë sistemet e veta. Në periudhën afatgjatë, kjo do të nënkuptonte se paratë do të liroheshin nga mbështetja e institucioneve të themeluara dhe në vend të kësaj do të mund të përdroreshin për iniciativa kulturore të reja.

Në rast të llotarive apo shumave të ngjashme të mëdha, duhet të jetë rregull që të ketë baraspeshë mes shumës së dhënë për shpenzime kapitale (për objekte dhe pajisje) dhe shumës së dhënë për programin artistik. Nuk ka kuptim që të ketë objekte madhështore për artet nëse shoqëria nuk mund ta mbulojë punën që parashihej të kryhet në to. Realisht, ashtu siç dëshmohet shpesh nga festivalet, ia vlen që të pajtohesh me kushte më pak se të

përsosura përderisa ka rritje të standardit të performancës. Herët a vonë, gjithsesi, si audienca ashtu edhe artistët do të lodhen nga mungesa e komoditetit dhe nga kushtet teknike jo të duhura, por puna është prapëseprapë më e rëndësishme sesa objekti, edhe nëse politikanët janë shpesh më entuziastë me shënimin e arritjeve të tyre në diçka të ngurtë.

Artet e performancës po ashtu mund të pësojnë ngecje në rast se nuk ka hapësirë për iniciativa të reja. Ashtu si në biznes ku konkurrenca është e rëndësishme, institucionet artistike gjithnjë duhet përballen me sfidën e ideve të reja, ndonëse konkurrenca e fuqishme dhe bisedimet e vazhdueshme për bashkimin e organizatave nuk i shërbejnë askujt. Regjisorët artistikë, megjithatë, gjithnjë duhet të jenë të vetëdijshëm se ata nuk mund të qëndrojnë duarkryq. Andaj, së paku 10% të parasë publike që ndahen për kulturë duhet të rezervohen për ide të reja dhe duhet të mbahen larg institucioneve të themeluara. Megjithatë, nëse idetë e reja do të kenë sukses, ata do të dëshirojnë të bëhen institucione të themeluara. Andaj ata do të dëshirojnë që propozimet e veta të përfshihen në radhën e ardhshme të planifikimit.

Qeveritë (apo agjentët e tyre të afërt) do të përballen me alternativë të vështirë për akomodimin e një sektori në zhvillim e sipër brenda mundësive të veta edhe më modeste për ngritjen e buxhetit. Këtu vijnë në shprehje përparësitë e lirimit të organizatave të themeluara përmes fondeve për kulturë. Në periudhën afatshkurtër, megjithatë, zyrtarët duhet të bëhen më selektiv sesa që mund të dëshirojnë rreth asaj se cilat organizata të reja mund të vazhdojnë përtej fazës eksperimentale. Kjo do të shkaktojë zhgënjim të paevitueshëm, por shumë do të mbijetojnë në një mënyrë apo tjetër dhe, edhe nëse nuk mbijetojnë, reputacionet dhe karrierat e individëve do të jenë zhvilluar, duke dhënë kështu talente të freskëta për sistemet e themeluara të cilat mbizotërojnë.

Organizatave të artistëve duhet të jenë autonome, edhe kur ato ekzistojnë brenda sistemit publik. Modeli i vjetër i Europës qendrore, ku punonjësit e kompanive të performimit ishin punonjës civilë që nuk dallonin nga zyrtarët e tjerë, kishte përparësinë e ofrimit të sigurisë dhe futjes së teatrove dhe orkestrave brenda strukturës së shërbimit publik. Në rastet kur autoritetet kishin marrë përsipër mirëmbajtjen e ndërtesave dhe punësimin e punonjësve,

ndërsa kompanitë i përdornin të ardhurat nga biletat për t'i rritur produksionet, aty ishte përfitimi i shtuar se regjisorët artistikë duheshin të përshtateshin me shijet e audiencës për gjenerimin e parave si kundërvlerë për punën, duke e ditur se objektet themelore nuk ishin nën kërcënim.

Në anën tjetër, kontratat e përjetshme, në veçanti në mesin e stafit të performancave, mund të çojnë te kënaqja me vetveten dhe te mërzi. Performuesit e kanë të vështirë që t'i rifreskojnë karrierat e tyre përmes gjetjes së sfidave të reja në vende të reja, por edhe administruesit e kanë po aq të vështirë ta rifreskojnë kompaninë e tyre pa rritjen konstante të madhësisë së saj, apo pa u bazuar në artistë mysafirë nga rajonet a shtetet e tjera të cilët nuk do të kërkojnë vende pune afatgjate. Situata e dytë shpie në një gjendje ku pjesëtarët e punësuar të kompanisë humbin kundrejt mysafirëve më interesant me rastin e ndarjes së roleve, ndërsa ekziston rreziku se përkatësia kombëtare do të luajë rol të rëndësishëm për të vendosur se kush i bashkohet kompanisë së përhershme dhe kujt i duhet të detyrohet të përballet me një jetë profesionale peripatetike dhe të pasigurt.

Sigurisht se më mirë është që të ekzistojë kompania që i udhëheq rregullat e veta të punësimit, e financuar ashtu siç duhet për një gjë të fillë dhe të ofrojë kontrata me rreziqet dhe garancitë e njëjta si çdo punëdhënës tjetër komercial. Disa kontrata do të jenë për projekte të caktuara, disa do të jenë për një vit ose dy vite dhe të tjerat do të jenë për periudha më të gjata, varësisht nga nevojat artistike të kompanisë. Kjo strukturë kërkon që të ketë ndarje mes qeverisë dhe punonjësve, por se nuk është privatizim në kuptimin ekonomik. Kompania prapë do të mbetet përfituesi i parasë publike dhe qeveria mund t'i kërkojë llogaridhënie për atë dhe si rrjedhojë të ketë interesim mbikëqyrës për aranzhimin e kontratave. Megjithatë, kjo e liron organizatën nga mbajtja e punonjësve të panevojshëm dhe të shtrenjtë dhe ia mundëson asaj që të vendosë për prioritetet e veta buxhetore pa pengesën e përgjegjësisë për pjesën e sistemit shtetëror. Kjo paraqet shkëputje nga modelet e punësimit që janë themeluar nga Louis XIV i Francës dhe nga qytetet e Gjermanisë. Megjithatë sistemi sovjetik ka dëshmuar se sa i pavolitshëm mund të jetë një sistem i fillë nëse lejohet të zhvillohet deri në ekstremin logjik të tij. Nëse alternativa e autonomisë trajtohet me vullnet të mirë



dhe financim të arsyeshëm, nuk ka arsye që ai të mos ofrojë sektor të sigurt, por të fuqishëm të performimit me benefitet nga ndërhyrja e ulët politike, liria artistike dhe besimi i publikut. Në shtetet ku qeveria në shek. XX ka insistuar që të ketë fjalën e saj të paarsyeshme në politikën artistike, autonomia transparente mund të sigurojë se marrja e parave nga autoritetet nuk nënkupton pranimin e kontrollit.

Infrastruktura për kompanitë e performimit në shtetet bashkëkohore evropiane duhet të mundësojnë sa më shumë ndryshime që është e mundur. Në disa shtete (kryesisht në ato me tradita apo ndikim gjerman) sistemi i teatrove i bazuar në qytet me numër të plotë të aktorëve dhe muzikantëve nga radhët e stafit konsiderohet të jetë norma. Performancat varen shumë nga shitjet e abonimeve dhe ndërtesat përdoren relativisht pak, përveç nga kompania rezidente. Një kompleks i ngjashëm lokal i hollit të koncerteve shpeshherë është në dispozicion, ndonëse këtu ka më shumë mundësi që datat e sigurohen nga promovuesit e jashtëm dhe që artistët që shfaqen të jenë më të llojllojshëm. Në shumë shtete të tjera kompanitë e mëdha të operateve dhe të vallëzimeve, si dhe orkestrat,

janë më shumë të vendosura në nivele rajonale, të cilat shpesh kanë mundësi të ndahen nëpër ansambël më të vegjël për të udhëtuar për në qendra më të vogla që kanë objekte pritëse, por që nuk kanë (apo kanë më pak) performues rezidentë. Këtu sezonet më të shkurta dhe festivalet luajnë rol më të madh në jetën artistike. Asnjëri prej modeleve nuk është më i mirë apo më i keq, ndonëse edhe në qendrat pa kompani të plotë është e rëndësishme që të ekzistojnë mundësi lokale për produksione të zhvilluara nga vendi. Një lloj, një qytet me ansambël rezident mbresëlënës duhet të jetë i hapur për shkëmbime me institucionet e tjera, përndryshe publiku do t'i nënshtrohet një vargu të kufizuar në mënyrë të panevojshme të stileve. Jeta artistike mund të bëhet bajat shumë shpejt nëse nuk ka me çka të krahasohet. Një nga sukseset e mëdha të fundit të shek. XX është se ndërtesat për performim të trashëguara nga shek. XIX janë shtuar dhe zëvendësuar me energji mbresëlënëse nga ana e autoriteteve të të gjitha bindjeve politike. Ndonëse jo të gjitha teatrot apo hollët e koncerteve nuk janë kryevepra arkitektonike (ekzistojnë disa godina të frikshme nga betoni të cilat janë shumë të pakëndshme për ndonjë konferencë, apo për të dëgjuar muzikë në to), me një nivel besimi

mund të thuhet se në Europë nuk ka pothuajse asnjë qendër e populluar pa qasje në ndonjë hapësirë funksionale për performanca.

Themelimi i institucioneve artistike madhore megjithatë nuk e përfundon tërë tregimin. Performuesit i shfrytëzojnë të gjitha llojet e hapësirave, prej kishave e deri te ambientet e hapura, prej ndërtesave të vjetra industriale deri te uji. Konteksti shpeshherë është element suprem në ndonjë performacë – fryma e vendit mund të jetë po aq e fuqishme sa edhe fryma e përmbajtjes – dhe përshtatja e ndonjë hapësire për përdorim të freskët mund t'i japë jetë të re punës ashtu edhe rrethinës, gjë që tërheq publikun, i cili zakonisht do të ndihej jo rehat nga vendet konvencionale. Kështu muzikantët e muzikës rok dalin nëpër fusha, stadione të futbollit dhe fabrika të vjetra të duhanit, për t'u përcjellë nga kompanitë e operave, valltarët dhe producentët e filmave. Gërmadhat e kështjellave bëhen teatro të ndriçuar nga pishtarët, pallatet e papërdorura kumbojnë muzikë elektronike, poetët performojnë nëpër klube të muzikës xhaz dhe kuartetet e instrumenteve me tela i okupojnë qendrat tregtare. Në të vërtetë pothuajse nuk ka asnjë vend (përveç ndoshta nën

ndonjë pistë aeroplani) ku artistët nuk mund të performojnë, ndonëse disa kombinime do të jenë dukshëm më të mira sesa të tjerat – një këngë nga Schuberti në të vërtetë nuk tingëllon shumë mirë në ndonjë thetore dhe muzika rok nuk përshtatet këndshëm në ndonjë dhomë pritjeje në stilin barok.

Autoritetet publike mund të ndihmojnë për këtë shfrytëzim aventurist të hapësirave për performime përmes minimizimit të rregullave burokratike. Shpeshherë, për shembull, ekzistojnë rregulla për parkim, zhurmë, mirësjellje, dhe zjarr, të cilat janë të nevojshme për kontrollimin e situatave të përhershme, por të cilat në ndonjë rast mund të zbuten pa ndonjë vështirësi për ta mundësuar mbajtjen e ndonjë evenimenti artistik pa u shkakuar qytetarëve shqetësime. Ngjashëm, kodet e ndërtimit nuk do të duhej të ishin aq të rrepta sa për ta kufizuar ridizajnimin imaxhinativ të ndonjë ndërtese të vjetër për përdorim artistik. Artet e performancës e bëjnë jetën më sociale dhe më të ndritshme. Për shoqërinë kjo ka më shumë rëndësi sesa respektimi i rreptë i rregullave.

Si publiku ashtu edhe vetë performuesit do të jenë të entuziazmuar nga ndërlihdjet e befasishme nëpër

vende të pazakonta. Ndërthurja e ideve i gjallëron metodat e punës dhe rezulton në krijimin e projekteve të reja. Këtu përfshihet udhëtimi dhe rrjetëzimi, i cili për procesin e zhvillimit artistik është po aq thelbësor sa edhe vetë provat. Andaj është thelbësore që artistëve t’iu mundësohet të udhëtojnë dhe punojnë lirshëm. Nuk ka nevojë për kufizimet e llojit të imigracionit, vizave dhe lejes për punë, të cilat i zbatojnë shtetet kundrejt punëtorëve industrialë migrues. Në shumicën e rasteve artistët janë thjesht të kënaqur të kthehen në vendin e tyre dhe të vazhdojnë punën e tyre – meqë artistët kreativë e gjejnë frymëzimin e tyre ngjashëm si në vendin e tyre ashtu edhe jashtë tij – por edhe kur të vendosin që të qëndrojnë në ndonjë vend të largët, është vështirë të gjendet ndonjë shtet, i cili nuk ka përfituar shumë nga artistët që janë vendosur në të. Larg nga kufizimi i lëvizjes së artistëve, shtetet duhet t’i mirëpresin ata me duar të hapura, qofshin ata për vizitë apo për të qëndruar. Përfituesit do të jenë qytetarët të cilët do të kenë mundësi t’i shohin frytet e talentit të botës.

Kjo më së miri shfrytëzohet nëpër festivale. Festalet kanë qenë risitë më të suksesshme të programeve gjatë 100 viteve të fundit. Festivali më

i hershëm europian i rregullt i muzikës që ende frymon është festivali Three Choirs i Anglisë, i cili çdo vit migron mes qyteteve Hereford, Worcester dhe Gloucester që nga viti 1724, por tradita bashkëkohore pati një lulëzim të vërtetë pas themelimit të Festivalit të Salzburgut në vitin 1920. Vështirë se mund të gjendet ndonjë qytezë apo fshat që tani nuk është nikoqir i ndonjë lloji të festivalit të arteve me rregullsi të arsyeshme. Megjithatë politikat publike drejt festivaleve janë zhvilluar me një ngadalësi, kryesisht për shkak të kërkesave paraprake për financime nga ana e institucioneve të themeluara të cilat veprojnë gjatë tërë vitit. Megjithatë festalet e freskojnë jetën artistike të qyteteve si asnjë pije. Ato e transformojnë imazhin e vendeve që më parë janë parë si vende të mërzitshme. Ato e përqendrojnë vëmendjen në bukuritë e atyre që kanë rrëshqitur për sa i përket trendit. Ato i vënë në pah vendet që janë injoruar nga bota e jashtme dhe ofrojnë ngjarje artistike, nëpër komunitetet rurale, të një standardi që asnjëherë nuk mund të ofrohet në vazhdimësi. Më shumë se kjo, ato u ofrojnë artistëve dhe publikut një periudhë të përqendruar të aktiviteteve që i stimulon ata shumë më shumë sesa përvojat e rastësishme të çrregullta gjatë

pjesës tjetër të vitit. Ato bëjnë që vendet dhe njerëzit të ndihen të veçantë. Një politikë e duhur për sektorin e arteve performuese i trajton festivalet si një nga mënyrat më të efektshme për arritjen e rezultateve.

### **Industria e kulturës**

Jo të gjitha aktivitetet kulturore humbin para, në realitet shumica e tyre nuk kanë për qëllim të humbin para, por qëllimi i tyre nuk është plotësisht i orientuar në bërjen e parave. Ekzistojnë disa pjesë të jetës kulturore të cilat jo vetëm që e mbështesin vetveten, por edhe që kontribuojnë në masë të konsiderueshme për të ardhurat e shtetit. Për secilën formë të artit të subvencionuar ekziston një dorë e ndërlidhur komerciale me të cilën raporti është simbolik. Ndonëse sektori i subvencionuar i ka objektivat e veta, të cilat nuk kanë tendencë komerciale, ai prapëseprapë e ka efektin e të qenit krahu i industrive kulturore për hulumtime dhe zhvillime. Orët e muzikës në sistemin arsimor i ndezin industritë e rokut dhe popit si dhe biznesit të incizimeve klasike, ku ky i fundit do të ishte krejtësisht i paqëndrueshëm nëse nuk do të mund të bazohej në orkestrat e subvencionuara dhe koret katedrale. Edhe orkestrat që janë pothuajse plotësisht të liruara nga subvencionet

(shembujt aktualë përfshijnë Orkestrën Monteverdi të John Eliot Gardinerit dhe Orkestrën Kombëtare Ruse të Mikhail Pletnyevit) janë të varura nga vendet dhe festivalet e subvencionuara për shumicën e punës së tyre.

Këtu nuk ka vend për t'i cekur politikat e hollësishme për të gjitha industritë kulturore – të cilat përfshijnë filmat, televizionin, radion, teatrin komercial dhe incizimet dhe promovimet muzikore, botimet e librit, dizajnin, stolitë, restorantet, modën, gazetat dhe revistat, reklamat, orenditë dhe qeramikat. Megjithatë, ekzistojnë linja të përbashkëta të cilat kalojnë nëpër kushtet e të gjitha prej tyre. Por, një gjë është e vërtetë, ato të gjitha janë biznese të vogla. Edhe konglomerati më i madh që e përdorë kulturën është i vogël në lojën multinacionale të prodhimit. Ato po ashtu kanë tendencë të funksionojnë më së miri si ndërmarrje të vogla dhe të mesme, kryesisht për shkak se ato varen nga vizioni dhe prirja kulturore e një numri të vogël të individëve e jo nga funksionimi pa ndonjë problem i menaxhmentit. Zakonisht ekziston një madhësi optimale për biznesit kulturor. Ai e arrin vendin dominues në treg dhe pastaj ndahet dhe profilizohet (në rastin e botuesve dhe

të kompanive të incizimit), të cilat e rifitojnë individualitetin dhe energjinë e tyre përgjatë procesit.

Ashtu si çdo industri tjetër, ato që rrjedhin nga kultura kanë nevojë për një mjedis të qëndrueshëm dhe inkurajues të biznesit. Ato kanë nevojë për një rrjedhë të vazhdueshme të talenteve të afta dhe imagjinuase. Megjithatë, për shkak se janë përbërës jetik të imazhit që ndonjë vend e ka në botë, nuk mund të lihet tërësisht nën mëshirën e fatit të tregut. Në kuadër të konkurrencës dhe rregullave botërore të tregtisë, funksioni i tyre i veçantë duhet të njihet brenda sistemit fiskal. Kjo mund të përfshijë lehtësimin në krijimin e kapitalit për prodhimin e filmit, alokimin e granteve për faza kërkimore (zhvillimin e skriptit, hulumtime në proceset teknike, ndihmë dhënë dizajnuesve të rinj dhe - shih më poshtë - trajnime të specializuara, dhe përfundimin e librave nga tatimet nga shitja, apo tatimet e vlerës së shtuar.

Qeveria mund të jetë bujare edhe me ndihmën e saj për fillimin e bizneseve, përmes ofrimit të parave për pajisje dhe për mbulimin e kostove për stafin themelues, ofrimit të akomodimit me një të qira të ulët, apo pa qira fare, ofrimit të “pushimeve” nga tatimet (ku për

periudha të rëndësishme të zhvillimit tatimet hiqen ose shtyhen) dhe pranimit të natyrës së rrezikuar të ndërmarrjeve kulturore embrionale, duke e trajtuar stafin si të vetëpunësuar deri në kohën kur biznesi të jetë i sigurt.

Edhe autoritetet lokale mund të ndihmojnë në mënyra të ngjashme. Hapësirat e punëtorive dhe studiove në zhvillime të reja, apo ndërtesa të mobiluara, jo vetëm që mund t'i ndihmojnë biznesit kulturor, por përmes operimit të kompanive të llojllojshme në një zonë, biznesi kulturor mund të bëhet më tërheqës në përgjithësi dhe të bëhet forcë e fuqishme për revitalizimin e një ndenje të qëllimit në ndonjë zonë në ngecje. Dhënia e zonave për filmime, bashkërendimi i objekteve dhe i pajisjeve për ta lehtësuar kryerjen e punës audio-vizuale, janë tejet të rëndësishme për t'i tërhequr produksionet shumëkombëshe të cilat krijojnë zhgënjim nga vetë mendimi i nevojës për të aranzhuar tejet e pafundme burokratike që iu nevojiten për të filluar ndonjë filmim – ku mbyllja e rrugëve, shkrimi i lajmërimeve për vendparkime, heqja e orendive nëpër rrugë, pozicionimi i objekteve të hotelerisë, sigurimi i dhomave të hotelit dhe i banesave, mbajtja e publikut në një distancë të sigurt dhe sigurimi i

furnizimit me energji elektrike, janë vetëm disa prej elementeve.

Dhënia e stimulimeve industrive kulturore është vetë biznes konkurrues, ku qytetet, zonat rurale, rajonet dhe shtetet konkurrojnë mes vete për të tërhequr ndërmarrës. Për këtë ekziston një arsye e mirë. Në një epokë ku prodhimi është duke u larguar nga zonat qendrore tradicionale të tij të shek. XIX dhe të fillimit të shek. XX, industritë kulturore ofrojnë mënyra të dobishme për krijimin e një ndjenje të gjallërisë dhe një niveli të konsiderueshëm të punësimit. Ato gjenerojnë veprimtari plotësuese për vende të punës në fushën e turizmit dhe të shërbimeve.

Ato po ashtu përfaqësojnë filozofi industriale në përputhje me moshën e vet – të vogla, relativisht miqësore për ambientin, kombinim i shëndoshë i teknologjisë së lartë dhe i zejeve tradicionale dhe të lëvizshme. Industritë kulturore shpeshherë i rishfrytëzojnë objektet nëpër zona të shkreta bujqësore dhe industriale dhe ua rikthejnë një masë krenarie dhe dukje pozitive. Për shkak të afërsisë së lidhjes mes kreativitetit dhe prodhimit, ato po ashtu ofrojnë karriera të cilat, edhe nëse nuk janë fitimprurëse, janë më përmbushëse se shumë të tjera.

Teknologjitë e reja iu ofrojnë industrive pamje të re. Mundësitë për transmetime digjitale, për dizajne të softuerit, si dhe mundësitë që artistët të kenë vegla pune që ua bëjnë mundësitë e tyre për të krijuar dhe kombinuar pamje pothuajse të pakufishme, janë duke u hapur me një shpejtësi që është parashikuar vetëm gjatë viteve të fundit. Mjaft larg nga ofrimi i mënyrave më të drejtpërdrejta të kontaktimit me tregun, që shpeshherë i largon ndërmarrësit me pakicë, teknologjia kompjuterike i ka shkurtuar proceset e prodhimit, ka revolucionarizuar stoqet dhe informimin e klientëve dhe ka bërë që lokacioni të mos jetë vetëm jorelevant, por edhe i pagjurmueshëm. Për botuesit e vegjël ajo e ka larguar (dhe do të vazhdojë ta largojë edhe më shumë) pengesën madhore të librarive që mbajnë stoqe të kufizuara nga kompanitë e mëdha ndërkombëtare. Interneti ua mundëson botuesve të vegjël dhe botuesve vetanake që të vënë tituj në dispozicion pa pasur nevojë të bazohen në teket e distributorëve dhe të dyqaneve. E njëjta vlen edhe për kompanitë e vogla incizuese, kompanitë e videove dhe dizajnerët e llojlojshëm.

Ajo gjithashtu ka mundësi që te

klauzola në marrëveshjet për çmimet e shitjeve me pakicë të librave, gjë që tashmë është duke u sulmuar në disa shtete evropiane ku shitësit e mëdhenj me pakicë nuk e tolerojnë pamundësinë që t'i zbresin çmimet e librave më të shitur. Ndonëse kjo mund të nënkuptojë që libraritë e vogla kanë gjasa që të specializohen më me kujdes, të mbajnë libra të ri si dhe të përdorur, apo të krijojnë aleanca për të ofruar çmime konkurruese (siç kanë bërë lokalitetet e vogla të ushqimit që nga vitet e shtatëdhjeta) nuk ka ndonjë arsye të vërtetë pse shkrimtarët duhet të preken negativisht nëse zbritjet e çmimeve rezultojnë me më shumë shitje dhe kontratat e tyre parashohin tantum bazuar në një proporcion të çmimit që paguhet nga shitësi me pakicë, e jo në çmimin që i jepet lexuesit.

### **Mediet**

Mediet, natyrisht, se janë industri kulturore domethënëse. Megjithatë ato ngrisin çështje që disi ndryshojnë nga ato që janë të lidhura më drejtpërdrejt me dizajnimin dhe prodhimin. Pjesa më e madhe e politikave të medieve rrallëherë është në përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të ndonjë departamenti kulturor – çështjet e konkurrencës, dhënia e frekuencave të valëve dhe rendi teknik dhe publik.

Megjithatë ka ndërlikueshmëri të cilat kanë nevojë të trajtohen nga një këndvështrim kulturor: përqendrimi i pronësisë, liria e të shprehurit, shpërndarja e përmbajtjes kulturore, çështjet e shijes, mbajtja e transmetuesve shtetëror në sistemin digjital me shumë kanale dhe çështja e strukturave financiare (përfshirë rregulloret për reklamimin).

Përqendrimi i pronësisë bën që dy parime të rëndësishme të teorisë politike bashkëkohore të ndeshen me njëra-tjetrën. Nga njëra anë është në natyrën e ndërmarrjeve private që ato të synojë zhdukjen, apo inkorporimin e rivalëve. Qeveritë po aq të pasigurta apo të tej-ndjeshme do të dëshirojnë që t'i kontrollojnë informatat që përhapen rreth tyre. Që të dyja qëndrimet janë shkatërruese si për lirinë e të shprehurit ashtu edhe për diversitetin kulturor. Nëse një numër shumë i vogël i personave apo i kompanive kontrollojnë një pjesë të madhe të infrastrukturës së shtypit dhe transmetuesve, atëherë mundësitë për debate dhe mbulueshmëri kulturore të papenguara do të jenë në vartësi të interesave komerciale dhe politike të korporatave mediatike dominuese. As kjo nuk do të jetë çështje lokale.

Interesat mund të mos kenë asgjë të bëjnë me shtetin përkatës, por mund të jenë të lidhura në ndonjë pjesë tjetër të perandorisë së biznesit në anën tjetër të botës.

Deri më sot nuk ka ekzistuar asnjë mangat i medieve të cilit nuk i ka pëlqyer zëri i vet dhe shijimi i mendimit të imponimit të atij zëri mbi qeverinë. Nuk ka asgjë të keqe në atë nëse një individ kërkon që mendimet e veta t'i përcjellë te sa më shumë persona (me kusht që mendimet të mos nxisin urrejtje dhe dhunë). Megjithatë, kur ndonjë individ, apo korporata që ai e kontrollon, manovron në pozicion ku zëri i tyre bëhet një prej zërave të pakët me mundësi ndikimi mbi ngjarjet, atëherë liria zvogëlohet, nuk zgjerohet. Në teori, interneti, transmetimi digjital, kabllor dhe ai me satelit dhe lehtësia e shtypjes dhe e shpërndarjes së gazetave duhet ta përhapin bëjnë diversitetin e shikueshmërisë. Në vend të kësaj, kontrolli i drejtpërdrejtë editorial është duke u zëvendësuar me kontrollin e mënyrave të shpërndarjes, qoftë ai fizik apo elektronik. Duke siguruar që ato të kenë veto mbi atë se kush ka qasje në publik, korporatat e dinë se redaktorët dhe personat që i dizajnojnë formatet e kanaleve do të bëjnë atë që pritet nga ta.

Në fund të fundit, nuk ka shumë oferta për ndonjë karrierë alternative.

Ndikimi i njëjtë editorial mund të ushtrohet nga ata reklamata e të cilëve paguajnë për transmetim dhe publikim komercial. Mes departamenteve të redaksisë dhe të reklamave duhet të ekzistojë një ndarje e rreptë. Kjo është më lehtë të thuhet sesa të arrihet, gjithsesi, nëse ajo është arsyeja e vetme e reklamuesve pse ata paguajnë për hapësirë për të arritur tek audiencat të cilat ata mendojnë se mund t'ua pëlqejnë produktin.

Është e pashmangshme që me kalimin e kohës një pjesë e strategjisë së tyre të jetë ndikimi te qëndrimi editorial, në mënyrë që të tërheqin personat që synohen nga reklamuesit.

Qeveria sillet në pothuajse të njëjtën mënyrë. Pavarësisht sa demokratik dhe parimor që është sistemi, ai gjithnjë do të përpiqet t'i bindë mediet që botën ta portretizojnë ashtu si regjimi dëshiron të shihet. Këto të gjitha janë fakte të jetës mediatike. Politika kulturore duhet ta luajë rolin e vet për të siguruar një baraspeshë që do të mjaftojë për ta kthyer bilancin në favor të qytetarëve dhe të së vërtetës.



Politikat duhet të ofrojnë mundësi për diversitet të pikëpamjeve dhe për karakteristika lokale, rajonale dhe nacionale, qofshin ato linguistike, aktuale apo artistike. Kushtet për kuotë në kanalet transmetuese kanë qenë shumë më të suksesshme sesa që pretendojnë operatorët komercialë. Ato kanë mbështetur dhe stimuluar dramën, lajmet dhe mbulimin tjetër regjional në zonat, të cilat qoftë për shkak të madhësisë, qoftë të gjuhës, do të qëllitëshin lehtësisht nga ndikimi masiv nga jashtë. Teoritikisht, kjo do të jetë vështirë për t'u mbajtur kur radiot dhe televizionet digjitale ofrojnë me qindra kanale. Megjithatë, nuk ka ndonjë arsye të vërtetë se pse duhet të jetë kështu. Në të vërtetë, mund të jetë mundësi e shkëlqyer për ato kanale me përbajtje të specializuara, apo me përbajtje specifike kulturore, që të arrijnë tek audiencia e tyre nga diaspora në mbarë botën. Për herë të parë një australian me origjinë lapp-e do të ketë qasje të lehtë në gjuhën dhe kulturën e shtetit nga i cili vjen. Faktikisht, derisa njerëzit do t'i shikojnë në mënyrë të pashmangshme kanalet dhe programet më të popullarizuara të botës, po ashtu do t'i shikojnë dhe dëgjojnë edhe transmetuesit e vendeve që i shohin si

vende të veta. Programet të cilat vuajnë për sa i përket konkurrencës globale, me shumë gjasa do të jenë ato të cilat janë kopje jo të mira të programeve të tjera që kanë buxhete më të mëdha dhe vlera më të larta të produksionit. Kjo nuk është diçka e keqe. Tregu mund t'i lihet vetvetes kur programet janë plotësisht komerciale. Kur shtetet dëshirojnë të sigurojnë mbulueshmëri të lajmeve dhe sportit të tyre, mbijetesën e transmetimeve të tyre artistike dhe të ngjarjeve aktuale, kushtet për kuotë që duhet të plotësohen nga transmetuesit do t'i sigurojnë ato deri në një masë të caktuar. Përvoja e viteve 1980 dhe 1990 tregon se kanalet që kanë për qëllim krijimin e programeve të cilat në teori kujdesen vetëm për audiencat e specializuara gjejnë treg shumë të gatshëm dhe janë po aq tërheqëse për reklamuesit sa edhe për politikanët. Nëse ato mbrohen nga marrja përsipër, "shurdhimi" dhe shkrirja nga ndonjë regjim rregullativ i fuqishëm, diversiteti dhe përfitimi i sektorit mund të shtohet dhe përqendrimi të zhduket.

Çështjet e shijes, njerëzisë dhe pranueshmërisë së përmbajtjes janë gjithnjë të vështira për autoritetet në shtetet e lira. Shumica e shteteve europiane tani e pranojnë një qëndrim të relaksuar ndaj pamjeve të seksualitetit të njeriut dhe në të vërtetë interneti ka bërë që kontrollat të kenë më pak kuptim sesa në të kaluarën. Arsyeja për të kërkuar marrëveshje ndërkombëtare për transmetim ngrihet atëherë kur pamjet e dhunës kërcënojnë shkeljen e ligjeve dhe konventave të tjera, në veçanti ato që përfshijnë fëmijët. Kodet ndërkombëtare janë të vetmet që kanë mundësi të jenë të zbatueshme – ndonëse Europa duhet të ketë kujdes që të sigurojë se klima e saj seksuale, që në përgjithësi është liberale, nuk do të sprapsët në moralin e së kaluarës nga ana e zërave puritanë më kumbues nga Shtetet e Bashkuara, Lindja e Mesme apo, në të vërtetë, nga vetë ujërat e vet reagues.

Transmetuesit shtetërorë, të cilët nuk varen plotësisht nga të hyrat komerciale, por që financohen nga shteti, janë anakronizëm në një epokë digjitale. Ata janë themeluar pjesërisht për shkak se frekuenat analoge të radios dhe televizionit ishin të pakta dhe të shtrenjta për transmetim, pjesërisht për shkak se qeveritë dëshironin t'i kontrollojnë

informatat në një medium të ri kaq të fuqishëm dhe pjesërisht për shkak se, sapo shteti të ketë transmetues shtetëror, ishte e pashmangshme se edhe të gjithë të tjerët duhet ta dëshirojnë një të tillë. Baraspesha e financimit mes marketingut dhe tatimitit ka ndryshuar – që nga kanali BBC i Britanisë që nuk ka fare reklamim dhe setet e licencuara të televizioneve, e deri te kanalet e Italisë që janë të dominuara nga komercializmi. Shkaku pse një transmetues shtetëror është anakronizëm, megjithatë, nuk nënkupton se ai nuk ka rol, apo se ai duhet të shpërbëhet. Megjithatë, ai duhet ta ketë lirinë që të gjenerojë sa më shumë financa që mundet jashtë sistemit të shtetit dhe ta ruajë mundësinë që ta shfrytëzojë potencialin e vet komercial aty ku mundet, me kusht që të ardhurat të riciklohen në prodhim, në vend se t'ua shpërndajë personave ekzekutivë, apo aksionarëve të vet. Transmetuesit shtetëror gjithashtu duhet t'i parandalohet përdorimi i përparësisë së tij që t'ua heqë mundësitë për të tërhequr reklama atyre që varen plotësisht nga ai. Kjo është arsyeja pse kufizimi i kanaleve që mund të pranojnë reklama mund të jetë kuptimplotë, e jo pastërtia e programit. Nëse qeveritë dëshirojnë të sigurojnë vazhdimësinë

dhe cilësinë e programeve ato munden (ndoshta edhe duhet) ta kufizojnë numrin e minutave në çdo orë apo program ku lejohen reklamat. Kjo jo vetëm që e ruan cilësinë e lartë dhe përqendrimet dramatike, por e bën reklamimin më fitimprurës për kompanitë e televizioneve dhe radiove përmes ngritjes së vlerës së rrallë të intervaleve kohore.

Përparësi e epokës digjitale është se transmetimet tani mund të jenë të llojllojshme dhe të lehta për t'u shfrytëzuar sa edhe botimet. Transmetimet mund të ofrojnë një varg të ngjashëm të gjërave speciale dhe të opinioneve. Megjithatë, ka ende hapësirë për transmetuesin e përgjithshëm që ofron mbulueshmëri për audiencën me shkathtësi dhe autoritet.

Pavarësisht tundimeve dhe presioneve nga korporatat ndërkombëtare ambicioze (të cilat kanë të drejtë të plotë për vendin e tyre - por jo të drejtë ekskluzive - në treg), qeveritë duhet të vazhdojnë t'i financojnë dhe strukturojnë sistemet vendase për mbrojtjen e interesave vendase. Kjo nuk duhet ta mbyllë opsionin për pjesëmarrje të plotë në rrjetet digjitale. Në vend të kësaj, kjo do ta ruajë një kënd për shqetësimet vendase që nuk dallon nga mënyra se

si ligjet për planifikime i parandalojnë kompanitë shumëkombëshe të hotelerisë që të mos i shkatërrojnë lokacionet e trashëgimisë që nuk iu përshtaten atyre.

# VI. Arsimi dhe trajnimet

*Ai ndihmoi për ta prishur argumentin e drejtorit të shkollës, ishte i tridhjetetreti në trigonometri, dhe, siç mund të pritet, e redaktoi revistën shkollore.*

**Dylan Thomas**

*Return Journey*

Arsimi është element jetik në politikat kulturore dhe nuk mund t'i lihet plotësisht departamentit të arsimit për shqyrtim. Aq është qendror saqë është e drejtë të thuhet se përgatitja e personave për t'iu bashkuar kulturës së tyre ka të njëjtën rëndësi sa përgatitja e tyre për punë. Që të dyja janë tejet të ndërlidhura me vete, në veçanti kur Europa largohet nga baza e saj e industrisë së rëndë drejt industrive kreative si motor kryesor i punësimit. Andaj në këtë kapitull duhet shqyrtuar dy çështje: arsimimi i qytetarëve për t'ua mundësuar shijimin e jetës kulturore dhe pjesëmarrjen e plotë në të dhe arsimi që nevojitet për t'ua mundësuar një numri të qëndrueshëm të personave që t'i zhvillojnë karrierat në sektorin kulturor.

Lëndët kulturore në arsim janë po aq të dobishme sa edhe ato shkencore. Në të vërtetë, shpeshherë që të dyja janë të dobishme për njëra-tjetrën. Ekzistojnë dëshmi për ta mbështetur

idienë se mësimi i një instrumenti muzikor ndihmon për koordinim dhe për proceset e progresit logjik, që si rezultat iu ndihmon fëmijëve për ta menaxhuar matematikën. Ngjashëm, besimi dhe vetëbesimi që fëmijët e përvetësojnë nga drama, vallëzimi dhe shkrimi i poezive u ndihmon atyre me lëndët e tjera, si lëndët gjuhësore. Ky është argument i dobishëm me ata (dhe janë të shumtë) që i shohin lëndët kulturore si “të buta” dhe kalimtare. Ka tendencë që shumë sisteme arsimore të kenë rezistencë të ngulitur ndaj trajtimit të lëndëve kulturore me seriozitet. Është e dukshme, për shembull, se sa pak mësimdhënës të lëndëve të muzikës, dramës dhe të artit ngrihen në hierarkinë e shkollës për t'ua bërë mësimdhënës kryesorë, apo nëpër burokraci për t'ua bërë drejtorë të arsimit në autoritetet lokale.

Megjithatë, argumenti i vërtetë për fillimin e arsimit kulturor në fëmijërinë e hershme dhe vazhdimin e tij përgjatë periudhës së arsimit formal është se pa një gjë të tillë përgatitja për jetë nuk do të ishte e plotë. Ne jetojmë në një kohë ku mundësitë për hulumtimin e kulturës rreth nesh janë të mëdha si kurrë më parë. T'i humbësh këto mundësi nënkupton t'i humbësh në

masë të madhe burimet njerëzore të shteteve tona. Megjithatë, ne duhet të bëjmë kujdes me mënyrën e prezantimit të njerëzve me kulturën. Është thënë se ne e kalojmë jetën si të rritur duke u rimëkëmbur nga arsimimi ynë – duke i rikthyer lidhjet e thyera nga kurrikula formale shkollore dhe sistemi i provimeve (kjo është arsyeja pse mundësitë për t'u kthyer dhe mësuar më vonë kërkohen më pastaj). Si me sportet, njeriu mësohet ta shijojë kulturën duke marrë pjesë në cilindo nivel që ne mundemi. Fëmijëve duhet t'u ngulitet mendimi se ata mund dhe do t'i shijojnë artet dhe se sa më thellë që ata të gjurmojnë, aq më të dobishme do të bëhen lëndët. Pra, krijimi i muzikës në praktikë, të mësuarit e të dëgjuarit, luajtja me instrument dhe këndimi ofrojnë një fillim më të qëndrueshëm sesa mësimi akademik i teorisë kritike, apo i historisë së stilit. Nëse fëmijët janë të mbushur me entuziazëm, ata do të kërkojnë që ta mësojnë edhe historinë, me kusht të ajo të mësohet në frymën e zbulimeve, e jo si pjesë e ndonjë procesi të gjykimit.

Arsimi nuk zhvillohet vetëm brenda klasës. Dhe edhe kur ndodh kështu, arsimi kulturor funksionon më së miri kur dihet përvoja e jashtme. Për këtë

arsye është me rëndësi që çdo kompani dhe organizatë artistike që merr fonde nga autoritetet publike ta lidhë punën e vet me sistemin arsimor – përmes dërgimit të performuesve, regjisorëve, shkrimtarëve dhe artistëve nëpër shkolla për të punuar me nxënësit dhe mësimdhënësit e tyre, rezervimit të performancave dhe biletave me çmime koncesionare për studentët dhe grupet nga shkollat, dhe përfshirjes së tyre në procesin krijues, duke ua bërë të mundur që të punojnë së bashku me kompozitorë, producentë të filmave, etj. Kjo shpeshherë del të jetë përfituese për profesionistët aq sa edhe për studentët, duke i ndihmuar që ta rizbulojnë entuziazmin dhe të mësojnë nga përvoja e zhveshjes së artit të tyre dhe ribashkimit të tij për një audiencë të re. Përfshirja e kësaj pune gjithashtu ka efekt në shtimin e audiencave të ardhshme (përderisa pjesa tjetër e politikave – çmimet, përfshirja sociale etj., nuk përbën pengesë më vonë). Megjithatë, ky është përfitim shtesë. Fituesi i vërtetë është sistemi shkollor, i cili bëhet më pak institucional dhe e fiton mundësinë që të bëhet plotësisht i përfshirë në jetën rreth tij.

Arsimi kulturor nuk është vetëm importues. Ai mund t'i eksportojë

mundësitë e veta tek ata që ndihen të përjashtuar nga pjesa tjetër e shoqërisë. Për të papunët dhe ata që vijnë nga grupe të pafavorizuara – imigrantët dhe refugjatët, për shembull, shfrytëzimi i arsimit kulturor si pjesë e ndonjë programi kontakues mund të jetë tejet efektiv. Ai ofron mënyrë për t'i përfshirë njerëzit në shoqëri. Personat nga grupet e pafavorizuara nuk janë të vetmit që më vonë përfitojnë nga të mësuarit rreth artit dhe trashëgimisë. Shumë njerëz e rrisin dashurinë e tyre për artet me kalimin e viteve, edhe atëherë kur ata i kanë anashkaluar kur kanë qenë të rinj. Në kohën kur ata fillojnë të dëshirojnë t'i gjurmojnë artet, megjithatë, ata shpeshherë i kanë harruar mësimet që i kanë mësuar në shkollë apo i kanë ngritur barrierat psikologjike të turpërimit nga injoranca e tyre apo mungesa e njohurive. Ata do të dëshirojnë të kenë qasje në sistemin arsimor jashtë orarit të punës, apo në ndonjë atmosferë më pak formale sesa në atë që e ofrojnë ambientet e klasave apo universitetit. Këta njerëz duhet të inkurajohen nga bërësit e politikave kulturore. Në fund të fundit, kjo është çështje e trajnimit të audiencës.

Zhvillimi i politikave në këtë fushë nënkupton arsimimin e arsimtarëve

në po atë nivel sa edhe marrësit e arsimit. Hapja e sistemit në mënyrë që ndërtesat shkollore dhe universitare – hollët, bibliotekat, studiot, objektet dhe pajisjet e artit – që janë të dispozicion për komunitetin duhet të jenë prioritet. Sigurimi se departamentet e shkollave dhe universiteteve që janë në kontakt të rregullt me artistët dhe profesionistët e kulturës duhet të jetë detyrë, dhe autoritetet lokale duhet të mbajnë regjistra të personave që janë aktivë në rajonin e tyre në mënyrë që ata të kontaktohen. Jo çdo artist mund të dëshirojë të japë mësim (apo të jetë i aftë për mësimdhënie), por zakonisht ekziston një aspekt i punës së tyre, të cilën ata do të mund ta shpjegojnë në mënyrë më të efektshme sesa të tjerët. Trajnimi i mësimdhënësve në mënyrë që ata të fitojnë aftësi për t'i përgatitur klasat për të punuar me profesionistë – dhe për ta përcjellë projektin kur ata të kenë shkuar – është çelësi për arritjen e rezultateve afatgjate (dhe shpeshherë gjë që nuk vërehet nga administratorët). Mësimdhënësit nuk duhet t'i trajtojnë vizitat e ndonjë organizate apo profesionisti të artit si kohë të lirë për mirëseardhje. Ato duhet të jenë element i integruar i lëndës. Po ashtu ofrimi i një vargu të gjerë të objekteve dhe pajisjeve shtesë arsimore në lëndët kulturore (pa

pagesë apo me çmim të ulët) duhet të jetë detyrë e të gjitha autoriteteve arsimore. Nuk është e thënë që arsimimi të përbëhet vetëm nga orët mësimore. Arsimimi mund të përfshijë ndihmën dhënë personave për ta përdorur sistemin e bibliotekës, jo vetëm për libra, por edhe për muzikë, internet, video të performancave dhe të gjitha llojet e informave rreth projekteve dhe aktiviteteve kulturore. T'i ftosh artistët për t'u bërë pjesë e bibliotekave për të dhënë këshilla dhe përgjigje në pyetje mund të jetë mënyrë jo e shtrenjtë dhe frymëzuese për ngritjen e interesimit të personave që kanë vende pune të tjera, por që duan t'i zgjerojnë horizontet e tyre personale.

Ajo kategori – personat që kanë vende pune të tjera, por që dëshirojnë t'i zgjerojnë horizontet e veta – shpeshherë, në botën bashkëkohore, i përfshin studentët.

Sigurisht se për shtetin është gjë absurde që të pajtohet të ofrojë arsim nga tatimimi deri në moshën tetëmbëdhjetëvjeçare dhe më pastaj të refuzojë ta kryejë detyrën. Në ditët kur është pritur që njerëzit ta lënë shkollën dhe për tërë jetën të fillojnë të punojnë në vende ku punët janë

kryer manualisht mund të ketë pasur arsyetime. Megjithatë, shumë pak prej atyre industrive ekzistojnë në Europë në shekullin 21. Nëse dëshirojmë ta ruajmë punësimin, shumica e të rinjve do të kenë nevojë për t'u trajnuar në një nivel shumë më të lartë sesa në të kaluarën dhe është sigurisht e paarsyeshme që të pritet që ata të arrijnë rezultate të mira kur punojnë si kamerierë, apo ndihmës në dyqane sa për të mbijetuar, përveç nëse do të mbesin studentë gjatë tërë moshës së viteve të njëzeta, duke humbur kështu disa prej viteve më inovative të jetës produktive.

Qëndrimi që lëndët e arteve dhe të trashëgimisë në universitete, konservatore dhe akademi i shikon si opsion të lehtë (krahasuar me ato shkencore) është thellësisht shkatërrues për përparimin ekonomik dhe social. Për ekonomitë e shërbimeve në Europë, ku prodhimtaria dhe bujqësia kanë rënë masivisht, do të jenë industritë e bazuara në kulturë dhe kreativitet ato që do ta ofrojnë bazën për punësim. Për performuesit, standardet profesionale janë duke u ngritur pashmangshmërisht, meqë publiku që ka udhëtuar shumë, repertorët dhe disponueshmëria e gjerë e incizimeve (shumica e tyre të gatshme për t'u shkarkuar nga interneti),

nënkuptojnë se toleranca ndaj talentit që nuk ka asgjë të jashtëzakonshme është duke rënë. Konservatoriumet tani duhet të prodhojnë të diplomuar të gatshëm dhe të aftë të hyjnë shpejt në profesion dhe të mbijetojnë në një treg ndërkombëtar nëse dëshirojnë të vazhdojnë si performues. Natyrisht se ka shumë vende të tjera të punës që e mbajnë të qëndrueshme majën e performimit – si agjent, administrator, publicist, gazetar, transmetues, mësimdhënës, dhe akademik. Megjithatë, këto janë role dytësore dhe u përket performuesve dhe kreatorëve që të shkëlqejnë në çdo gjeneratë dhe (për ruajtjen e politikave rajonale dhe komunale) në çdo pjesë të shtetit.

Kundrejt kësaj duhet të baraspeshohen mundësitë që performuesi i ka për të pasur jetë të plotë dhe të kënaqshme në profesionin e vet. Nuk do të kishte kuptim që, për shembull, nga akademitë shtetërore të dalin trumbistë të shkëlqyer nëse nuk do të kishte orkestra për të luajtur me ta. Aktorët veçse kalojnë kohë depresive, pa punë për kohë të gjata të karrierës, por që iu duhet të jenë vazhdimisht të gatshëm të udhëtojnë për të marrë pjesë në audicione, të marrin role për vetëm një apo dy ditë, dhe të kalojnë kohë nëpër trajnime pa u paguar. Aktorit i duhet t'i studiojë

skriptat, ta mbajë si zërin ashtu edhe trupin në formë dhe t'i ruajë aftësitë nga të ndryshkurit, edhe atëherë kur nuk ka perspektivë për ndonjë vend të punës. Ngjashëm nuk do të kishte kuptim nëse kolegjet e dramës prodhojnë profesionistë të mirë, por të cilët shkojnë dëm për shkak të politikave joadekuate për teatrin, filmin dhe televizionin.

Megjithatë, edhe konservatoriumet duhet t'i pajisin studentët për realitetin e profesionit, duke i mësuar ata për prezantimin para audiencave, marrëdhëniet me media, si t'i menaxhojnë financa, si të merren me zyrtarë si dhe si të kërkojnë punë.

Ndonëse shumë universitete europiane kanë objekte dhe pajisje shembullore për trajnimin e performuesve, prapëseprapë kësaj nuk i kushtohet aq rëndësi sa në Amerikë. Megjithatë, lëndët e arteve vazhdojnë të jenë tejet tërheqëse për studentët, edhe pse rruga drejt një vendi të punës është më pak e sigurt sesa në disiplinat e tjera. Kultura ka nevojë të ketë bazë të fortë të hulumtimeve akademike. Duhet të ekzistojë një baraspeshë mes praktikës dhe teorisë. Nëse ne dëshirojmë ta kuptojmë të kaluarën ashtu siç duhet, atëherë universitetet janë thelbësore,



qoftë për trajnimin e arkeologëve, historianëve dhe restauruesve, qoftë të atyre që kanë aftësi të krijojnë edicione performuese nga notat e muzikës së lashtë, apo ta shpëtojnë dhe interpretojnë letërsinë e para njëmijë viteve nga dorëshkrimi i stilizuar i kohës (si vërejtje, në këtë kontekst, ne nuk duhet të lejojmë që studimi i gjuhës latine dhe i Greqisë antike, i gjuhës hebreje dhe sanskrishte të bëhet aq i specializuar sa të ketë vetëm pak dijetarë që do të mund t'i zbatojnë tekstet në lëndë jashtë lingistikës).

Duke e pas parasysh lëvizshmërinë në rritje e sipër të njerëzve në Europë, universitetet dhe institucionet e tjera duhet të sigurohen që kurset e tyre të strukturohen në atë mënyrë që kualifikimet që i japin të pranohen ndërkombtarisht. Kjo nuk nënkupton se çdo shtet duhet t'i braktisë traditat e veta dhe të miratojë një plan-program mësimor të njëjtë. Por të diplomuarit, në fund të kursit të tyre, dihet ta kenë gatishmëri të njëjtë t'i hyjnë botës profesionale, ku diplomat e tyre duhet të tregojnë nivel të përbashkët të njohurive dhe arritshmërive.

Universitetet po ashtu kanë rol të efektshëm në ofrimin e trajnimeve

të diplomimit për menaxhim dhe çështje ndërkombëtare dhe për hapjen e objekteve dhe pajisjeve të veta për komunitetin e gjerë. Universitetet lokale dhe akademitë shtetërore po ashtu janë jetike për ruajtjen e traditave kulturore, përmes ofrimit të ekspertizës nëpër fushat, gjuhët dhe teknikat që kanë dalë jashtë përdorimit të përgjithshëm, por që janë komponenta të pandara të përkatësisë sociale. Humbja e këtyre përgjatë kërkimit ekskluziv të bashkëkohores dhe të asaj që është dukshëm e popullarizuar do të ishte diçka e papërgjegjshme dhe shkurtpamësi.

Kombinimi i nevojave arsimore të kulturës për shoqërinë dhe i buxhetit që mund të jetë në dispozicion, mund të duket si shpresë e frikshme. Megjithatë, pritshmëritë mund të lidhen me burimet. Pa dyshim se industritë kulturore do të mund të bënin shumë më shumë sesa ajo që e bëjnë për të ndihmuar në prodhimin e ekspertizës që iu nevojitet, pjesërisht duke kontribuar për kostot e trajnimeve dhe, çka është më e dobishme, duke siguruar që objektet dhe pajisjet për studentë të jenë të përditësuar, të pajisura me teknologjinë të cilën të diplomuarit do të duhet të dinë se si ta përdorin dhe ta çojnë më tej

kur ta fillojnë profesionin. Duhet të ketë raport më të afërt mes biznesit kulturor dhe studentëve. Edhe nëse kthimi në sistemin e vjetër të stazhit të punës si nxënës nuk është praktik, prapëseprapë mund të ekzistojë një proces i miratimit, ku studentët fitojnë përvojë të dorës së parë të jetës profesionale dhe ku ata që tani më janë me përvojë veprojnë si mentorë për të rinjtë që janë në fillim e sipër. Në fund, sistemi i integruar i mentorimit të të diplomuarve do ta bënte më të lehtë kalimin nga studimet në punë, ai do t'ua ulte kompanive kostot e punësimit, do ta bënte procesin e përshtatjes në mjedisin e punës më pak traumatik dhe do t'i lehtësonte në masë të konsiderueshme presionet mbi kostot e qeverisë për mirëqenie.

Teknologjia e re dhe kosto e ulët e udhëtimeve me aeroplan po ashtu mund të ndihmojnë për shpëtimin e buxhetit. Tani është e mundur që institucionet t'i shfrytëzojnë bashkërisht objektet dhe pajisjet, të promovojnë kurse të përbashkëta, të shkëmbejnë tutorë dhe t'i vënë në dispozicion punimet për të tjerët në anën tjetër të botës me aq lehtësi sikur ata të gjendeshin matanë rrugës. Intraneti, si dhe interneti, sistemet mund t'ua mundësojnë studentëve që t'i kontaktojnë cilat

do autoritete që iu nevojiten, të kenë qasje në biblioteka dhe të komunikojnë mes vete në mbarë botën. Studimet virtuale nuk mund dhe nuk duhet ta zëvendësojnë botën sociale dhe të dorës së parë të kampusit – ajo do t'i dënonte studentët me izolim shkatërrues dhe t'ua mohonte përvojat më të rëndësishme formuese të jetës rinore – por ato shtojnë një dimension të ri dhe e zgjerojnë fushëveprimin e studimeve dhe prejardhjen e studentëve që kanë mundësi t'i vijojnë. Kjo e baraspeshon idenë e të mësuarit afatgjatë me atë të përgatitjes profesionale, atmosferën e kolegjit që ngjan me fshatin, fleksibilitetin e rrjetëzimit ndërkombëtar dhe përfitimin e pazëvendësueshëm të kontaktit individual me pasuritë e komunikimit të pakufizuar.

# VII. Përmbledhje: lista e plotë për hartuesit e politikave

Kjo listë është nxjerrë nga ato që janë thënë në kapitujt më sipër. Lista kontrolluese nuk është paraqitur me qëllim sipas radhës prioritare. Hartuesit e ndryshëm të politikave do të dëshirojnë që gjërat t'i bëjnë në mënyra të ndryshme dhe ndërhyrja në atë proces do të ishte parajyquese. Kjo nuk është përmbledhje e udhëzimeve të Këshillit të Europës për ndonjë fushë tematike të caktuar, e as përzgjedhje nga shqyrtimet e politikave të tij shtetërore. Megjithatë, kjo është shumë afër të dyjave për nga fryma dhe qëllimi. Këtu parashihet që studentëve të politikave t'u jepet një grup kriteresh kundrejt të cilave do të mund të bëhej gjykimi i drejtimit të politikave. Andaj, derisa do të ketë shumë më shumë elemente të cilat profesionistët e fushës do të dëshironin t'i shtojnë, nëse ato nga lista nuk janë të pranishme të pyesësh se pse mund të jetë gjë produktive.

## Trajtimi i trashëgimisë

-Promovimi i lartësisë së ministrave të kulturës në hierarkinë politike në mënyrë që ndikimi i tyre të përshtatet me rëndësinë politike të identitetit kulturor, për çka ata duhet të jenë pararojë për të gjitha pikëpamjet e ndryshme kulturore të shoqërisë.

-Detyra e qeverisë në fushën e kulturës është që të mundësojë e pastaj të qëndrojë anash.

-Të mos theksohen tepër përfitimet shtesë dhe ekonomike nga kultura. Përfitimi i vërtetë është çlirimi i kreativitetit dhe frymëzimit.

-Përfitimet sociale do të rrjedhin nga shpenzimet kulturore vetëm nëse ato mbështeten nga masat ekonomike dhe arsimore.

-Kultura i sjell vlerë të shtuar punës së fushave të tjera të qeverisë. Politikrat kulturore duhet të koordinojnë, përfshijnë dhe të kërkojnë zgjerimin e kësaj.

-Në shumicën e shteteve europiane, komunitetet vendore gjithnjë kanë genë dhe vazhdojnë të jenë furnitorët më aktivë të mbështetjes kulturore.

-Qeveria ka nevojë që t'i ketë tri strategji të politikave: për kontributin e vet, për kontributin e investimeve lokale dhe për kontributin e sektorit privat.

-Donacionet dhe sponsorimet janë ndihmë e mirë për fondet publike, por ato mund ta shtrembërojnë drejtimin artistik dhe rrallëherë kontribuojnë më

shumë se mesatarisht 10% të buxhetit të organizatës.

-Sponsorimi nuk duhet të shikohet si përgjigja ndaj dëshpërimit, qoftë nga ana e qeverisë, ndonjë organizatë kulturore, apo sponsor. Nuk duhet t'i lihet rregullimi i pjesëve të mbështetjes jo të duhur nga sektori publik.

-Institucionet kulturore kanë nevojë për pavarësi të mjaftueshme për t'u liruar nga pengesat burokratike, por autoritetet publike në çfarëdo niveli kanë ndikim të rëndësishëm stabilizues.

-Institucionet kulturore jokomerciale nuk janë lypsare nga shteti. Ato kanë prioritete të ndryshme nga komercializmi, që i ofrojnë shoqërisë përfitime të tjera. Për të qenë e suksesshme, kulturës i nevojiten që të dyja.

-Privatizimi i institucioneve duhet të shkojë vetëm deri aty ku e lejon interesi i qytetarëve dhe i kulturës.

-Institucionet nuk janë të vetmit motorë të aktiviteteve kulturore. Politikat duhet të bazohen në kontributin kreativ të individit.

### **Nivelet e qeverisë**

-Vendimet duhet të merren në nivelin më të afërt me pikën e ofrimit – pra qytetet duhet ta marrin përgjegjësinë kryesore për jetën e tyre kulturore etj.

-Shumica e institucioneve kulturore gjithashtu do të dëshirojnë të kenë lidhje me nivelet shtetërore, rajonale dhe lokale.

-Duhet të ekzistojë e drejta për t'u ankuar në nivelin shtetëror (në ministrinë e kulturës).

-Një detyrë e qeverisë qendrore është bashkërendimi i niveleve të ndryshme të ofrimit të shërbimeve dhe gjykimit mes tyre.

-Prioriteti për shqyrtim dhe përfitim duhet të jenë interesat e, së pari, qytetarëve, së dyti, ofruesve kulturor, dhe së treti, të autoriteteve qeverisëse.

-Kultura duhet të promovohet kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht. Programet ndërkombëtare duhet të mbështeten dhe organizatat kulturore që marrin pjesë në to duhet të ndihmohen.

-Sigurimi i qasjes më të lehtë të mundshme, sa më pak burokratike dhe

sa më të drejtpërdrejtë në fonde.

-Duhet të ekzistojnë linja të qarta të autoritetit mes të gjitha niveleve, me procedura ndërlidhëse në mes dhe në kuadër të shtresave të ndryshme.

-Duhet të ketë organ të fuqishëm këshillues me bazë juridike të pavarur.

-Nga qeveria duhet të kërkohet që ta publikojë arsyen e saj në rast të mospërbushjes së rekomandimeve të dhëna nga organi këshillues, si dhe duhet të sigurohet procesi i ankesave.

-Numri dhe shtresat e organeve zyrtare duhet të mbahen në një minimum – nuk ka arsye të çohen dëm burimet që mund të shpenzohen drejtpërdrejt për kulturë.

-Inkurajimi i shoqërisë civile (profesionistë dhe vullnetarë) dhe i rrjeteve të saj. Sigurimi i mbështetjes me të hyra për funksionin e tyre.

-Ofrimi i mbështetjes rrjeteve ndërkombëtare, në veçanti nëse ato i vendosin sekretariatet e tyre në territorin tuaj.

-Sigurimi që zyrtarët në të gjitha

nivelet të trajnohen për t'i mësuar kushtet dhe traditat e sektorit kulturor: mënyrën e punës së profesionistëve, jetën e përditshme të artistëve, etj.

-Zbatimi i papenguar i rregullave dhe i rregulloreve, duke e pranuar se kultura shpeshherë ka të bëjë me shkeljen e rregullave dhe ka nevojë për kritere që janë fleksibile.

-Zyrtarëve që punojnë në fushën e kulturës t'u jepet statusi i lartë profesional. Atyre t'u jepet struktura e karrierës solide brenda administratës kulturore, trajnime gjithëpërfshirëse dhe prospekte profesionale të mira pa barriera jozyrtare.

-Të punohet për të siguruar që kultura të përdoret në politikë si fuqi unifikuese e jo ndarëse.

### **Objektivat politike**

-Të pranohet se njerëzit kanë më shumë se një prejardhje dhe identitete. Mos u mundoni të impononi identitet të rremë, i cili përkon me linjat politike bashkëkohore në hartë.

-Ruajeni dhe promovojeni gjuhën, jo vetëm gjuhën dominuese, por edhe letërsinë që shkon me të.

-Ndhimjoni personat që të përmbushin potencialin e tyre kulturor.

-Drejtojini politikat drejt nxitjes së kreativitetit.

-Pajisini popullatën, si psikologjikisht ashtu edhe fizikisht, që t'i shijojnë rezultatet.

-Fuqizojini njerëzit që të kontribuojnë në pasurinë kulturore të shtetit përmes pjesëmarrjes aktive – qoftë ajo amatore apo profesionale. Njiheni dhe pranojeni kufirin kalimtar dhe jo të ngurtë mes tyre.

-Sigurojeni qasjen fizike dhe sociale për të gjithë.

-Kërkoni nga transmetuesit që të kujdesen për të gjitha shijet dhe interesat, për shkak se të gjithë ne jemi pjesë e ndonjë pakice. Ata duhet të jenë bujarë në ofrimin e poezisë, dramave, vallëzimeve, operës, arteve pamore dhe muzikës klasike – format të cilat kanë audiencë të mëdha, por jo gjithnjë në masë.

-Të ruhen artizanatet e lashta dhe ato të shkallës së vogël.

-Të mbahet mjedisi i jetesës në kulturë dhe trashëgimi – jo në ndonjë mjedis tematik artificial – në veçanti për pakicat e kulturat autoktone.

-Synoni të arrini një ndjenjë të sigurisë kulturore në mesin e tërë popullatës.

### **Trashëgimia**

-Trashëgimia duhet të ruhet si pjesë e jetesës së shoqërisë.

-Politikat për trashëgiminë duhet të përfshijnë kujdesin ndaj peizazhit. Politikat e planifikimit duhet të krijojnë një baraspeshë mes inovacioneve kulturore dhe ameniteteve t përmirësuara kundrejt evolucionit të favorshëm të peizazhit.

-Dëshmitë e së kaluarës duhet të mbrohen, të skicohen, të vihen në katalogë dhe të ruhen.

-Ndërtesat e rëndësishme trashëgimore duhet të vazhdojnë të përdoren – vende për të jetuar dhe punuar, deri në atë masë që është në përputhje me konservimin.

-Pronarëve duhet vënë në dispozicion

grante, kompensime dhe lirime tatimore për mirëmbajtjen e trashëgimisë, mjedisit të saj dhe koleksioneve.

-Pronarët duhet të kenë “detyrë për kujdes” dhe nga ta të kërkohet që t’i kenë parasysh qytetarët në lidhje me ndryshimin apo sistemimin e aseteve të trashëgimisë që ata i kanë në dispozicion.

-Duhet të ekzistojë një kornizë juridike që e lejon caktimin e fondacioneve për kujdes të përhershme ndaj ndërtesave, pasurive dhe monumenteve.

-Fondacionet trashëgimore duhet t’i përkasin një trupi profesionist që i rregullon standardet e konservimit, menaxhimin dhe qasjen publike në një nivel të pranuar ndërkombëtarisht (nganjëherë edhe më gjërë).

-Politikat duhet ta lehtësojnë përdorimin e teknikave dhe artizanateve të ndërtimit trashëgimore në ndërtesat e ditëve të sotme – zhvillimi i punësimit të personave të shkathët, në veçanti nëpër zona rurale.

-Ndërtesat e konservuara duhet të përdoren kurdo që është e mundur për projekte arsimore, festivale, interpretime

dhe takime (pa e dëmtuar strukturën apo atmosferën).

-Ndërtesat të dekorohen me ndjesi – sa më afër skemës së ngjyrës origjinale (d.m.th., jo plotësisht të bardhë!).

-Mos të bëhet përqendrim i burimeve në ato lokacione të pakta që janë të popullarizuara dhe të vizituara së tepërmi në kurriz të pjesës tjetër.

-Kijeni parasysh presionin e numrit të vizitorëve dhe dëmet që ata mund t’ua shkaktojnë lokacioneve të ndjeshme. Nëse është e nevojshme, numri të kufizohet.

-Programet e konservimit mund të mos jenë në përputhje me orarin politik. Të jeni të përgatitur për afatin e gjatë.

-Kujdesi për trashëgiminë duhet të bëhet në kuadër të një kornizeje për politika mjedisore si dhe kulturore.

-Ndryshimet nuk duhet të jenë të ndaluara. Rregulloret duhet të ofrojnë fleksibilitet të mjaftueshëm për akomodimin e ideve imagjinative.

-Shikoni ndërtimet e të sotmes si trashëgimi potenciale për të nesërmen

dhe si rrjedhojë kërkoni standarde të larta.

### **Turizmi**

-Fryma dhe atmosfera e një vendi duhet të ruhet. Turistët do ta ndryshojnë atë, por atyre nuk duhet lejuar ta shkatërrojnë.

-Nevojat e komunitetit lokal duhet të baraspeshohen kundrejt objekteve dhe shërbimeve për turistët.

-Vendasit duhet konsultuar lidhur me ndërtimin dhe projektimin e objekteve dhe shërbimeve. Zhvillimi i pakufizuar nuk duhet lejuar.

-Për punët zhvillimore të përdoret fuqia punëtore vendase sa më shumë që është e mundur.

-Artizanatet suvenire duhet të merren nga traditat dhe shkathtësitë vendase, jo të jenë mallra të importuara që janë prodhuar në ndonjë vend tjetër.

-Sigurohuni që shërbimet, siç janë restorantet dhe dyqanet, të hapen në kohën kur vizitorët duan dhe presin, edhe nëse kjo gjë është ndryshe nga praktika vendase. Përndryshe përfitimet e plota ekonomike do të humbasin.

-Këmbëngulni që shërbimi nëpër vendet turistike të jetë miqësor, që informatat të jenë të lehta për t'u kuptuar dhe për t'u gjetur, dhe që stafi i nevojshëm të aftësohen për gjuhët evropiane kryesore.

-Monitorojeni vlerën për para dhe jini të gatshëm të rregulloni nëse ka nevojë. Kërkimi i pagesave të tepërta do të jetë shkatërruese në afatin e gjatë.

-Sigurohuni që brendi i qytetit, rajonit apo i shtetit të përputhet me realitetin. Mos premtoni çudira që nuk janë për t'u soditur.

### **Muzetë, bibliotekat dhe arkivat**

-Në muze, interpretimi është po aq i rëndësishëm sa edhe ekspozimi.

-Muzeu është teatri i të kaluarës. Ekspozimet në të duhet të pasqyrojnë dramën/emocionin prapa objekteve.

-Inkurajojini personat që të prekin si dhe të shohin, t'i shikojnë rikonstruksionet apo replikat dhe t'i prekin gjërat vetë. Vizitorët që marrin pjesë do të mbajnë mend më shumë.

-Gjejini baraspeshën mes dhuntisë prezantuese dhe kuratorisë së përpiktë.



Sigurori që muzetë të kenë fonde të mjaftueshme, jo vetëm për t'i konservuar dhe ekspozuar koleksionet e tyre, por edhe për t'i shtuar ato.

Inkurajojini fondet për kulturë për muze.

Inkurajojini muzetë që të kenë në shitje mallra cilësore që lidhen me ekspozitat e tyre. Muzetë mund t'i përdorin kompanitë e tyre tregtare për t'u bërë porosi artizanëve dhe artistëve.

Shfrytëzoni mundësitë rekreative të muzeve përmes performancave, hapësirave të mira sociale dhe ushqimit të mirë.

Mundohuni që t'i hapni muzetë përtej orarit të rregullt në mënyrë që qytetarët vendas të mund t'i vizitojnë.

Sigurohuni që të mos ketë ndërhyrje politike në interpretimet e historisë që jepen nga muzetë, arkivat dhe bibliotekat; që këto institucionet të jenë të lira ta thonë të vërtetën me aq saktësi që e lejon studimet akademike.

Ta keni parasysh nevojën për të genë në hap me zhvillimet e reja

ndërkombëtare të arkivimit, p.sh. ruajtja e postës elektronike (e-mail) në forma elektronike dhe të shtypur.

Sigurojeni strukturën e duhur juridike për arkivat lokale dhe universitare, përmes së cilës do të përcaktohen përgjegjësitë për grumbullimin, ruajtjen dhe qasjen.

Ndihmohuni arkivave që materialin e tyre ta vënë në dispozicion përmes teknologjisë së re.

Punoni drejt marrëveshjeve ndërkombëtare lidhur me standardet e ruajtjes arkivore.

Librat në biblioteka janë burim jetëgjatë, jo artikuj konsumatori që duhet të hidhen në rast se nuk nxirren nga raftet. Atëherë ku ka nevojë për largimin e librave më pak të njohur për shkaqe të krijimit të hapësirës, ato duhet të ruhen me qasje të lehtë dhe të mbahen në katalog.

Çdo shtet duhet të ketë më shumë se një bibliotekë me të drejtë autoriale, në të cilën do të mund të mbahen regjistrat e plotë të të arriturave të shoqërisë. Nga botuesit duhet të kërkohet që t'i depozitojnë kopjet.

-Të ruhet roli arsimor dhe social i bibliotekave lokale. Ato të qëndrojnë të hapura në orare kur shumica mund t'i shfrytëzojnë.

### **Artet pamore dhe letrare**

-Përmirësojeni statusin e artistëve dhe shkrimtarëve përmes ofrimit të kornizave fleksibile fiskale dhe të mirëqenies.

-Mbështetini artistët dhe shkrimtarët e çdo moshe, puna e të cilëve parashihet të jetë e cilësisë së lartë, por e cila ende nuk ka mundur të tërheqë shfrytëzimin komercial.

-Mekanizmi kryesor për mbështetjen e artistëve dhe shkrimtarëve duhet të jetë ofrimi i fondeve për porositjen e punëve, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi përmes sistemit të prezantimeve dhe botimeve.

-Kriteret për porositje duhet ta kenë parasysh se puna e artit apo e letërsisë mund të zhvillohet në mënyra të llojllojshme nga plani fillestar. Kjo është shenjë suksesi, jo mospërputhje. Andaj nga artistët dhe shkrimtarët nuk duhet të kërkohet sasi e tepërt e hollësive rreth ndonjë pune para se ajo të porositet.

-Fondet mund të ofrohen si kredi apo garanci kundrejt humbjes. Kjo i jep shtetit nxitje për të bërë që puna të ketë

sukses.

-Të krijohen sisteme të shpërndarjes për punën e artistëve dhe shkrimtarëve që nuk janë të varur nga qëndrueshmëria komerciale.

-Të themelohen *droit de suite*/ e drejta për rishitje dhe e drejta për t'iu qasur dhe riparuar punimet origjinale.

-Të sigurohen marrëveshje të reja ndërkombëtare për të drejtat autoriale, në veçanti marrëveshje kolektive për shkarkime nga interneti.

### **Artet e performancës**

Pritni që mes 50% dhe 70% e buxheteve të sigurohen nga mjetet publike.

-Ndërlidhini subvencionet me objektiva specifike, p.sh. për produksione të cilësisë së lartë të cilat do të jenë të qasshme për sa më shumë persona që është e mundur.

-Jepni garanca të niveleve të mbështetjes me vite të tëra më parë për të mundësuar planifikim të arsyeshëm. Kjo do të kursejë para dhe do t'i ruajë standardet.

-Bëjeni sistemin e subvencionimit transparent dhe me mundësi të akomodimit të ankesave (gjithmonë mbani buxhet për kontingjenca/gjëra të paparashikuara).

-Shmangiuni ofrimit të granteve të njëpasnjëshme të palëvizshme.

-Synoni të lëvizni drejt fondeve për kulturë për kompani madhore, duke iu ofruar siguri afatgjate dhe në të njëjtën kohë gradualisht t'i shkëpusni nga varësia nga mbështetja me të hyra. Themeloni procedura të kontabilitetit për ta lehtësuar këtë dhe mos i ndëshkoni kompanitë me shkëputje të mbështetjes direkte në proporcion me të ardhurat e tyre nga fondet për kulturë. Në vend të kësaj, ulini fondet për kulturë për 25% të interesit prej investimeve. Kjo nënkupton se stimulimi për dhënien e fondeve për kulturë mbetet i fuqishëm, ndërsa në anën tjetër fondet do të lirohen për iniciativa të reja.

-Nuk parashihet që buxheti i përgjithshëm i qeverisë për kulturën duhet të bjerë me pavarësimin e kompanive nga ai, ai mund të riorientohen në fusha të reja, duke i ndihmuar kështu jetës kulturore që të vazhdojë.

Jepni shuma të përshtatshme për punët artistike brenda ndërtesave në rastet kur jepen grante kapitale për përmirësimin e vendeve.

-Së paku 10% të të gjitha fondeve duhet të rezervohen për punime të reja.

-Kompanitë e arteve duhet të jenë administrativisht të ndara nga qeveria edhe atëherë kur ato varen praj saj. Atyre duhet t'iu mundësohet që vetë t'i kryejnë aranzhimet kontraktuale, menaxheriale dhe artistike.

-Oqytetet duhet të sigurohen të ketë baraspeshë mes kompanive rezidente dhe ansambleve vizituese. Jetës kulturore i nevojitet llojllojshmëri dhe ndërlidhje.

-Minimizojini kufizimet për përdorimin e hapësirave të pazakonta për performanca.

-Relaksoni kufizimet e vizave për artistët e huajë që vijnë për vizita. Synoni të arrini një botë kulturore të hapur. Kjo, si rezultat, do t'i ndihmojë botës ta vlerësojë kulturën.

-Trajtojini festivalet si burime madhore

dhe mënyrë thelbësore për përhapjen e pasurive të jetës kulturore nëpër zonat e largëta apo të pafavorizuara.

### **Industritë kulturore**

-Të gjitha industritë kulturore janë biznese të vogla ose të mesme. Asnjë prej tyre nuk është gjigant industrial (ndonëse një apo dy perandori mediatike i afrohen).

-Ato e përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të imazhit kulturor të shtetit dhe janë mjet i projektimit të imazhit kulturor brenda si dhe jashtë shtetit. Andaj, ato nuk mund të trajtohen thjesht si prodhuese të mallrave.

-Natyra e tyre e veçantë duhet të njihet si në sistemin fiskal të brendshëm ashtu edhe në kodet ndërkombëtare për tregtinë dhe konkurrencën.

-Autoritetet vendase mund të ndihmojnë me ndërtesa, nxitje të punësimit lokal dhe bashkërendim të objekteve/shërbimeve.

Politikat që kanë për synim përmirësimin e qasjes në treg dhe shpërndarje janë po aq të rëndësishme sa edhe ndihma dhënë prodhimit – shpeshherë edhe më shumë.

-Qeveria duhet ta shfrytëzojë çdo rast për t'i promovuar industritë kulturore të shtetit të vet jashtë vendit: duke iu ndihmuar që të vijojnë panairët e tregtisë, ngjarjet diplomatike dhe forumet ndërkombëtare.

### **Mediat**

-Qeveria duhet ta mbrojë shoqërinë demokratike kundër përqendrimit të tepërt të pronësisë mediatike.

-Diversiteti i opinioneve dhe llojllojshmëria e formateve është esenciale në shoqëritë demokratike.

-Porositësit e reklamave nuk duhet të kenë ndikim në politikën redaktuese dhe në përmbajtjen programore. Politika e kulturës duhet të jetë si kundërpeshë ndaj presioneve komerciale.

-Mediet transmetuese duhet të kujdesen për pakicat kombëtare, kulturore dhe linguistike.

-Standardet dhe shumëllojshmëria e programeve mund të sigurohet përmes kushteve dhe kuotave të shërbimit publik.

-Qeveria duhet të abstenojë nga

ndërhyrja në çështjet e sjelljes seksuale. Çdo rregullore tjetër përpos pragjeve kohore për transmetuesit e vendit është pothuajse e prirë për të mos funksionuar dhe do të bëhen edhe më jofunksionale me kalimin e televizionit analog në digjital.

-Rregulloret për transmetuesit shtetëror duhet t'ua mundësojnë që ta arrijnë potencialin e tyre të plotë dhe ta investojnë suksesin në programe. Është më mirë nëse transmetuesit shtetërorë nuk konkurrojnë drejtpërdrejt me stacione tërësisht komerciale për të ardhura nga reklamat (ndonëse kjo mund të mos jetë e shmangshme në disa shtete të vogla). Konkurrenca jo e drejtë, së bashku me praninë e gjithëmbarshme të reklamimit, do t'i ulin standardet e të dyja llojeve të rrjetit.

-Proporcioni i reklamimit ndaj përmbajtjes së programit (numri i minutave të lejuara në orë) duhet të kufizohet për ta mbrojtur vazhdimësinë e programit. Kjo gjë po ashtu do ta rrisë vlerën e rrallësisë.

-Sado i sofistikuar dhe global që bëhet transmetimi digjital, qeveritë duhet të kërkojnë zhvillimin dhe garantimin e sistemeve lokale.

### **Arsimi dhe trajnimi**

-Lëndët shkencore dhe kulturore kanë rëndësi të njëjtë në arsim. Që të dyja përfaqësojnë makinën hulumtuese dhe zhvillimore të shoqërisë.

-Të mësuarit për muzikën ndihmon për shkathtësitë logjike dhe ato të koordinimit. Artet pamore ndihmojnë për analizim dhe përqendrim. Dramat ndihmojnë për nivelet e vetëbesimit dhe kuptimit social. Shkrimi kreativ liron të shprehurit dhe e përmirëson artikulimin. Këto të mira, në mesin e të tjerave, duhet të pasqyrohen në plan-programet shkollore për të gjithë fëmijët.

-Politikat duhet të inkurajojnë më shumë mësimdhënës të lëndëve kulturore që t'i arrijnë postet më të larta në kuadër të profesionit.

-Kultura ka nevojë për pjesëmarrës, profesionistë dhe audienca të informuara mirë. Sistemi arsimor duhet të ndihmojë që t'i sigurojë të tria prej tyre.

-Ne duhet të kemi kujdes me mënyrën e njoftimit të njerëzve me kulturë nëpër shkolla. Entuziazmi mund të shtypet shumë lehtë përmes qasjes shumë teorike, ose didaktike, apo nëse të rinjve u ofrohen performanca të nivelit dytësor.

-Nga çdo organizatë kulturore që merr para publike duhet të kërkohet që të ketë program arsimor serioz për personat e të gjitha moshave.

-Vendosja e artistëve profesionistë nëpër shkolla mund t'iu ndihmojë shkollave që të lidhen me jetën e komunitetit.

-Arsimi kulturor mund t'iu ofrojë njerëzve mundësi për t'ri rizbuluar talentet më vonë gjatë jetës.

-Ai mund t'iu ofrojë grupeve të pakicave dhe refugjatëve lidhje të rëndësishme me komunitetin.

-Objektet e shkollave dhe kolegjeve – bibliotekat, studiot, skena, etj. – duhet t'ri vihen në dispozicion pjesës tjetër të komunitetit kurdo që është e mundur.

-Zyrat vendase të arsimit duhet të mbajnë shënime rreth profesionistëve kulturorë që jetojnë nëpër rajonet e tyre në mënyrë që shkollat dhe kolegjet ta kenë më të lehtë t'ri kontaktojnë.

-Mësimdhënësit duhet të trajnohen rreth metodave të suksesshme për përfshirjen e profesionistëve nëpër

projekte.

-Shkrimtarët rezidentë nëpër biblioteka mund t'iu ndihmojnë të tjerëve që të zbulojnë interesimin e tyre për letërsinë.

-Lëndët kulturore në arsimin e lartë nuk duhet të shikohen si “të buta”, apo si përgatitje e keqe për tregun e punës. Kreativiteti dhe fleksibiliteti i të menduarit që ato e inkurajojnë mund të jenë asetet e rëndësishme në karrierat e ardhshme.

-Konservatorët duhet t'ri përgatisin studentët për realitetet e profesioneve në të cilët shpresojnë t'ri kenë.

-Studimet në lëndët kulturore nëpër universitete, p.sh. gjuhët e lashta dhe muzikologjia, janë të rëndësishme për ta kuptuar të kaluarën. Qëndrimi dhe madhësia e tyre në universitete duhet të ruhen.

-Nevojiten përpjekje të mëtejme për t'ri bërë kualifikimet të krahasueshme në mbarë Europën.

-Industritë kulturore duhet inkurajuar për të ndërtuar lidhje më të fuqishme me sektorin e arsimit dhe të aftësimeve.

-Zgjerimi i mundësive përmes përdorimit të lidhjeve të internetit dhe intranetit shpejt do ta ndërkombëtarizojë kontekstin e arsimit kulturor.



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë




Implementuar nga:











*forumikulturor.net*  
*facebook.com/ForumiKulturor*  
*twitter.com/forumikulturor*

